



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 26 JANAR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
26. JANUARA 2012. GODINE**

**JANAR – JANUAR
2012**

E mërkurë, 26.1. 2012, ora 11:30

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit Qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në mbledhje janë të pranishëm 62 deputetë, që do të thotë mund t'ia fillojmë punës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutim jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutime në emër të Grupit, pesë minuta, në emër të deputetit, tre minuta. Replika s'ka. Fillojmë.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Duke qenë se përcaktimi i ne të zgjedhurve të popullit është ligjshmëria dhe transparenca, në shërbim të interesit qytetar, dua të ngre disa pyetje që kanë të bëjnë me zotin Kurti, i cili ka ngritur disa pyetje me qëllim që ai të ndërtojë teori konspirative për gjoja dy takime publike të kryeministrit me Boris Tadiqin, që në fakt nuk mund të llogariten as përshëndetje kurtuazie në konferenca publike ndërkombëtare e lëre më takime zyrtare.

Ndërsa, tentoni që në konferenca publike ndërkombëtare të bëni lajm e të luftoni kryeministrin në rrafshin politik dhe kombëtar, patriotik, duke ditur që në aspektin kombëtar, patriotik e politik, as për së afërmi nuk mund të arrini, po ta rikujtoj shkurtazi historinë e konferencave ndërkombëtare të Rambujesë kur Hashim Thaçi udhëhoqi delegacionin kosovar edhe pse në moshë të re, arriti të përfitonte përkrahjen ndërkombëtare, që rezultoi me intervenimin e NATO-s dhe çlirimin e vendit dhe konferencën e Vienës, që rezultoi me pavarësinë e vendit.

Për shkak të qasjes suaj negative për vendin duke tentuar që të fshiheni pas flamurit kuqezi, duke kërkuar tradhtarë në këtë vend, pa pasur vizion për vendin, duke mos njohur fare politikën si art i së mundshmes, ju zoti Kurti skajmërisht keni politizuar dhe armiqësuar skenën politike. Por, pasi që po keni dëshirë të ngritni çështje të kësaj natyre, zoti Kurti, do të doja që në aspektin më pozitiv, të përgjigjeni publikisht në disa pyetje, që në fakt janë çështje që deri më tani i keni mbajtur të mbyllura për vete dhe për bashkëpunëtorët dhe rrethin tuaj të ngushtë, pa fare transparencë.

Së pari, zoti Kurti është mirë të sqaroni takimin tuaj të fshehtë me serbët në Klinë. Zoti Kurti, policia e Kosovës, në vitin 2004, ju ka ndaluar në makinë së bashku dhe legjitimuar së bashku me disa serbë, duke shkuar në një fshat serb të Klinës. Në bagazhin tuaj kishte dokumente dhe shishe të verës, suxhuk e gjëra tjera ushqimore. Dua t'u sqaroni qytetarëve të Kosovës, me cilët serbë keni qenë, qëllimin e këtij takimi, ishte për piknik me serbët, me qëllim të rritjes së besimit ndër qytetarë, apo ndonjëri nga bashkudhëtarët tuaj ishte punëtor i BIA-s?

Së dyti zoti Kurti, pas lirimit tuaj nga burgu ju keni vazhduar të mbani korrespondencë me një grua serbe këtu në Prishtinë. E di edhe nga ish të burgosurit shqiptarë, se e njëjta grua iu ka vizituar edhe në burgun në Serbi. Do të ishte mirë t'u shpjegoni qytetarëve raportet tuaja me këtë serbe dhe gjithsesi qëllimet e takimeve tuaja a janë për reciprocitet?

Dhe e treta, zoti Kurti, më datë 28 shtator 2011, përmes autobusit Beograd-Prishtinë, ju keni marrë një korrespondencë, në pako në zarf, sekretari juaj Dardan Mulliqaj e ka pranuar këtë pako në zarf të dedikuar për ju të Stacioni i Autobusëve në Prishtinë. Andaj do të ishte mirë të tregoni qëllimin e materies dhe përmbajtjes së këtij zarfi, që ua ka dërguar vajza e njërit nga ministrat e Millosheviqit.

Për këtë korrespondencë me zarf, zoti Kurti, ka dëshmitarë dhe nëse Agjencioni për Inteligjencë, apo organet e hetuesisë janë të interesuara, atëherë sigurisht se dëshmitari, që ka qëlluar në autobusin Beograd-Prishtinë dhe ka parë këtë korrespondencë tuaj, është i gatshëm të dëshmojë.

Duke qenë se jeni përcaktuar për shtet ligjor, për transparencë dhe veprim institucional, me qëllim më pozitiv dhe në interes të qytetarëve, Albin Kurti, është mirë që t'i sqarosh këto çështje dhe korrespondencat tuaja. Ke bërë mirë që je tërhequr nga protestat në kufi. Sigurisht që edhe të ftohtit e ka bërë të vetën, që ju pak të ftoheni nga idealet tuaja, po, po të them Albin Kurti, që unë me pa dal në kufi, i gjallë nuk isha tërhequr, se jam mësuar me qëndru në të ftohtë, në borë edhe në shi. Ju dëshmuat se bartjen e flamurit kuqezi, bashkë me patriotizmin e keni farsë. Nuk e doni flamurin kuqezi më shumë se asnjë shqiptar tjetër e lere më, më shumë se ne që mbuluam me flamurin kuqezi dëshmorët, shokët tanë që ranë për liri.

A jeni i vetëdijshëm, zoti Kurti, për pasojat që i shkaktuat vendit me këto veprime tuaja, me paralelizmat që krijuat, me strukturat kriminale në veri? A jeni i vetëdijshëm që me veprimet tuaja amortizuat edhe bllokimet e rrugëve në veri dhe me këtë i krijuat Serbisë favore, për të marrë statusin e vendit kandidat për aderim në Bashkimin Evropian?

Zoti Kurti, unë kam menduar që ti të paktën e kupton pak politikën dhe e di që konceptet tona politike, me të gjitha kundërshtitë, do të duhej të na avanconin, por kurrësi të na armiqësonin. Andaj këto çështje që i ngrita për ju zoti Kurti, janë në interes tuajin së pari dhe pastaj edhe të qytetarëve të Kosovës, andaj është mirë që t'i sqaroni bashkë me qëllimet tuaja. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderua ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Kohët e fundit Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor ka ndërmarrë një aksion të rëndësishëm për mbrojtjen e ambientit, përkatësisht rrjedhës së lumenjve, po ashtu edhe për krijimin e disiplinës kur është në pyetje eksploatimi i rërës dhe zhavorrit. Shpresoj se ky është vetëm fillimi i një pune të madhe drejt luftimit të ilegaleve dhe informalitetit në segmentin e eksploatimit të pasurisë minerale të Kosovës, përkatësisht rërës dhe zhavorrit. Sado që ky aksion ka hasur në kritika të mëdha, vlerësoj se hapi tjetër i Ministrisë duhet të drejtohet kah rishqyrtimi i lejeve dhe licencave të dhëna, identifikimi i bizneseve legale, të cilët kanë punuar përbrenda kornizave të lejuara për eksploatim, si dhe gjetjen e mundësive për kompensim, për shkak se puna e tyre është bllokuar për fajin e ilegaleve. Mandej, këto rishqyrtime dhe identifikime duhet të bëhen sa më shpejtë, ashtu që të mos pësojnë bizneset e ndershëm. Ambienti në Kosovë, por edhe pasuritë minerale të saj janë në shënjestër edhe të shkatërruesve të tjerë, ndaj të cilëve nuk ka ndërmarrë asgjë kjo ministri apo cildo mekanizëm tjetër ndëshkues. E kam fjalën për numër të madh të gurëthyesve, përkatësisht në mënyrën e eksploatimit të gurit.

Kjo nuk është një dukuri e re, por ka marrë hov me rritjen e investimeve, posaçërisht në infrastrukturë. Për fat të keq, kohët e fundit nuk është funksionale faqja elektronike e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, prandaj nuk mund të flas me shifra për numrin e bizneseve, që kanë këtë veprimtari, por me këtë rast po përmendi disa të dhëna nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, të cilat e ilustrjnë gjendjen alarmante në këtë fushë.

Sipas raporteve, ky komision ka dhënë 604 licenca, prej të cilave 245 janë për hulumtim të gjitha llojeve të mineraleve. Në vitin 2010 janë dhënë 22 licenca për shfrytëzim të gurit të fortë, por asnjë për shfrytëzimin e mineraleve të tjera. Në total nga 68 licenca të lëshuara parvjet për hulumtim, sipas llojit të mineraleve, 57 janë për gurë të fortë. Mirëpo, situatë alarmante vërehet kur kemi parasysh se prej 127.000 m³ të planifikuara të rërës dhe zhavorrit janë eksploatuar vetëm 18.5 mijë m³. Gjendja e njëjtë është edhe te guri gëlqeror. Nga afër 5.000.000 m³ të planifikuar janë realizuar 2.600.000 m³. Pa marrë parasysh se eksploatimi është shumë larg parametrave të lejuar, në treg nuk ka pasur mungesë të rërës, zhavorrit apo të gurit. Arsyeja kryesore është se kompanitë e licencuara kanë një konkurrencë të pandershme në treg, për shkak të aktiviteteve ilegale të shfrytëzimit. Kjo ka ndikuar që kompanitë e licencuara, të reduktojnë prodhimin. Ky është edhe vlerësim i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Me një fjalë, në treg dominojnë kompanitë ilegale, ndërsa kompanitë legale, përkatësisht ato të licencuara dhe të pajisura me të gjitha lejet, janë viktima e tyre.

Ai gjatë vitit 2010 ka regjistruar dhe inspektuar gjithsej..

(Ndërprerje e zërit nga mikrofon)

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Alma Lama e ka fjalën!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë po i përmbahem kërkesës suaj të vazhdueshme, që në këtë pjesë të seancës të ngremë çështje të cilat janë urgjente, ashtu sikurse nuk bënë të tjerët përpara nesh.

Ne kemi informata se në fshatrat Bistricë, Kushtove dhe Cerajë, të komunës së Mitrovicës, për shkak të kushteve të këqija të motit dhe borës së madhe, që ka rënë, banorët e këtyre fshatrave kanë mbetur të bllokuar dhe nuk kanë mundësi të furnizohen me ushqime dhe me gjëra të tjera të nevojshme. Po kështu, ka pasur edhe mungesë të rrymës elektrike dhe përveç faktit se ata janë të bllokuar në një aks rrugor edhe nga serbët, për shkak të barrikadave, ata tashmë kanë mbetur krejtësisht të izoluar.

Këto fshatra janë lënë pas dore, si nga ana e Qeverisë, ashtu edhe nga ana e Komunës së Mitrovicës, prandaj ju bëjmë thirrje Qeverisë, që të marrë masa të menjëhershme për t'iu ardhur në ndihmë këtyre banorëve të këtyre fshatrave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Jo, unë kam thënë, që çështjet që nuk mund të hyjnë në rend të ditës.

Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Javën që e kaluam në këtë Kuvend u votua një mocion dhe u rrëzua një mocion tjetër. U vlerësua si arritje nga njëra anë dhe si dështim nga ana tjetër. Befasues edhe i shpejtë sikurse ishte mocioni, duket se sidoqoftë ka pasur një efekt të menjëhershëm. Ka tejkaluar një situatë të rëndë politike, e cila po rëndohej shumë e më shumë.

Grupi Parlamentar i Aleancës insiston në zbatimin e vendimeve që merr Kuvendi i Kosovës nga ana e Qeverisë së Kosovës. Si të këtilla, tashmë është e qartë edhe për ata që nuk e kanë ditur, se vendimet e Kuvendit nuk janë këshilluese, por janë detyruese për Qeverinë e Kosovës. Prandaj, edhe sot si Aleancë, ne shprehim pakënaqësinë tonë me vazhdimin e politikës së njëjtë të Qeverisë në raport me Kuvendin.

Pra, politikën e injorimit dhe zhvleftësimit të rëndësisë primare që ka Kuvendi i Kosovës, në një Republikë si kjo e jona. Lëre që nuk e respektoi mocionin e 7 dhjetorit, i cili u zhvleftësua në këtë Kuvend, por, kjo Qeveri nuk po e respekton tash as këtë mocionin e ri të 20 janarit, që u votua nga deputetët e koalicionit qeveritar.

Në pikën 3 të mocionit të 20 janarit thuhet shprehimisht, se Qeveria obligohet t'i raportojë Kuvendit lidhur me mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe reciprocitetit. Pra, Qeveria është dashur që menjëherë pas votimit të mocionit, të kërkojë nga Kuvendi i Kosovës, mbajtjen e një seance me vetëm një pikë të rendit të ditës, raportimi i Qeverisë lidhur me mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe reciprocitetit.

Kjo nuk ka ndodh dhe nuk ka shenja as që do të ndodhë. Pra, Qeveria as nuk na ka raportuar se çka po ndodhë në këto bisedime dhe as nuk e ka ndërmend që të na raportojë. Me këtë tashmë po shkel edhe një vendim tjetër të Kuvendit të Kosovës. Pra, po shkel pikën 3 të mocionit të Kuvendit më 20 janar.

Janë dy momente, që duam ne si Aleancë t'i ngrisim në këtë seancë.

Së pari, prej se ka filluar arritja e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, ju vetë koalicioni qeverisës, keni thënë se këto marrëveshje nuk ka nevojë të vijnë në Kuvend dhe si pasojë e këtij qëndrimi edhe nuk i keni sjellë ato.

Së dyti, prej marrëveshjeve të para me Serbinë, qysh para shtatë muajsh, asnjë raportim nuk e keni bërë në Kuvend me atë që ju obligon, mocionet e Kuvendit. Pra, mos i përzini obligimin e raportimit, që keni si Qeveri me debatet, që kërkojnë deputetët. Ju obligoheni që vetë të raportoni, plus debatet që i kërkojnë deputetët.

I nderuar kryetar, ne pyesim shumë direkt- Çfarë vendimi, apo dokumenti tjetër do të duhej, që ky Kuvend të miratojë, në mënyrë që t'i rikujtojë kësaj Qeverie obligimet e qarta, që i ka?

A duhet tash të votojmë një mocion tjetër, për t'i thënë Qeverisë ...
(Ndërprerje e zërit nga mikrofoni)

KRYETARI: Faleminderit!

BURIM RAMADANI: ... Pesë minuta, a?

KRYETARI: Jo, tre minuta, se s'e ke... në emër të Grupit, a? Vazhdo! Po, lajmërou ti, regjia vetë e zgjatë pesë minuta, po lajmëroni ju!

BURIM RAMADANI: A duhet tash të votojmë një mocion tjetër dhe t'i themi kësaj Qeverie se duhet t'i respektojë mocionet e Kuvendit të Kosovës? A duhet që çdo herë në këto deklaratat jashtë rendit të ditës, ne të ngremë çështjen e mosrespektimit të vendimeve të Kuvendit nga ana e Qeverisë?

Kryetar, po e themi qartë, se kjo situatë tash vërtetë ka rënë nën nivelin minimal të përgjegjësisë, që duhet ta ketë Qeveria në raport me Kuvendin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovën e RE, dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj lidhur me Ligjin mbi festat shtetërore dhe festat e tjera. Ky ligj ka dhënë norma shumë gjeneroze jo vetëm me numrin e madh të ditëve festive, që janë përcaktuar, por edhe me ditët e pushimit. Gjithashtu, është me rëndësi një fakt, që besoj se duhet të korrigjohet, ky ligj ka një zgjidhje të papërshtatshme, lidhur me situatën kur ditët e festave bien të shtunave ose të dielave. Sipas këtij ligji, këto ditë pushimi vazhdon të hënave e nganjëherë edhe të martën. Nëse do t'i mblidhnim të gjitha ditët festive, Kosova do të dilte një nga vendet me më së shumti ditë pushimesh. Kjo ndikon keq, sidomos në institucionet arsimore, në shkolla dhe universitete. Këtë semestër janë humbur shtatë të hëna, që do të thotë, studentët që kanë pas të hënave mësim, ata mund të kenë humbur gjysmën e programit mësimor.

Duke u nisur nga kjo situatë e tillë, Koalicioni për Kosovë të Re propozon, që ky ligj të shqyrtohet në dy aspekte.

1. Që kur festat bien të shtunave ose të dielave, pushimi mos të zgjatet të hënën ose ditëve tjera. Një praktikë të tillë kohëve të fundit e ka vënë edhe Shqipëria, por e kanë edhe shumë e shumë vende tjera.

2. Që festat nacionale, etnike dhe fetare të vlejné vetëm për komunitetin përkatës, kurse festat shtetërore apo në përgjithësi në nivel të vendit për të gjithë.

Prandaj ne dëshirojmë që me këtë paraqitje, të iniciojmë një aktivitet, nuk po shoh këtu ministrat përkatës, të Shërbimeve Publike ose të Punës, por këtu janë zëvendëskryeministrat dhe ministrat tjerë dhe ju kishim lutur, që kjo çështje të shqyrtohet në Qeveri dhe të gjendet një zgjedhje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputetja, Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe ju kolege deputete,

Ajo që më ka shtyrë sot që ta marr fjalën, është një komunikatë e lëshuar për media nga Termokosi, që është lëshuar më datën 19.01.2012, ku apelon edhe një herë tek të gjithë konsumatorët, që të bëjnë, thjesht që të paguajnë faturat e borxhit të mbetur.

Sipas të dhënave zyrtare, orari i ngrohjes nga Termokosi zgjatë nga ora 6 e mëngjesit dhe vazhdon deri në orën 22, kurse, ne të gjithë jemi dëshmitarë, që shërbimet e Termokosit, kanë qenë minimale. Ka pasur ngrohje vetëm në dy-tri orët e para të mëngjesit apo herë-herë, ka ndodhë që ngrohje të mos ketë me ditë dhe javë të tëra. Dhe, krejt çka qytetarët kanë marrë nga Termokosi, kanë qenë faturat, të cilat janë faturuar pa qenë, nganjëherë edhe shfrytëzues absolut të Termokosit.

Për shembull, kemi rastin kur një qytetar i Kosovës, ka blerë banesë në Prishtinë dhe për momentin jeton në një qytet tjetër të Kosovës, ai faturohet pa qenë shfrytëzues i Termokosit dhe faturohet rregullisht. Duke pas parasysh që nga mungesa e shërbimeve të mirëfillta nga Termokosi, qytetarët janë të detyruar të paguajnë shpenzime të dyfishta, në njërin anë duke i paguar fatura të rregullta Termokosit, në anën tjetër duke paguar kilovatët e energjisë elektrike që kanë shpenzuar për t'u ngrohur.

Unë apeloj tek udhëheqësit e Termokosit dhe nga përgjegjësit komunalë të Prishtinës, që ta ndalin praktikën e faturimit paushall dhe ta kursejnë qytetarin nga plaçka që po i bëhet çdo ditë, duke faturuar faturat e papërbalueshme për shërbimet që asnjëherë s'i marrin.

Në një dokument në ueb-faqen e Termokosit thuhet se faturimi bëhet për një pajisje matëse të energjisë, nëpër stacione termike, në bazë të cilave vërteton energjinë të cilën e ka dërguar tek konsumatorët, nga ku bën faturimin e tyre, bazuar në ato të dhëna. Por, kjo nuk qëndron, sepse të vetmin shërbim që e marrin konsumatorët nga Termokosi, janë faturat, të cilat asnjëherë nuk vonohen.

KRYETARI: Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dua t'i ndaj me ju disa çështje, që kanë të bëjnë me menaxhimin e Policisë dhe rolin e saj, e kësaj organizate në muajin e parë të këtij viti.

Më 14 dhe më 22 janar, Qeveria përdori Policinë si mekanizëm dhune, duke keqpërdorur dhe duke dëmtuar rëndë reputacionin e kësaj organizate. Gjithsesi, barra kryesore e përgjegjësisë nuk bie mbi policët të cilët zbatonin urdhra, por mbi ata që jepnin urdhra për ushtrim dhune ndaj protestuesve. Me rastin e urdhrin për përdorimin e forcës, u shkel dokumenti i quajtur "koncepti për ballafaqimin e turmave", ky dokument pra, dokument i miratuar dhe i nënshkruar nga menaxhmenti i Policisë në tetor të vitit 2010.

Ky dokument u hartua nga Policia e Kosovës, me kontributin e drejtpërdrejtë të shumë ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Po ashtu, burimet ligjore të këtij dokumenti janë: Kushtetuta e Kosovës, Ligji mbi tubimet, Kodi Penal i Kosovës, Kodi i procedurës penale dhe Ligji i Policisë. Duke shkelur këtë dokument, më 14 janar policia u shty të veprojë në kundërshtim me procedurat për menaxhimin e turmave dhe në kundërshtim me moralin e shumicës së policëve.

Në kapitullin e tretë të këtij dokumenti, që ka të bëjë me kontrollimin e turmave të qeta thuhet: "Policia e Kosovës, e angazhuar për sigurimin dhe kontrollimin e turmave, shumë shpesh do të ballafaqohet me turma, të cilat janë të qeta dhe për këtë arsye do të duhet të veprojë duke iu përshtatur situatës në terren. Në rastet kur informatat thonë se protestat do të jenë të qeta, nuk është e arsyeshme ta paraqesim forcën." Mbaron citati.

Inspektorati i Policisë së Kosovës, duhet ta konstatojë, ta vlerësojë dhe të marrë masat e duhura ndaj përgjegjësve, që tejkaluan mandatin e tyre policor dhe jo të kthehet në

instrument të ushtrimit të dhunës me arrestime të paligjshme nga ana e inspektorëve të hetuesisë së këtij inspektorati.

Me 14, e sidomos me 22 janar, Kosova ishte edhe nën presionin e propagandës qeveritare kundër protestës së lëvizjes “Vetëvendosje” me deklarime të pasakta të ministrit dhe zëdhënësit të policisë. Më lejoni t’i shkëpus disa prej tyre.

Më datën 23, në edicionin e lajmeve të orës 22,00 në Radiotelevizionin 21, ministri i Brendshëm deklaroi se nuk është konfiskuar asnjë mjet nga organizatori i protestave. Faktet e demantojnë të kundërtën. Këtu i kam edhe faturat dhe dokumentet e konfiskimeve të mjeteve të konfiskuara. Pra, në Besianë, më datën 22, dokumenti, procesverbali 09001072, mbi konfiskimin e asortimenteve pyjore.

Dokumenti tjetër, lista e provave materiale me numër KI 7236. Gjilan 22 janar, dokumenti vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm me numër të rastit, pa numër, të datës 22.1.2012, ku janë gjithsej, përkatësisht 46 artikuj, 54 artikuj dhe një artikull tjetër.

Të gjitha këto ishin artikuj logjistikë duke përfshirë gjeneratorë, pajisje për akomodim, ushqime dhe pajisje tjera të domosdoshme përballimin e protestuesve në temperatura të ulëta.

(Ndërprerje e zërit nga mikrofon)

KRYETARI: Në emër të Grupit, edhe dy minuta!
Lajmërohuni kur jeni në emër të Grupit.

REXHEP SELIMI: Përveç urdhrit për konfiskim ishte tendencë për ta sabotuar dhe pamundësuar protestën, po ashtu edhe deklarimi i së kundërtës nga ana e ministrit, përbën një shkelje dhe abuzim me detyrën. Pasaktësitë u shfaqën edhe te zëdhënësi i policisë, një oficer, tashmë i instrumentalizuar nga Policia.

Në lajmet e orës 19:30, zëdhënësi i Policisë deklaroi se numri i protestuesve është dukshëm më i vogël dhe po vjen duke u zvogëluar. Po ashtu në emisionet tjera, qoftë në RTK, në 21 dhe në KTV dhe në shumë deklarime të ngjashme, zëdhënësi i Policisë u kthye në zëdhënës të Qeverisë, duke qenë në shpërputhje me mandatin e tij zyrtar.

Duke dashur me këmbëngulje ta mbrojmë institucionin e Policisë së Kosovës, t’i mbrojmë policët dhe oficerët e Policisë së Kosovës dhe autoritetin e tyre, që kanë në shoqërinë tonë, kërkojmë nga Qeveria e Kosovës dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, që të mos e përdorë Policinë për nevoja politike, partiake, por ta ndihmojë atë duke mbështetur në misionin dhe kompetencat, që ka policia e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,
Të nderuar deputetë,
Dëshiroj ta shpreh brengën time për fatin e monumentit më të rëndësishëm të natyrës, i cili ndodhet në Shpellë të Gadimës, domethënë, për vetë Shpellën e Gadimës.

Ne kemi pasur një shqetësim për këtë monument për faktin se atje operojnë katër operatorë, të cilët janë të licencuar e që merren me problemin e prodhimit të rërës nga gurët. Po ashtu, kuvendi komunal ka vendosur mbi Shpellën e Gadimes një depozitë të madhe, e cila realisht mund të jetë një rrezik për Shpellën e Gadimës.

Kohëve të fundit morëm vesh se aty, që nga viti 2006 është e vendosur një depo e madhe e eksplozivit, në të cilën sipas banorëve lokal, mund të ketë deri në 100 tonë materie eksplozivi, pasojat e rrënimit të cilave askush nuk i di. Ndërsa, më e reja tash kohëve të fundit, sipas banorëve lokal, atje qenka duke u ndërtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, një depo e materialeve të rrezikshme, për të cilat banorët lokal realisht nuk janë të informuar se për çfarë materialesh kanë të bëjnë.

Dëshiroj ta theksoj faktin se ky është një monument i rrallë, jo vetëm në Ballkan, por është më i rralli, është bukuroshja e Kosovës, për të cilën ndoshta është mirë që të ketë institucionet përkatëse të kenë kujdes më të madh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë, unë do të flas për një çështje, që mendoj që duhet të jetë preokupuese për secilën prej nesh, kam fjalën për gratë deputete, por edhe për secilën grua, kudo që ndodhet.

Në fletoret për planifikim ditor, të cilat Kuvendi i Kosovës ua shpërndau të gjithë deputetëve, sapo e hapa fletën e parë, vërejta se në fund të fletës ka të shkruara fjalë të urta. Kjo më zgjoi kureshtjen dhe fillova t'i lexoj në secilën faqe. Kur arrita te muaji maj, vërejta se secila fjalë e urtë, gjatë tërë këtij muaji, ka të bëjë me gruan dhe për më keq, në kontekstin më negativ të mundshëm. Nuk e di se kush e ka bërë përzgjedhjen e këtyre fjalëve të urta dhe se cili ka qenë qëllimi i tyre, që t'i edukojë deputetët në këtë frymë, që t'ua rikujtojë deputetëve se cili është koncepti shovinist mashkullor dhe seksist për gruan apo ndoshta thjerrëza përmes duhet parë koleget deputete? Të gjitha thëniet më poshtëruese për gruan, që i kam dëgjuar ndonjëherë, të përmbledhura në një vend, i gjeta në fletoret e punës, të cilat na i ka shpërndarë Kuvendi i Kosovës. Pra, ky përkufizim i gruas, pakë a shumë i bënë të qarta qëndrimet e disa personave, si për shembull, deputetit Halit Krasniqi, zëvendësministrit Ilir Mirena, por edhe të zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi, të cilat janë qëndrime paragjyquese dhe fyese ndaj gruas.

Përkufizime të tilla për gratë janë në secilën thënie, që disa prej tyre edhe dua t'ua lexoj, më shumë për hir të opinionit të gjerë, që të shohin se si e definojnë gruan institucionet e vendit.

- Heshtja është ari i vetëm që kanë femrat.
- Heshtja dhe modestia janë stolia më e bukur e gruas.
- Te femra gjithçka është zemër, bile edhe koka.
- Luleve u nevojitet dielli, kurse femrave dashuria.
- Gruaja është enigmë, qëllimi i saj është fëmija.
- Gratë nuk zbukurohen aq shumë për meshkujt sa kundër grave.
- Thirreni gruan si të doni, por asnjëherë jo si nënë.

Andaj, këto fletore me gjithë këto thënie të përzgjedhura nga dikush prej jush do t'ua kthej mbrapsht me keqardhjen për nënçmimin e nivelit të deputetëve dhe shpenzimit të parasë publike, në mënyrën më të keqe të mundur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Rita Hajzeraj Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për deputetët,

Po i drejtohem ministrit të Financave.

Ju e dini që kohëve të fundit po mbretëron një mot jashtëzakonisht i ligë dhe duhet ta dini që situata e familjeve dhe popullatës në komunën e Istogut, Pejës dhe Klinës, është përkeqësuar dukshëm. Ju e dini që shumë familje kanë mbetur pa kulm mbi kokë. Zoti ministër, ne ju kuptojmë juve dhe Qeverinë e Kosovës, mirëpo, është një shumë aq simbolike prej 400 mijë euro, krahasuar me dëmet që i ka shkaktuar situata e jashtëzakonshme, pra moti i ligë.

Ne kërkojmë nga ju që ta merrni këtë çështje më seriozisht dhe të dilni në terren, t'i shihni ato familje se sa po heqin dhe të keni një konsideratë më të madhe për to, sepse, ne kemi raste tjera, që ju keni dhënë shuma për shtete tjera dhe plotësisht e vlerësojmë këtë gjest tuajin, që keni dhënë ndihma, mirëpo, sa i përket popullatës tonë, popullatës shqiptare, duhet të kemi kujdes më shumë, sepse ato familje sot janë pa kulm mbi kokë. Andaj, shuma që është dhënë, krahasuar me shuma të tjera të ministrave dhe kryeministri, që marrin kredi për ndërtimin e shtëpive, kushtojnë barabartë me shumën e cila i është ndarë këtyre tri komunave.

Pra, vlerësoni se a mund të krahasohen të tri komunat me shumatat e kredive të një shtëpie të një kryeministri apo një ministri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ka kaluar koha për deklarime jashtë rendit të ditës.

Unë për hir të korrektësisë dua të kërkoj nga deputetët që kjo pikë e rendit të ditës është menduar për çështje që nuk hynë në rend të ditës dhe janë në interesin e qytetarëve. Nuk është pika e rendit të ditës, as për pyetje për Qeverinë, as për pyetje për deputetët dhe

kisha kërkuar që vërtet këtë pikë të rendit të ditës ta shfrytëzoni ashtu siç duhet dhe ashtu siç është interesi i qytetarëve të Kosovës. Vazhdojmë.

Koha për pyetje parlamentare.

Në pajtim me nenin 45 pika 1 e Rregullores së Kuvendi, koha për pyetjet e deputetëve, për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrajnë më së shumti dy pyetje, por sot i kemi krejt dy pyetje dhe këtu nuk i kemi asnjërin nga ministrat, deputetët kanë drejtë ta lexojnë pyetjen.

Deputeti i parë është Arsim Bajrami, pyetje për ministrin Mahir Jagxhillar.

A doni ta lexoni pyetjen?

ARSIM BAJRAMI: Jo, po e barti për seancën tjetër.

KRYETARI: E drejta e deputetit është edhe ta lexoj pyetjen, drejt dy herë, madje nëse s'vjen pastaj botohet. Nejse, është çështje e deputetëve.

Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Ramë Buja.

Deputete a doni ta lexoni pyetjen?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

E shikoj që ministri nuk është këtu, por pavarësisht nga kjo unë pyetjen do ta lexoj. Para pak kohësh kemi parë në shtyp që ministri ka folur për një plan ose ka proklamuar një plan sipas të cilit në vitin e ardhshëm ose në shtatorin e vitit të ardhshëm, Ministria do të mundohet që të hartojë tekste të integruara, që do të thotë disa lëndë të integrohen në një lëndë. Ky është projekt goxha ambicioz dhe kërkon një punë shumë të madhe dhe përgatitje, ndërsa në Kosovë ka mungesa elementare si p.sh. klasa të pamjaftueshme për nxënësit, mësues të pakualifikuar për lëndët e tyre, numër tepër të madh të nxënësve nëpër klasa, kam mësuar që ka edhe klasa ku 60 nxënës, në shpërprurje të plotë me standardet e mësimdhënies kjo dhe bile- bile jemi në një situatë kur bëhet fjala për hartimin e teksteve Ministria e Arsimit nuk ka arritur akoma që të hartojë një abetare të mirë për nxënësit e klasës së parë.

Prandaj, pyetja ime është se çfarë përgatitjesh konkrete ka bërë Ministria e Arsimit për të realizuar një projekt të tillë aq të madh dhe a është kjo në përputhje me programin qeveritar i cili së paku në planin afat mesëm parashihet projekte krejt të tjera për zhvillimin e arsimit dhe sa para janë ndarë për hartimin e teksteve të integruara sipas ministrit dhe kur do të fillojë ky proces? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Me këtë pyetje të deputetes përfundon pika e dytë e rendit të ditës, pyetje parlamentare për Qeverinë.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20 dhe 23 janar 2012

A ka vërejtje në këtë procesverbal?
Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është një vërejtje për sekretarinë që ka hartuar procesverbalin. Në të vërtetë, nëse krahasohet transkripti i mbledhjes dhe procesverbali, atëherë shihet se faqja 39 dhe 40 e transkriptimit, është në kundërshtim me faqen 5 të procesverbalit, nuk shpreh atë çfarë deputetë kanë vendosur dhe kanë marrë vendim. Dhe, unë i sugjeroj sekretarisë që ta shqyrtojë autocintetin e këtij stenogrami dhe ta përshtat vendimin konform stenogramit të mbledhjes. Faleminderit!

KRYETARI: A ka ndonjë vërejtje tjetër?

Të nderuar deputetë,

Ju e dini mënyrën e funksionimit të komisioneve dhe kur diçka kalon në ligj, komisionet kanë afat brenda dy muaj t'i dorëzojnë raportet me rekomandime, ashtu e parasheh Rregullorja.

Vazhdojmë.

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalin e mbajtur, më 20 dhe 23 janar 2012.

KRYETARI: Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse janë pika të rregullta ato, në rend të ditës kam menduar kur të hyjmë në rend të ditës shqyrtimet ta them atë që po paraqes në emër të Grupit Parlamentar. Ne kërkojmë që nga rendi i ditës të hiqet pika e 12 -**Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti**. Ka shumë arsye dhe shumë shkurt po mundohem t'i them ato kryesoret. Konsiderojmë që është një ligj, gjegjësisht një projektligj shumë diskriminues dhe merreni prej nenit 21 veçmas po i përmend dhe deri 26, shkelet dinjiteti dhe integriteti i pensionistëve në shumëçka dhe për shumëçka në këtë projektligj.

Konsiderojmë që ka shumë çështje të cilat nuk rregullohen si duhet dhe meqenëse po kërkojmë të hiqen nga rendi i ditës, nuk po dëshiroj ta elaboroj më shumë, por ka shumë arsye që ky projektligj të hiqet, sepse është vetëm për t'u hedhur pluhur syve qytetarëve, po edhe pensionistëve. Nëse në mos asgjë tjetër thuhet që ky projektligj ose ligj hyn në fuqi në vitin 2016, atëherë pse e nxjerrim tash, për çka? Ligji bëhet për të pasur përfitime dhe benificione që këta njerëz që ia kanë kushtuar shekullin e jetës punës edhe familjeve dhe ne themi mes të tjerash që është më kryesorja në fund që kjo do të shkojë dhe do të

hyjë në fuqi, do të zbatohet në vitin 2016 dhe absolutisht për ne edhe shumë çështje të tjera janë shumë të kontestueshme, nuk bëhet kategorizimi i pensionistëve, janë futur sa për sy e faqe disa kategori gjoja se të reja, por përsëri pa kurrfarë përfitimi.

Andaj, konsideroj që jo vetëm që e kanë bërë një peticion edhe ua kanë dorëzuar edhe juve zoti kryetar, por kanë shumë arsye dhe arsyeshmëri në atë që thonë dhe unë në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkoj që ky projektligj të kthehet në ripërpunim në Qeveri të Kosovës edhe aty pse jo të japin kontributin e tyre edhe vetë këto shoqata me përfaqësues edhe ne të tjerët, sepse kemi shumëçka të themi andaj kërkoj që mocioni, në këtë rast kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së të hidhet në votim që ky projektligj të tërhiqet sot nga rendi i ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani kolege ministri, zamenici premijera,

Dame i gospodo, narodni poslanici.

Zakon koji ste pomenuli o penzijama financirane od strane države, je zakon na kojem se radilo najmanje 3 godine. On predviđa, kao što ste rekli tačno za dve nove grupe u 2016-oj godini, a i da bi ... proces koliko je i bitan i koliko nam je trebalo da dođemo do ovoga, su stalna insistiranja pre svega bila i od strane nekih određenih organizacija i udruženja penzionera, koji su bili protiv, a nisu se pomenuli oni koji su i za ovaj nacrt projekta zakona i pored toga što zakon kad bude ušao na snazi, ja sam hteo danas i da vam preporučim, kao što ću i raditi da će u zakonu postojati da on bude na snazi od 1 januara 2012.godine. ove godine, a kategorizacija bi bila urađena u narednih dve godine zbog, čisto tehničkih i detaljnih stvari, kao što su provera svih dokumenata, koji bih svako od penzionera, onih pogotovu koji su platili doprinos, trebali da dostave, i njihova verifikacija. To je proces koji nije lak, ali sigurno ovaj zakon kad bi bio usvojen, kao što će pretpostavljam, biti stvoreni uslovi za usvajanje, pre svega obezbediti jedno povećanje, koje bi u slučaju ljudi koji su svoj životni vek dali doprinos za budžet kroz institucije Kosova, dobili povećanje od 26,5% dok bi kategorizacija kad bi bila napravljena kroz 2 godine to povećanje je minimum penzija, koja bi u daljem toku, moglo da se kategorizuje od broja ... ne znam, 1 prema do 1,5 koliko već bude bilo.

Prema tome zakon, garantujem vam da posle stotinu sastanaka sa svetskom bankom ... fondom i usaglasnošću sa pismom o dobrim namerama koje je potpisano od strane premijera, je absolutno korigovano, odnosno, u skladu sa tim. Ispunili smo sve tehničke forme, ovo bi omogućilo samo početnu fazu. Pored toga zakon bi omogućio tu dinamiku koju bi bili u stanju da stvorimo kroz, odmah kroz dve godine. I ja sama već razgovarao sa udruženjem penzionera, kojima je već rečeno da od usvajanja zakona, odmah su počeli da budu deo tehničke koje će raditi na kategorizaciji, koja opet ponavljam bi bila završena u roku od dve godine, i time bi se stvorili uslovi za bolje poboljšanje i dalje povećanje.

KRYETARI: Deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për deputetët,

Meqë jam kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat të Zhdukur dhe Peticione e shoh të arsyeshme t'i njoftoj deputetët se në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, do të thotë me pikën 12- Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, dje Komisioni ka marrë peticion të nënshkruar nga 15 mijë e 267 qytetarë dhe meqë peticionin e kemi marrë me vonesë, nuk kemi mbërri të njëjtën ta shqyrtojmë. Të njëjtit kërkojmë që ky projektligj t'i kthehet prapë në ripunim Qeverisë për shkak të diskriminimit dhe papranueshmërisë së këtij projektligji dhe e pash të arsyeshme t'i njoftoj deputetët në mënyrë që të njoftohen në lidhje me mocionin dhe të vendosin në lidhje me mocionin e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Kurtan Kajtazi e ka fjalën.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Meqenëse Koalicioni i Pensionistëve të Kosovës e ka shtruar një peticion dhe ju ka drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Peticione, ai peticioni akoma s'është shqyrtuar edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është që të shtyhet ky projektligj derisa të shqyrtohet peticioni. Mirëpo, vetëm desha ta demantoj shefin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike se ligji nuk hyn në fuqi në vitin 2016, por janë dispozitat e nenit 10,11 dhe dispozitat e nën paragrafit 3.2. dhe paragrafit 3, dispozitat e paragrafit 4 të nenit 12, që është fjala për kushtet edhe kriteret për njohjen e të drejtës së punës për pension invalidor dhe kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pensionin familjar si dhe disa dispozita tek beneficionet për pensionin bazik të moshës dhe pensionin e parakohshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kërkon që ky projektligj të shtyhet. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Ismet, a deshe fjalën?

ISMET BEQIRI: Kryetar, kërkoj ndjesë nga kolegët edhe njëherë, kërkesa ishte shumë e qartë që projektligji t'i kthehet Qeverisë, ndërkohë kryhen këtu punët, a mbahet, komisioni mban mbledhje e shqyrton, ajo është çështje tjetër, t'i kthehet dhe unë nuk dëshiroj të polemizoj por po i them zotit Kurtan, që pikërisht ato dispozitat që ky i ceku janë kryesore dhe tjerat janë llafe, janë fjalë dhe janë letër e pavlefshme. Nëse ato nuk hyjnë në fuqi atëherë ligji s'e ka as arsyeshmërinë. Prandaj, zoti kryetar veç desha me u sqarua që pikërisht janë këto arsyt, ato dispozitat që vetë i lexoj zoti Kajtazi që e bëjnë këtë ligj të pavlefshëm edhe të padobishëm edhe pa interes për ata për të cilët është

dedikuar. Andaj shpresoj në mirëkuptimin e kolegëve që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë dhe të bëhen përmirësimet e nevojshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Mendoj se s'po e zgjatim më shumë se ju e dini që me votim duhet të hiqet prej rendit të ditës, por gjithnjë për hir të korrektësisë rekomandimi i Komisionit për Shëndetësi ashtu miratohet në parim Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti. Kjo është rekomandimi, ju lutem, unë po flas për rekomandimin e komisionit dhe unë jam dakord që pas petitionit ta shikojmë dhe atë jemi dakord.

Nga "Vetëvendosja" Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Së pari mendoj që e kemi praktikuar këtu në Kuvend zakonisht që pasi që të ngritët mocioni deklarohen shefat e grupeve parlamentare me rend, këtë herë nuk shkuam ashtu s'pe di pse, po s'ka lidhje. Edhe Grupi Parlamentar i lëvizjes "Vetëvendosje" konsideron që ky ligj duhet t'i kthehet Qeverisë, pra e përkrah mocionin e ngritur nga Grupi Parlamentar i LDK-së, jo të shtyhet siç u përmend këtu, por t'i kthehet Qeverisë për t'u ripunuar për shkak të diskriminimit në të dhe për shkak që ky ligj në asnjë mënyrë nuk i plotëson as nevojat, as kërkesat e pensionistëve të Kosovës.

Këta janë një kategori shoqërore të cilët janë gënjyer më së shumti këtu në Kosovë prej vitit 1999 e tutje, nuk ka instancë e pushtetit që nuk i ka premtuar atyre se do t'ua përmirësojë pozitën, gjë që nuk ka ndodhur kurrë dhe tash e dëgjuam ministrin se takime kryesore që i ka pasur janë me Bankën Botërore dhe FMN, po jo me pensionistët, ndërkohë që ky ish dashur të jetë ministri i cili i takon pensionistët, punëtorët e kështu me radhë, meqenëse e mbulon atë. Pra, shihet që kjo Qeveri në fakt nuk interesohet fare se çfarë thonë qytetarët e Kosovës dhe çka kërkojnë qytetarët e Kosovës, po vetëm çfarë thonë të tjerët jashtë Kosovës. Dhe kjo është për të ardhur keq.

Është interesante se si në Kosovë ka para për gjithçka, ka para për t'ia përmirësuar bilancin vjetor Bechtellit, ka para për veturat e shtrenjta të ministrave, kryeministrit e kështu me radhë, ka para madje për dreka e darka të shtrenjta, për privilegje të jashtëligjshme dhe jashtë kushtetuese për deputetët, por kur vjen puna te qytetarët e Kosovës, të cilët jetojnë në varfëri, atëherë kurrë parat nuk po gjinden. Dhe unë mendoj që këtu ish dashur të bëhet diçka nga kjo Qeveri që ato para që i kemi, këtë pasuri që e kemi të këqyrim ta ndajmë në mënyrën më të drejtë dhe më të barabartë për shkak se ato janë pasuri dhe paratë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, nuk janë vetëm të disave. Faleminderit!

KRYETARI: Ne e kemi një kërkesë dhe realisht nuk është mirë gjithçka ta shfrytëzojmë për politikë se sigurisht që nuk ka deputetë që nuk dëshiron që për pensionistët dhe për gjithë qytetarët e Kosovës, të ketë të ardhura për një jetë më të dinjitetshme, por kulaçi është ai që është dhe s'mund ta zmadhojmë.

Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Desha vetëm dy çështje t'i theksoj, nëse është mendimi që duhet t'i kthehet Qeverisë, atëherë duhet Qeverinë ta afatizojmë deri kur ai të kthehet, zhargitja është në dëm të njerëzve. Një konstatim i dytë është, në veçanti zoti Ymeri tash e potencoi se bisedohet me të huajt, unë i them se nuk është biseduar as me të huajt, zoti ministër, sepse po t'i merrni standardet e Bankës Botërore dhe FMN-së ju nuk keni të drejtë të paguani asnjë pension ndër 112 euro, urdhëroni merrni listën e domosdoshme, 45 artikuj i keni. I keni sasi të shumëzime me çmimin dhe e keni këtë. Skema pensionale kur është vendosur ka qenë adekuate, është diskutuar një debat shumë i gjerë vetëm për 30 fining, a të rrumbullakohet në 40 apo të mbetet 39.7. ndërsa, ju tani paguani 45 që me vite është dëmtuar kjo shtresë e njerëzve?

Qeveria e ka plotë gojën, kem rritur pagat 50%, por pensionistët i keni lënë në fund të pusit dhe kjo zhargitje i dëmton ata njerëz. Unë nuk po hy në pozicionet tjera të veçanta atje ku ka diskriminim, sepse e thanë kolegët edhe besoj që kur të vjen në ligj do të bisedojmë për çdo nen.

Por, nuk është biseduar sepse këto standarde janë të Bankës Botërore dhe të FMN, jo të juaja. Urdhëroni, atë zbatoni jo realisht në një mënyrë bukur të mirë i plotësonin nevojat dhe kërkesat që sot i kanë pensionistët.

KRYETARI: Unë veç dua t'ju sqaroj tash që këtu i kemi edhe një korrigjim të kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së, e bëri deputeti Kurtan Kajtazi. Një gjë është, Komisioni ka thënë të miratohet, kemi petitionin që u tha të shtyhet derisa të shqyrtohet peticioni. Nëse e qesim në votim kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së për t'ia kthyer Qeverisë, ky ligj do të vonohet shumë dhe tash a po e shtyjmë deri ta shqyrtojmë mocionin, apo po shkojmë në votim, nuk ka nevojë nëse nuk tërhiqesh nga mocioni unë po e qes në votim dhe nëse fiton.

Kërkesa juaj është t'ia kthejmë dhe kemi dy mocione, nëse nuk shkon mocioni i parë, atëherë shkojmë te i dyti. Kërkesa e grupit..., jo nuk ka nevojë absolutisht s'ka nevojë kurrkush më.

Unë jam i bindur që ju jeni konsultuar me FMN-n dhe Bankën Botërore, por megjithatë e kemi një mocion dhe na si Kuvend duhet të vendosim për këtë. Kush është "për" mocionin e Grupit Parlamentar të LDK-së që ligjin t'ia kthejmë Qeverisë?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Prezent janë 79 deputetë, 41 kanë votuar "për", 28 vota "kundër", 2 abstenime. **Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti i kthehet Qeverisë, për ripunim.**

A ka ndonjë mocion tjetër?

Vazhdojmë me pikën e 4 të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin zoti Bujar Bukoshin, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë projektligjin.

BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Kabinet qeveritar,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para jush në pika të shkurtra ta paraqes Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër, të miratuar nga Qeveria, më 23 nëntor të vitit 2011.

Ky projektligj cakton rregullat për sigurimin e bazës ligjore, për mbrojtjen e të drejtave elementare të një kategorie të personave me aftësi të kufizuara. Me këtë projektligj rregullohet statusi i personave të verbër dhe personave pjesërisht të verbër, rregullohen të drejtat dhe përfitimet, si dhe përcaktohen kriteret për kategorizimin e personave të verbër dhe atyre që janë pjesërisht të verbër. Kështu këta persona mbrohen nga diskriminimi dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët, bazë kjo e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Po ashtu me këtë projektligj rregullohet vendstrehimi sigurimi shëndetësor, arsimimi, pushimi dhe mirësitë e tjera për personat e verbër dhe për personat pjesërisht të verbër. Projektligji përcakton kushte të favorshme edhe me përparësi për punësim që bazohet në Ligjin për aftësimin dhe riaftësimin profesional, si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe ligjet e tjera në fuqi. Para dhe gjatë hartimit të këtij projektligji janë bërë hulumtime dhe konsultime të gjëra nga natyra e kësaj fushe. Ky projektligj është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Bashkimit Evropian.

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Ju propozoj që këtë projektligj ta miratoni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisioni kush e do fjalën?

Në emër të Komisionit deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, në cilësi të komisionit funksional, në takimin e datës 18 janar 2012, shqyrtoi në parim Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër dhe vlerësoi se në aspektin përmbajtësor i plotëson kushtet e përcaktuara me rregullat e hartimit të legjislacionit, si dhe kushtet e caktuara me Rregulloren e Kuvendit. Lus deputetët që në parim ta përkrahin këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në emër të Grupit të Partisë Demokratike, deputeti Kurtan Kajtazi e ka fjalën.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër. Me këtë ligj, përveç që rregullohet statusi dhe përfitimet të personave të verbër dhe pjesërisht të verbër, gjithashtu mbron nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët, bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut e ka shqyrtuar Projektligjin për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër dhe në aspektin përmbajtësor i plotëson kushtet e përcaktuara me rregull të hartimit legjislativ, si dhe kushtet e përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit. Është konform ligjeve të BE-së, andaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, kush e do fjalën?

Deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse pak me vonesë ne e përkrahim këtë projektligj, në parim në leximin e parë. Konsiderojmë se ky projektligj ka mangësi, mirëpo me punën e Komisionit funksional dhe deputetëve tanë në komisionet adekuate të cilat do të punojnë këtë projektligj, do ta japin kontributin e tyre.

Unë konsideroj që ky projektligj nuk ka implikime financiare të cilat janë paraqitur këtu, andaj do të takohemi edhe me shoqata të verbërve të Kosovës që të na sugjerojnë se si ta ndryshojmë dhe ta plotësojmë në favor të tyre, pra që ligji të jetë më kompetentë dhe më i plotë për interesat e të verbërve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të “Vetëvendosjes” kush e do fjalën?

A je lajmëruar Albanë? Po, mirë se s’po e shoh emrin, ka qenë më poshtë. Deputetja Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Lëvizja “Vetëvendosje” ka shqyrtuar Projektligjin për personat e verbër dhe për personat pjesërisht të verbër dhe kemi vërejtje në disa nene të këtij projektligji.

Tek neni 6, lirimi nga taksat dhe tatimet, ku thuhet që personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private, si persona juridik. Këtu mendojmë se nëse një i verbër dëshiron të merret me ndonjë veprimtari, të marrim shembull një punëtor ose diçka

tjetër, në këtë rast duhet të subvencionohet dhe jo t'i vendoset taksa. Pra, shteti duhet ta ndihmojë në veprimtarinë e tij dhe jo të përfitojë nga ai.

Neni 7, pika 2- përfitimet materiale për shkak të verbërisë i takon kujdestarit të verbrit të kategorisë së parë të cilin e zgjedh ai.

Po ashtu, tek neni 8 pika 2, ku thuhet që personat e verbër nënshkruajnë kontratë me kujdestarët e tyre, para organit kompetent, pra noterit dhe ia paraqesin nëpunësit të organit kompetent. Mendojmë që kjo është një qasje e gabueshme, ngase i verbëri nuk mund të ketë një njeri për 24 orë që ta kujdestarojë. Kompensimi që jepet për kujdestarët duhet të shkojnë në emër të verbrit, shumë kjo që i verbëri mund ta ndajë me shoqëruesin apo shoqëruesit e tij.

Neni 11, pika 3- edukimi dhe arsimimi. Rekomandojmë që pajisjet tifo-teknike dhe tifo-didaktike të cilat lehtësojnë integrimin e personave të verbër dhe personave pjesërisht të verbër tu lehtësohet importi pa doganë.

Neni 15.1, ku thuhet: “Të gjithë personat e verbër dhe pjesërisht të verbër, gëzojnë lehtësira në konsumin e energjisë elektrike sipas Ligjit të skemës sociale”. Këtu është dashur të ceket se sa përqind do të jetë lehtësimi në konsumin e energjisë ashtu siç është bërë edhe tek neni 14, pra tek udhëtimi, ku transporti ndër-urban bëhet me 50% të vlerës së biletës. E njëjtë gjë është dashur të ceket edhe te ky nen për të mos lënë hapësirë manipulimi.

Neni 18.5. Personi i verbër, i grupit të parë, duhet të deklarojë emrin e kujdestarit të tij ose të saj para shërbyesit kompetent që e regjistron atë në një regjistër të posaçëm. Po ashtu ai duhet të deklarojë edhe ndërrimin e kujdestarit. Me këtë ndërrim ju ftohet menjëherë edhe administrata e ministrisë përkatëse.

Mendoj që ky nen është i egzagjeruar nga se e tërë kjo procedurë burokratike është shumë e mundimshme dhe e panevojshme e sidomos kur kemi parasysh faktin se për çfarë kategori njerëzish bëhet fjalë. Kjo vetëm sa e vështirëson jetën e tyre dhe e kundërta e asaj se çfarë synon ky ligj.

Dhe te neni 21, ku thuhet që “Qeveria, varësisht nga mundësitë nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacionit eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë do të vendosë për lartësinë e shumës së benificionit të përcaktuara me këtë ligj”. Në këtë rast Qeveria është e obliguar të planifikojë paraprakisht buxhetin sikurse edhe për ligjet të tjera e jo t'i lihet rastit apo mundësisë për manipulim.

Në një rast të tillë sikur që është paraqitur në këtë nen, atëherë kemi të bëjmë me një ligj jo serioz, një ligj i cili nuk ka për qëllim përkrahjen e kësaj kategorie të ndjeshme të njerëzve, por vetëm një ligj i cili do të mbetet në arkiva por që nuk do ta lehtësojë jetën praktike të të verbërve me nevojë.

Dhe për fund Lëvizja Vetëvendosje do ta votojë në parim këtë projektligj në mënyrë që vërejtjet që i dhamë të merren parasysh në Komision.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja, Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi parlamentar i AAK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për persona të verbër dhe personat pjesërisht të verbër të Republikës së Kosovës dhe konkludon se ofron të dhëna të mjaftueshme në bazë të të cilave mund të vlerësohet se Projektligji mund t'i procedohet për shqyrtim në Kuvend të Kosovës.

Projektligji i adresohet të gjithë personave të verbër dhe personave pjesërisht të verbër të Republikës së Kosovës dhe me këtë plotëson infrastrukturën ligjore për këtë çështje në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Arsyeja e hartimit të këtij projektligji është përcaktimi i rregullave për sigurimin e bazës ligjore për mbrojtjen e të drejtave elementare të një kategorie të personave me aftësi të kufizuara, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Projektligji ka nevojë për amendamentim, andaj kontributi ynë do të jepet në Komision, kështu që në parim e mbështesim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Ju faleminderit, kryetar!

Ehe Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për persona të verbër dhe persona gjysmë të verbër. Të njëjtin e përkrahim. Dhe, natyrisht se do ta përkrahim sepse konsiderojmë se është ligj i rëndësishëm, dhe kontributin do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit të SLS-së, deputetja Bisetra Kostiq, e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem gospodine predsjedniče!

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila Nacrt zakona o slepim i delimično slepim licima. Podržaćemo Nacrt zakona u načelu, a daćemo doprinosa u Komisiji. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit “6+”, deputetja Duda Balje, e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa „6+“ je mišljenja da ovaj Nacrt zakona kojim se uređuje status slepih i delimično slepih lica, kao i njihovo pravo i privilegije je vrlo značajan, s obzirom da se ovim Nacrtom zakona određuje prava na mesečni iznos uplate koje određuje Vlada za slepa i staratelj slepaca prve kategorije koje dato lica odredi, zatim zapošljavanje po povoljnim uslovima, njihovo stručno završavanje, oslobađanje od svih vrsta taksi i poreza, njihov smeštaj, zdravstvene nega, rehabilitacija i drugih privilegija.

Podržavamo Nacrt zakona i svoj dalji doprinos daćemo kroz rad u funkcionalnoj komisiji. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Donika Kada Bujupi.

DONIKA KADA BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kolegë deputetë,

Pa ndonjë dallim prej qytetarëve tjerë të kategorizuar si persona me nevoja të veçanta, edhe personat e verbër në Kosovë, në mungesë të ligjit por edhe të moszbatimit të ligjeve të tjera të cilët janë në fuqi që një kohë, vazhdojnë me qenë pa përkrahje institucionale.

Ndihmat e ndryshme të cilat i kanë marrë në periudha të caktuara janë të mirëseardhura, por në fakt nuk kanë zgjidh problem. Ajo çka duhet është koordinim i gjithanshëm i dikastereve të arsimit, të shëndetësisë dhe të infrastrukturës, e po ashtu edhe të Ministrisë së Punës (Po shoh që paskan shkua!) me qëllim të krijimit të mjedisit ku këta njerëz do të kenë hapësirë dhe mundësi veprimi dhe integrimi të plotë. Në këtë kontest ky projektligj është shumë i mirëseardhur, mirëpo janë disa rekomandime të cilat do i jap më vonë.

Mendoj që në rend të parë është tepruar me disa përkufizime të panevojshme të çdo ligji. Çdo ligj që na vjen thuhet “fjala ministri nënkupton”. Për këtë kanë thënë disa herë deputetët, por po vazhdon Qeveria me i pru me të njëjtat përkufizime, sikur me përmëshë atë vakumin, apo se letra duron gjithçka. Por, për shkak të një kulture institucionale është mirë me fillua me përmirësua sjelljen e ligjeve në Kuvend, në mënyrë që të tjerët që vijnë pas neve mos me qesh me mënyrën qysh kemi vepruar dhe qysh kemi punuar.

Unë do të ndalem te neni 3, dhe kisha kërkuar vëmendjen sepse bëhet fjalë për Komisionin mjekësor. Do të thotë neni 3, parasheh që Komisioni mjekësor të përbëhet prej ekspertëve të formuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i cili thotë: “bën përcaktimin e gjendjes shëndetësore dhe shkallës së verbërisë, duke përfshirë seriozitetin dhe kohëzgjatjen e saj”.

Të nderuar,

Kemi aq shumë përvoja të këqija nga komisionet e themeluara për qëllime të ngjashme dhe unë do të marrë një shembull, ta zëmë, për persona të hendikepuar - të paafte për punë, që merrnin nga 40 euro, sa që unë këmbënguli që kjo mos të përsëritet kurrë në këtë ligj, në rend të parë. Sepse Komisioni që parashihet të jetë profesional, madje po quhen ekspertë, të cilët do të jenë në kuadër të ministrisë, bazuar me përvojat e të

kaluarës, do të thotë zakonisht kanë qenë njerëz të cilët janë emëruar nga politika. Pra, njerëz të cilët në të shumtën e rasteve kanë punuar më shumë për partinë se sa për kategori të cilave iu dedikohet ky ligj.

Ka pasuar edhe shumë shkelje! Më besoni, në prokurori sot janë shumë lëndë ku bëhet fjalë për shkelje tepër të mëdha, të cilat janë lidh me raste korruptive ku kanë përfituar pikërisht këto komisione dhe kanë mbetur njerëz të cilët janë në nevojë jashtë skenave, ndërsa qytetarët e shëndoshë, do të thotë njerëz të cilët janë të aftë për punë, kanë marrë pensione të tilla. Prandaj, duhet me i ikë përsëritjes së skenarit të njëjtë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon që ky komision të jetë i pavarur, të themelohet në baza ad-hoc nga profesionistë, për shembull të QKUK-së, në mënyrë që të evitohet abuzimi dhe korrupsioni që ka ndodhë në të kaluarën.

Neni 5, po ashtu flet për komisionin, dhe rekomandimi është: “Komisioni të jetë i pavarur dhe profesionistë në baza ad-hoc”.

Neni 8, është shumë interesat qysh shkruan, thotë: “Lartësia e shumës përcaktohet nga Qeveria në bazë të verbshmërisë”. Do të thotë Qeveria po del mbi ligjin. Në fakt duhet ligji të përcaktojë në këtë rast lartësinë e shumës dhe jo anasjelltas.

Neni 9, flet për çështjen e banimit, mirëpo rekomandimi është që t’i shtohet edhe adoptimi i infrastrukturës.

Tek komunitat, është shumë e përgjithësuar sepse duhet që në njëfarë forme të specifikohet që komunitat duhet t’i përshtatin ambientet publike në mënyrë që këta njerëz të mund të integrohen.

Neni 22, është shumë i çuditshëm thotë: “Bashkëpunimi me shoqatën”. E dimë që në Kosovë zakonisht ka shumë shoqata. Prandaj ministria, me të cilën shoqatë në momentin e caktuar kur ka nevojë me u bë ky kategorizim, do të bashkëpunojë?

Edhe këtu e dimë që shoqatat shpesh ndodhë themelohen 2 – 3 ditë para zgjedhjeve dhe atëherë Ministria vendos me bashkëpunuar me filan shoqatë. Prandaj, kërkoj që të specifikohet edhe neni 22.

Dhe krejt për fund. Qeveria Thaçi në vazhdimësi po krijon iluzion që gjendja e kategorive të caktuara po përmirësohet në vend. Mirëpo, fakti që hynë në fuqi ky ligj vetëm në vitin 2013, tregon që këta njerëz duhen me pritur edhe goxha shumë derisa ky ligj fillon të zbatohet! Nëse fillon të zbatohet!? Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,

Projektligji që e kemi para vetes për persona të verbër është i mirëseardhur për shoqërinë tonë, e veçanërisht për persona të verbër dhe familjet e tyre. Megjithatë, konsideroj se disa çështje nuk janë sqaruar sa duhet.

Përkufizimi i termit “i verbër”, nuk është bërë në mënyrë korrekte dhe për aq më tepër nuk është qartësuar se cila kategori e të verbërve do të jetë përfituese e beneficioneve.

Verbëria e plotë apo totale, nënkupton mungesë të plotë të perceptimit të dritës dhe projeksioneve, ndërkohë që termi i verbër shpesh përdoret edhe për të përshkruar çrregullimet të rënda të pamurit te personat që kanë vetëm të perceptimit të dritës, pra e dallojnë dritën nga errësira.

Nga ana tjetër, për të përcaktuar se cilët persona kanë nevojë për ndihmë të veçantë për shkak të çrregullimit të pamurit, shtete të shumta kanë formuluar përkufizime më komplekse që përshkruajnë të ashtuquajturën verbëri ligjore.

Prandaj, konsideroj se edhe ne duhet të përkufizojmë verbërinë për ligj ku përfshihen personat plotësisht të verbër dhe pjesërisht të verbër, e që kanë nevojë për asistencë dhe të quhen me një emër persona të verbër. Dhe, si rrjedhojë e kësaj, edhe emërtimi i ligjit të jetë Ligj për persona të verbër.

Gjithashtu kam vërejtje te neni 3, sikurse edhe kolegja Donika Kada, te përkufizimi i Komisionit mjekësor, ku konsideroj se duhet bërë modifikimet si vijon:

Në vend të fjalës “ekspertëve” duhet të precizohet “mjekëve specialistë të oftalmologjisë, të cilët bëjnë përcaktimin e shkallës së verbërisë dhe reversibilitetin”. Ndërsa, duhet të hiqet “se këta përcaktojnë gjendjen shëndetësore, seriozitetin e verbërisë dhe kohëzgjatjen” pasi këto janë të pakuptimta në aspektin mjekësor.

Është e rëndësishme të ceket “reversibiliteti i çrregullimit të të pamurit, pasi ata persona të cilët kanë pengesa serioze me të pamur, por mund të korrigjohen, nuk duhen të jenë përfitues të këtij ligji”.

Te kategorizimi në tri grupe i personave me çrregullim të të pamurit konsideroj se gjatë amendamentimit duhet konsultuar edhe një herë specialistët oftalmologë të vendit dhe të përdoren njësitë matëse që përdoren te ne, në mënyrë që t’iu shmangemi konfuzioneve eventuale.

Gjithashtu konsideroj se duhet të sqarohet prerazi se cila kategori përfiton nga ky ligj.

Kur jemi te neni 8, që ka të bëjë me shumën e pagesës, konsideroj se shumta e pagesës duhet të caktohet në këtë ligj dhe atë në përqindje në raport me pagën mesatare apo minimale të vendit.

Ndërkaq, si vërejtje më të vogla do t'u përmendi dy. Te titulli i Kreut II shkruan "Kujdesi, sigurimi i vendstrehimit, sigurimi shëndetësorë, arsimimi, pushimi dhe mirësi tjera" ndërkohë që duhet të jetë "të mira tjera".

Dhe te neni 13.4, konsideroj se në vend të "rehabilitimit dhe arkëtimit" duhet të jetë "Rehabilitimit dhe rekreacionit".

Ju faleminderit, për vëmendje dhe shpresoj se do t'i merrni parasysh vërejtjet tona gjatë amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja, Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni që fillimisht të përshëndes punën dhe angazhimin e të gjithë atyre që kanë punuar në hartimin e një projektligji që mbron dhe realizon të drejtat e personave të verbër dhe pjesërisht të verbër të Republikës së Kosovës.

Duke qenë afër dhe në bashkëpunim me përfaqësuesit e OJQ-ve që merren me çështjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe po ashtu njerëz të vullnetit të mirë, unë si deputete e Parlamentit të Kosovës në parim e mbështesë këtë projektligj.

Historikisht, çështja e aftësisë së kufizuar, me këtë rast e personave të verbër janë trajtuar më shumë në kuptimin social se sa atij integruar, ku me këtë rast konsideroj që ky ligj duhet të shpjegojë qartë dhe të jetë i modifikuar në atë mënyrë që personat e verbër të trajtohen as më shumë e as më pak, por të barabartë me gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Unë e kam lexuar Projektligjin për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër dhe parimisht mendoj që modifikimi është bërë në harmoni me kërkesat dhe mundësitë buxhetore që ky ligj posa të aprovohet të jetë i zbatueshëm dhe konsideroj që përmes këtij ligji në të ardhmen të definohet qartë pozita dhe benefitet e personave të verbër.

Megjithatë, unë kam disa vërejtje që ky projektligj ka hapësira për përmirësime të vogla.

Për shembull unë i rekomandoj Komisionit përkatës që në nenin 5.1.1. veç që e merr për bazë Ligjin për aftësim e riaftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara, nga ky projektligj që po e diskutojmë të dalë me këtë pikë të punësimit edhe një obligim shtesë që e mundëson punësimin e personave të verbër.

Neni 15, i këtij projektligji bënë lehtësira në shpenzimet e energjisë elektrike dhe telefonit. Unë propozoj që në këtë nen institucionet përkatëse të caktojnë shumën në fillim të vitit, pra të planifikojë buxhetin dhe mendoj që 80% e pagesës ta bartë institucioni përkatës dhe 20% personi i verbër, edhe pse unë mendoj që ne si shtet i ri

duhet tu ikim skemave sociale ndaj këtij komuniteti, por le të jetë ky një benifit që të verbëritë kanë të drejtë ta gëzojnë.

Tek neni 21, do të rekomandoja një kërkesë që mendoj që është e arsyeshme, pasi që të bëhet kategorizimi i verbërisë, sigurisht që një numër i caktuar i personave të verbër do ta kenë vështirë punësimin. Andaj, në këtë pikë konsideroj që me një udhëzim administrativ, të miratuar nga Ministria e Financave dhe Qeveria e Kosovës, efekti i verbërisë të caktohet afërsisht 70% e rrogës minimale në Kosovë.

Konsideroj që si fillim, meqë jemi në leximin e parë, të jenë rekomandimet e mia dhe besoj që do të shqyrtohen edhe nga grupi punues, dhe le të jemi të vëmendshëm dhe kritik ndaj punës tonë meqë dëshira ime është që mbi të gjitha të fuqizohet sa më shpejtë ky ligj dhe të implementohet në çdo fjalë që shkruhet në projektligjin e statusit të verbërisë.

Ne jemi dëshmitarë të pozitës aktuale të gjithë personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Andaj, ndjejë obligim, pikësëpari si qytetare e Kosovës, që të jemi të vëmendshëm e të përkushtuar në integrimin e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Njëherit më lejoni t'ua rikujtoj dhe të falënderoj Qeverinë e Kosovës, dhe konkretisht kryeministrin e Kosovës i cili me këtë projektligj po e përmbush edhe një premtim të dhënë gjatë fushatës elektorale që e ka bërë për këtë shtresë qaq të çmuar të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: I nderuari kryetar i Parlamentit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër është një Projektligj i rëndësishëm i cili e rregullon statusin e kësaj kategorie të shoqërisë sonë - të drejtat, përfitimet.

Fillimisht do të doja që ky projektligj të jetësohet, por marrë parasysh deklaratën financiare të Departamentit të Buxhetit, ky projektligj ka ndikime buxhetore diku mbi një milionë euro, pa llogaritur ndikimin buxhetor në mënyrë jo të drejtpërdrejtë për përfitime të tjera të përcaktuara me këtë projektligj që kanë të bëjnë me punësimin, strehimin, lirimin nga taksat dhe tatimet, kujdesin shëndetësor, edukimin e tjera.

Prandaj, do të doja që Qeveria t'i gjejë këto mjete dhe ky projektligj të implementohet.

Gjithashtu, mendoj se ky projektligj është përpiluar shumë dobët dhe kompletuar me deklarata dhe opinione të ministrive tjera, sikur ka të bëjë në kushte të jashtëzakonshme.

Ka aq shumë gabime të shumta strukturore, përmbajtjesore, e të cilat edhe u thanë më herët nga kolegët, dhe ka gabime të shumta dhe nuk ka korrektësi fare gramatikore dhe drejtshkrimore.

Gati në secilën fjali, si në pjesën e parë të Projektligjit ashtu edhe në të dytën, nuk kemi fjalë që është shkruar drejt. Vetëm shikojeni memorandumën shpjegues të Zyrës së kryeministrit, ku në vetë titullin e projektligjit të kornizuar, të shkruar me shkronja të mëdha në një titull me vetëm 5 fjalë të janë 2 gabime. Prandaj, do të doja që këto dokumente zyrtare të korrigjoheshin dhe të merreshin më seriozisht.

Ajo që më ka rënë në sy në të gjitha projektligjet e kemi sponsorizues Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i procedohet Kuvendit të Kosovës. A thua zoti kryetar Qeveria qenka e Republikës së Kosovës, ndoshta Kuvendi i Kosovës.

Nuk mendoj që këto lëshime bëhen në mënyrë të qëllimshme por marrë parasysh pretendimet e kohëve të fundit që të sfidohet integriteti i Kuvendit, të cenohet mandati dhe kompetenca e tij, do të sugjeroja të paktën në këto dokumente zyrtare që ne i quajmë ligje dhe janë ndër dokumentet kryesore për të funksionuar shteti, të shkruhet: Kuvendi i Republikës së Kosovës. Eedhe pse në disa dokumente Republikë po na hiqet, po të paktën për këto dokumente që vendosim vetë, të mos i bëjmë këto lëshime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja, Salihe Mustafa, e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e Kosovës e ka bërë një punë shumë të mirë që e ka proceduar në Kuvend projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbëritë nga se ky komunitet ballafaqohet me probleme të mëdha në jetën e përditshme dhe është mirë që kjo fushë të rregullohet me ligj.

Është obligim i shtetit të përkujdeset për këtë kategori të shoqërisë dhe duke u bazuar në faktin se verbëria llogaritet me një nga invaliditetet më të rënda krahasuar me aftësitë e kufizuara të tjera. Kjo edhe për arsye, pasi që dihet se 90% të informatave truri i njeriut i merr përmes organit të pamurit.

Për një definim më të saktë dhe konkret duhet mbështetur në nenin 22 i këtij ligji i cili bënë fjalë për bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqatën e të verbërve.

Ky ven thotë: “Me qëllim të lehtësimit të procesit të zbatimit të këtij ligji, Qeveria e Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me Shoqatën e Personave të Verbër si dhe akterët e tjerë relevantë”.

Meqenëse ky nen nuk precizon qartë llojin e bashkëpunimit gjegjësisht mbështetjen e Shoqatës së të Verbërve nga ana e Qeverisë, mendoj se ky nen duhet rishikuar dhe projektuar në mënyrë që bashkëpunimi të konkretizohet.

Pasi që Shoqata e të Verbërve të Kosovës ofron shërbime dhe mbështetje për komunitetin e të verbërve, kjo shoqatë ka nevojë për mbështetje nga ana e Qeverisë. Shërbimet që i ofron kjo shoqatë janë specifike si shkrim dhe lexim në brain, teknologji informative, orientim në hapësirë, trajnime psiko-sociale.

Shoqata e të Verbërve ka mundësi dhe kapacitete njerëzore për ofrimin e të gjitha këtyre shërbimeve. Megjithatë, që këto shërbime të jenë në nivelin e duhur nevojiten mekanizma të posaçëm dhe të organizuar në nivel më të lartë siç është ai qeveritar.

Prandaj, Shoqata e të Verbërve ka nevojë për mbështetje nga Qeveria për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Arsyeja e ofrimit të këtyre shërbimeve nga ana e shoqatës qëndron në faktin se të verbrit, të cilët e humbin të pamurit në mosha të ndryshme nuk kanë mundësi të marrjes së këtyre shërbimeve në institucionet shtetërore siç është Qendra Burimore në Pejë.

Andaj, unë e përkrah këtë projektligj dhe besoj se komisioni funksional do t'i ketë parasysh vërejtjet e deputetëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja, Teuta Haxhiu, e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,
Në radhë të parë një vërejtje lidhur me terminologjinë. Termi “pjesërisht i verbër” nuk është adekuat, thjeshtë sepse në vendet anëtare të BE-së dhe në vendet tjera këtyre personave nuk u referohet si pjesërisht të verbër, por si persona me shikim pjesërisht. Madje edhe në versionin anglisht të këtij projektligji është përdorur termi “partially sighted” që në shqip do të mund të përkthehej si me shikim të pjesshëm ose me të parë të dobët.

Pagesa për verbërinë bëhet si kompensim për shpenzimet shtesë që verbëria u shkakton personave të verbër. Si për shembull, në transport ata duhet të paguajnë dy bileta, një për vete dhe një për shoqëruesin. Ata detyrohen të përdorin shërbimin e taksive edhe në distancë më të shkurtër, t'i paguajnë personat që u lexojnë materialet që nuk janë në dispozicion në forma të përshtatshme për të verbërit, ose të paguajnë persona që ju kryejnë shërbime të ndryshme për nevoja të jetës së përditshme.

Besoj se është e qartë se këto nevoja dhe shpenzime shtesë vështirë që mund të përmbushen nga një person i vetëm, pasi që është vështirë që një person i verbër do të mund të gjejë një kujdestar i cili do të jetë i aftë, ta zëmë, të jetë edhe shoqërues i mirë në rrugë, në dyqan dhe në vende të tjera, pastaj edhe si lexues i mirë dhe pastrues i mirë

shtëpie i cili do të marrë si kompensim për këto punë pagesën që e përcakton ky projektligj.

Prandaj, konsideroj se më së miri do të ishte që Projektligji të mos i detyronte personat e verbër të nënshkruajnë kontratë me një kujdestar i cili do ta merrte pagesën për përkujdesjen e tyre, por që në vend të kësaj kjo pagesë tu jepej personave të verbër të cilit do ta përdornin atë për t'i mbuluar shpenzimet shtesë në mënyrë që të mos jenë të diskriminuar duke u detyruar të paguajnë të paktën dyfishin që e paguajnë personat që shohin.

Dhe në këtë rast, e kisha bërë një pyetje se a ka ndonjë vend të botës, do të thotë ndonjë vend që është anëtar i BE-së ku pagesa për verbërit i caktohet një kujdestari. Dhe ju them me përgjegjësi të plotë, se askund.

Duke pasur parasysh se çështja e të verbërve përfshinë dhe kërkon një qasje shumë sektoriale, mendoj që përveç Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në këtë projektligj rol i madh duhet tu caktohet edhe ministrive tjera, si Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Kulturës e të tjerë. Pra, edhe vetë komisioni vlerësues do të duhej të përbëhej, siç u përmend edhe më herët edhe nga koleget e mia, prej ekspertësh të shumë fushave të ndryshme nga se përcaktimi i shkallës së verbërisë nuk përcakton domosdoshmëri edhe llojin e nevojave dhe mënyrën adekuate të plotësimit të tyre.

Personat e verbër janë individë, që do të thotë se potencialet dhe nevojat e tyre midis tyre dallojnë po aq sa edhe ato të personave që shohin. Bie fjala, nëse një person i verbër do të mësojë shkrimin brai, një tjetër në gjendje ta mësojë atë, ose një person mund ta përdorë kompjuterin duke përdorur programet e posaçme folëse, një tjetër duke përdorur monitorin e brait, tjetri duke përdorur programe zmadhuese, kurse një tjetër nuk do ta mësojë kompjuterin asnjëherë dhe do të përdorë forma tjera alternative për përmbushjen e nevojave për lexim.

Për këtë arsye një komision shumë profesional jo vetëm që do t'i përcaktonte këto nevoja me të drejtë por edhe do të bënte kursime financiare në rastet kur kjo është e mundshme, sepse do të bliheshin pajisjet të kushtueshme për personat që nuk do t'i përdorin ato.

Dhe në fund pa mohuar në asnjë mënyrë rëndësinë dhe rolin që luajnë shoqatat e verbërve dhe e personave me të parë të dobët në Kosovë, besoj se zbatimi i këtij projektligji nuk do të duhej që domosdo të kushtëzohej me disa kompetenca të shoqatës. Dhe, për një vend demokratik, që pretendojmë të jemi, çfarë do të ndodhë me ata persona të verbër dhe me të parë të dobët që vendosin të mos jenë anëtarë të një shoqate ose me të tjerët që iu takojnë ose që themelojnë shoqata apo organizata tjera të verbërve dhe njerëzve më shikim të dobët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Më nuk ka të lajmëruar për diskutim. Tash hyjmë në votim, edhe Komisioni ka rekomanduar që të votohet në parim.

Në sall kemi 67 deputetë.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për persona të verbër dhe persona pjesërisht të verbër.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kjo iniciativë e Ministrisë së Financave është pjesë e strategjisë legislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në kuadër të strategjisë së reformave që i ka ndërmarr Qeveria për përshejtimin dhe përafrimin e legjislacionit tonë me atë të komunitetit evropian.

Me këtë projektligj për tatimin në pronën e paluajtshme në bashkëpunim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtarë dhe asociacionin e komunave, vendosëm një prag në vlerë prej 0,15% të gjitha komunat për pronat rezidenciale, kështu që me aplikimin e kësaj shkalle të tatimit në pronën e paluajtshme ne do të eliminojmë dallimet që kanë ekzistuar në pagesën e shkallës minimale të tatimit në pronën e paluajtshme në mes të qytetarëve të komunave të ndryshme që kanë ndodhë deri më sot.

Me këtë projektligj është paraparë që çdo komunë mund të caktojë normën e tatimit në pronë mbi pronën rezidenciale në bazë vjetore në shkallë prej 0,15% të vlerës së pronës në treg, që është kufiri i poshtëm. Po me këtë projektligj caktuam edhe afatin kohorë për pagesë të tatimit në pronë të paluajtshme dhe kjo tani e tutje do të bëhet në dy kështe. Kësti i parë me apo para 30 qershorit dhe kësti i dytë me apo para 31 dhjetorit, ndërsa për rastet e transferim apo ndërrimit të pronarit pagesa e tatimit në pronën e paluajtshme duhet të bëhet në tërësi të plotë.

Ky projektligj e rregullon edhe procedurën e zgjedhjes së ankesave, një e drejtë të cilën e njehë Kushtetuta e vendit tonë dhe të gjitha konventat për të drejtat e njeriut. Një procedurë e tillë e ankesës nuk ishte e rregulluar deri me sot dhe si pasoj e kësaj mungese, shumë tatimpagues të atakimit në pronën e paluajtshme nuk kanë mund të realizojnë të drejtën e tyre në ankesë, andaj tani e tutje kjo e drejtë është e rregulluar.

Një prej parimeve me rastin e pagimit të tatimeve dhe taksave, është edhe parimi i drejtësisë. Deri me tani qytetarët e komunave të Kosovës, varësisht se prej cilës komunë kanë qenë të ngarkuara me normat e ndryshme. Po i përmendim vetëm disa raste.

Qytetarët e komunës së Dragashit edhe deri me tani kanë paguar 0,15 të Istogut, gjithashtu; të Klinës dhe të disa komunave tjera, ndërsa kjo bëhet edhe me qëllim të ndërprerjes së një gare në mes të kryetarëve të komunave të cilët kanë të bëjnë me uljen e normës së tatimit në pronë.

Për këto arsye, të ndragura deputetë ju ftoj që ta votoni të ndryshim plotësim të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, që është një ligj i rëndësishëm së veçantë për zhvillimin e shumë projekteve komunale në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Të gjitha të hyrat, të cilat grumbullohen nga tatimi në pronë, janë të hyrat vetjake të komunave dhe ju kthehen 100% komunave. Ju faleminderit!

(Kryeson mbledhjen, nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Tani e hapi diskutimin lidhur me Projektligjin në parim.

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, nënkryetar!

I nderuari zoti ministër,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit, nr. 03-L/2004 për tatimin në pronën e paluajtshme dhe unanimisht i ka përkrahur plotësim-ndryshimet e bëra në këtë Projektligj.

Plotësim ndryshimet kanë të bëjnë kryesisht me ndryshimin e normës së pagesës së tatimit në pronë dhe me procedurat e ankimit.

Tatimi në pronë ofron një nivel të hyrave vetjake të besueshme që janë për përdorim të komunave. Kvendet komunale të çdo komune i caktojnë tarifatat komunale, kurse me këtë ligj është caktuar shkalla e ulët dhe më e lartë e vlerës së pronës në treg. Po ashtu janë përcaktuar edhe afatet kohore për pagesë dhe njëkohësisht është krijuar mundësia që qytetarët të cilët kanë ndonjë problem apo shqetësim të kenë mundësi të bëjnë vërejtje për çka janë përcaktuar edhe procedurat e ankesës.

Komisioni, pas sqarimeve që i ka dhënë ministri i Ministrisë së Financave, si sponsorizues i këtij ligji, në pyetje të anëtarëve të Komisionit, do me thënë në pyetje, pas sqarimeve që janë bërë dhe marrjes së përgjigjeve nga ministri në pyetjet të cilat janë bërë nga anëtarët e Komisionit, Komisioni ka vendosur që unanimisht ta përkrahë këtë Projektligj dhe i rekomandon Kuvendit që ta përkrah në shqyrtim të parë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, grupet parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03-L/2004 për tatimin në pronën e paluajtshme dhe në parim do ta përkrahim. Kontributin tonë do ta japim nëpër komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhje Demokratike, deputeti Demolli. Atëherë, deputeti Osmani, më fal! Pra, e ka fjalën deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë edhe pse e kemi përpara një draft propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronë, e kemi një çështje jashtëzakonisht delikate, që ka të bëjë me propozimin për rritjen e normës së tatimit.

Fjala është për një rritje bazë e ulët, do me thënë, plafoni i poshtëm, një rritje që parashihet për 300% dhe kjo, duke marrë parasysh rrethanat ekonomike-sociale në Kosovë, ka implikime të drejtpërdrejta te qytetari i Kosovës, pra ai i cili duhet me paguar këtë tatim.

Nga ana tjetër, ne si deputetë asnjëherë nuk kemi një analizë të vlerësimit se sa i përmbushin komunat, sa i vjelin komunat tatimet në pronë, as në shkallë të përgjithshme, as sipas komunave, në kuptimin e asaj që ne të vijmë deri te një vlerësim i saktë lidhur me tatimin në pronë, prandaj shtrohet si e domosdoshme që komisioni funksional të organizojë debate me asociacionin e komunave, i cili, faktikisht edhe është implementues të Ligjit e të shohin se cilat janë mundësitë dhe cilat janë propozimet e tyre lidhur me propozimin që ka ardhur për normën e tatimit.

Unë mendoj se krejt ky propozim, edhe pse i kemi dy qëndrime të ndryshme edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për rritjen e normës së tatimit dhe të Agjencionit Evropian që kemi për mos rritjen e normës së tatimit, konsideroj që kjo krejt ka për qëllim që të ndikojë në grantet për komuna dhe është krejt çështje, do me thënë që unë e konsideroj që asociacioni i komunave duhet ta japë qëndrimin e vet që mjetet nga tatimi në pronë,

e ato janë mjete të cilat do të mbahen në llogari të komunës apo të mbahen në llogaritë qeveritare.

Prandaj, konsideroj që do të kemi angazhim maksimal që të bëjmë një propozim në ligj, atë që ë është e përballueshme për qytetarin dhe jo për nevojat e buxhetit të Qeverisë së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputeti Ymeri.

VISAR YMERI: Ju faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ky Projektligj i cili plotëson dhe ndryshon Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, e rritë tatimin në pronën e paluajtshme nga 0.05% në 0.15%.

Pra, siç u përmend këtu, dhe u përmendën shumë arsye pse ky ligj nuk është i mirë, i mirëmenduar dhe në kohën e duhur, unë vetëm desha të deklaroj që Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është kundër kësaj rritje dhe do ta votojë kundër këtë rritje të tatimit, për shkak se konsiderojmë që edhe ky ligj sikur edhe një numër ligjesh të cilët do t'i kemi në këtë seancë, e që e mbulojnë fushën e tatimeve kryesisht janë bërë vetëm për qëllime për t'i fshehur në fakt ose për t'i ikur problemeve me financat sa do t'i ketë Kosova gjatë këtij viti, e të cilat Qeveria nuk po i pranon, dhe në këtë anë po rëndohet shumë buxheti i qytetarëve edhe ashtu të varfër, veçanërisht te prona e paluajtshme, kur e kemi parasysh që secili qytetar këtu, pavarësisht nivelit të ardhurave vjetore apo pavarësisht se ku është në strukturën shoqërore, është i obliguar t'i paguajë këto tatime dhe, po t'u rritet atyre ky tatim në pronën e paluajtshme, atëherë kjo faktikisht e bënë edhe më të rëndë jetën dhe mirëqenien e tyre sociale, e pastaj kur i kemi parasysh edhe të gjitha këto fjalë që po fliten përreth për mundësinë e rritjes së rrymës elektrike, pastaj për shtrenjtimin e jetës në përgjithësi nga inflacioni dhe kështu me radhë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ju faleminderit!

Definitivisht Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, është kundër kësaj rritje për disa arsye.

Në rend të parë do të thotë prej viti në vit, në të gjitha raportet po edhe atë çka e përfshijmë na, flitet se korrupsioni po rritet në vend, transparenca për shpenzimet po zvogëlohet dhe kemi shpenzime të pa kontrolluara që na e rrezikojnë buxhetin.

Na po e kuptojmë Qeverinë që është zotuar që me të gjitha mënyrat do të arrijë që të inkasojë mjete, do të thotë, që buxheti sado pak të vazhdojë të jetë stabil, mirëpo kjo nuk guxon me ndodhë në llogari të xhepit të qytetarëve. Ajo çka po kërkon Qeveria e

Kosovës, është që 300% të vjel më shumë taksa nga qytetarët të cilët edhe kështu janë tepër të varfër.

Un e di, që do të thotë, ka pasur angazhime edhe me komuna, mirëpo Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës rekomandon se është dashur të rriten grantet stimulues për komunat të cilat i rrisin të hyrat dhe jo të rriten vetë taksat, sepse kjo po i bie nëse 40% të qytetarëve të Kosovës paguajnë sot taksa, atëherë me 300%-shin e kësaj, do të rëndohen përsëri ata që paguajnë. Do të thotë është një politikë krejt e mbrapsht, sepse në vend që të rritet inkasimi dhe të provojmë që të inkasojmë 80 - 90% në taksat e tanishme, ne prapë po i dënojmë ata që po vazhdojnë me paguar.

Dhe, sigurisht Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është kundër kësaj.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin dhe deputetët në këtë seancë!

Duke marrë parasysh se Ministria e Financave e ka sjell Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, numër 03-L/2004 për tatimin në pronën e paluajtshme, do të thotë esenca e këtij plotësim-ndryshimi apo çështja e adresuar në këtë projektligj është ndryshimi i rritjes së normës për tatimin në pronën e paluajtshme nga 0.05% në 0.15%.

Ministri publikoi në prezantimin e tij se do të bëhet një barazim në të gjitha komunat. Mirëpo duke marrë parasysh këtë, unë e kisha pasur një kërkesë ministër këtu, dhe prapë se prapë na do t'i japim përkrahje këtij Projektligji.

Prandaj, dëshiroj që me këtë rast të theksoj se esenciale për komunat dhe administratën e tyre, është që të aftësohen për të arkëtuar tatimin në pronë pasi që komunat nuk mbledhin tatimin diku as 50% të pronës, ndoshta për shkak të dobësive në faturim, apo për shkak të faturimit të dobët, ato duhet ta kishin plotësuar kërkesën deri më tani që të kishin mbledhur tatimin total të pronës dhe ndoshta edhe për këtë arsye vjen deri te ngritja e kësaj shkalle të normës nga 0.05 në 0.015%.

Edhe një herë bëj kërkesë nga kryetarët e komunave që në mënyrë esenciale t'i mbledhin pronat e tyre për arsye se kjo ndikon edhe në funksionimin më të mirë të çdo komune dhe në ndarjet buxhetore të cilat i bënë Qeveria nga niveli qendror në nivel komunal dhe mos të ndodhë që ndoshta për këtë arsye dhe të ketë edhe një balancim të ngritjes së normave të interesit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "6+", Albert Kinolli, e ka fjalën!

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit, i nderuari nënkryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar” “6+”, e ka bërë analizën dhe shqyrtimin e këtij Projektligji, gjegjësisht ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimit në pronën e paluajtshme, i cili për qëllim esencial ka ndryshimin e normës për pagesën e tatimit në pronën e paluajtshme nga 0.05 në 0.15%, dhe se po ashtu jemi të mendimit, duke pasur parasysh se kjo rritje do të ndikojë në sasinë apo rritjen e të hyrave për buxhetet komunale për 3 deri 4 milionë euro dhe, duke pasur parasysh arsyet e lartcekura, Grupi Parlamentar “6+” është pro këtij ndryshimi dhe plotësimi të këtij Projektligji dhe do ta votojë si të tillë në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Sadriu e ka fjalën!

ALI SADRIU: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Përhëndetje për ju, ministrin dhe kolegët deputetë,

Tatimi mbi pronën është tatim shumë i vlefshëm dhe shumë i rëndësishëm për pushtetin lokal. Është i vetmi tatim që e administrojnë kuvendet komunale.

Mendoj se ka ardhur koha kur këtë ligj duhet ta avancojmë, dhe jo vetëm ta përcaktojmë në shkallën minimale dhe mandej t’i lihet komunave, sepse në të kaluarën ka qenë 0.05%, por realisht ministri e prezantojë se mesatarja e realizmit të këtij tatimi ose përcaktimi i këtij tatimi nëpër komuna, ka qenë mesatare diku 0.11%. Ka komuna që e ka edhe 20-të, e 15.

Kjo për mua është e pakuptimit. Ka pasur kuptim në start, kur kemi startuar, kur ende institucionet tona nuk kanë qenë të afta edhe me e bë përcaktimin edhe vjeljen e këtij tatimi.

Unë mendoj se pushteti qendror do të duhet me norma më të afërta t’i përcaktojë ose t’i udhëzojë kuvendet komunale se si ta përcaktojnë këtë tatim dhe si ta vjelin.

Çka dua të them me këtë? Për mua është e pakuptimtë që të lejohen ndryshime prej komune në komunë. Prona nuk është e njëjtë. Por çka duhet këtu? Duhet kuvendet komunale më përafërt të bëjnë vlerësimin. Pra, një pronë në Prishtinë nuk mund të krahasohet me një pronë, ta zëmë, në Lipjan, në Shtime dhe diku tjetër.

Por norma, përqindja pse të përfshihen këtu? Kuvendet komunale do të duhet jo vetëm në qytet që ndryshon, se ajo ndryshon brenda qytetit, brenda rrugës, brenda rëndësisë të asaj prone, do të thotë vlerësimi të bëhet adekuat e jo të shkohet në normë, të shkohet 20%. Pra, pse të shkohet 20%? Pra, po të ishte respektuar ajo 0.05% dhe vlerësimi të bëhet adekuat sipas vlerës së objektit ose të pronës, është diçka krejt në rregull.

Unë mendoj se në këtë drejtim duhet me intervenuar edhe me e përcaktuar. Pastaj vjelja e këtij tatimi ka qenë problem në të kaluarën, derisa e kanë kuptuar kuvendet komunale.

Pushteti qendror e ka stimuluar me grande stimuluese shkallën e inkasimit të këtij tatimi. Unë mendoj se duhet edhe një kohë të vazhdoni, zoti ministër, me këtë formë. Ndërsa, në anën tjetër kanë filluar veç bastardimet nëpër komuna specifike, sikur që

kushtëzojnë realizimin e këtij tatimi me elemente që prekin në të drejtat fundamentale të njerëzve.

Ata deklarojnë ndryshe, por realisht nëpër komuna, urdhëroni bëni një vizitë, do ta shihni se ka komunë që edhe dokumentacionin personal nuk ua japin pa e bërë pagesën e këtij tatimi. Kjo është diçka që mendoj se nga pushteti qendror këto dy fusha duhet të kontrollohen, stimulohet edhe të para-pengohen komunat që të mos bëjnë shkelje drastike të tilla.

Ndërsa, tatimi si tatim është tepër i rëndësishëm së veçantë, sepse thash se është i vetmi tatim që iu dedikohet komunave. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Kelmendi e ka fjalën!

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë dhe kolegë deputetë,

Situata aktuale në të cilën ndodhet Kosova, gjegjësisht qytetarët e saj, duke marrë parasysh standardin e ulët të jetesës, zhvillimin jo të mirë ekonomik dhe me një papunësi me shkallë mjaft të lartë të shkallës së varfërisë, ky projektligj pa dyshim që e bënë edhe më të rëndë situatën aktuale.

Rritja e tatimit në pronë në vlerë nga 0.05 deri në 0.15%, padyshim që e rëndon edhe më shumë standardin e jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ne jemi dëshmitarë të shumë ndryshimeve pozitive në Kosovë, por edhe një gjë e kemi parasysh se shumë firma dhe persona juridikë dhe fizikë që përfitojnë të ardhura mujore shumë të mëdha, nuk janë tatimpagues të rregullt dhe nuk i paguajnë si duhet tatimet e tyre, ndërsa me këtë projektligj ngarkojmë qytetarë të thjeshtë të cilët nuk e kanë të rregulluar sa duhet standardin e jetës.

Ne me disa ligje po synojmë t'i afrohem Bashkimit Evropian, por po harrojmë se standardi i qytetarëve të Kosovës është lartë prej standardit të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Prandaj duhet të marrim parasysh edhe këtë fakt dhe të mos ta ngarkojmë edhe më shumë jetën e qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues i Kuvendit,

Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Do të kisha dashur t'i paraqes disa vërejtje dhe komente lidhur me këtë projektligj i cili ndonëse për nga vëllimi është tejet i vogël dhe përmban vetëm 5 nene, në aspektin e shkaktimit të pasojave për popullatën e Kosovës, e sidomos për shtetasit më të varfra të shoqërisë sonë, është mjaft i madh.

Konkretisht, me nenin 2 të këtij projektligji, propozohet që të fshihet neni 7 i Ligjit aktual për tatimin në pronën e paluajtshme sipas të cilit, citoj: “Kuvendi komunal i çdo komune, i cakton tarifatatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0,05 deri në 1% të vlerës së pronës në treg, dhe i njëjti nen të zëvendësohet me dispozitën e propozuar sipas të cilës kuvendeve komunale iu lejohej mundësia që limitin e ultë të tarifave tatimore mbi pronën e paluajtshme ta grisim prej 0,05%, sa është aktualisht në 0,15, ndërsa limiti i lartë i kësaj shkalle, të mbetet ashtu siç ka qenë më parë.

Një ngritje e tillë, ndonëse numerikisht duket e vogël, pra prej 0,05% në 0,15%, gjatë zbatimit të ligjit në praktikë, do të jetë mjaft domethënëse, për të mos thënë do të goditë rëndë buxhetet familjare sidomos të shtresave të varfra të popullatës së Kosovës, e besa edhe të shtresës së mesme sociale.

Për familjet e Kosovës, një ndryshim i tillë paraqet goditje serioze financiare, sepse siç dihet, sipas të dhënave të instituteve dhe organizatave të ndryshme që merren me problemet ekonomiko-sociale në Kosovë, në vitin 2011 Kosova mbetet vendi me normën më të lartë të papunësisë, që është në shkallë mbi 43%, ndërsa në varfri jetojnë mbi 34% e popullatës, që do me thënë jetojnë më me pak se 1,42 euro në ditë, dhe 18% jetojnë në varfri të skajshme, me më pak se 94 cent në ditë. Që është më e keqja, nuk pritet ndonjë përmirësim i dukshëm i normës së papunësisë, por përkundrazi përkeqësim sepse, sipas ekspertëve të ekonomisë, në tregun e punës në Kosovë, hyjnë deri në 35.000 të rinj për çdo vit ndërkaq ky treg është në gjendje të absorbojë 4.000 deri në 6.000 punëtorë të ri në vit.

Këtyre fakteve mund t’iu shtohen edhe të dhënat mbi shkallën e lartë të inflacionit, respektivisht indeksin e ngritjes së çmimeve të konsumit, i cili sipas Entit Statistikor të Kosovës, tregon se shkalla e inflacionit e matur në muajin mars 2011 ishte 10,8%, që ishte në goditje direkte për buxhetin e konsumatorëve dhe ekonominë kosovare në përgjithësi.

Kjo shkallë e inflacionit, sipas vlerësimeve të ekonomistëve, ka ndikuar në fuqinë blerëse të qytetarit tonë sepse shportën e mallrave që në vitin 2010 e ka blerë me 100 euro, në vitin 2011 nuk ka mundur ta blejë as me 150 euro.

Në anën, tjetër paga mesatare e të punësuarit kosovar, sipas Entit Statistikor të Kosovës, është ndër më të ulëtat në regjion dhe në Evropë, me vetëm 374 euro

Edhe në aspektin e pensioneve, Kosova nuk qëndron aspak më mirë, sepse pensionet e pensionistëve tanë nuk i mjaftojmë as për të blerë barëra e lëre më për të paguar tatime. Njëherësh edhe në të ardhmen nuk pritet ndonjë ndryshim rrënjësor i statusit social dhe bazës materiale të qytetarit të Kosovës. Pra nuk priten hapje të theksuara të vendeve të punës, apo rritje të ndjeshme të pagave. Por përkundrazi, me fillimin e sezonit të verës, janë paralajmëruar ngritje të çmimeve të rrymës elektrike e cila rritje, e kam frikën, se do të përcillet edhe me rritjen zinxhirore të çmimeve të mallrave tjera të konsumit të gjerë.

Kur flitet për këtë Projektligj, pa ashtu, duhet theksuar se sipas opinionit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të tij, të Ministrisë së Financave, zbatimi i ndryshimeve të propozuara, pra ngritja e lartësisë së shkallës së tatimit do të ndikojë në rritjen e të hyrave vetanake të komunave, diku në vlerë afër 4,3 milionë euron vit, që do me thënë se kjo rritje prej 4,3 milionë drejtpërdrejtë do ta godas kurrizin e popullatës, edhe ashtu të varfër të Kosovës.

Është për t'u habitur se Qeveria kaur duhet tatimuar qytetarët, është tejet e gatshme dhe konsistente, ndërsa kur është për t'iu dhënë ndihmë materiale kategorive sociale, është mjaft e shtrënguar dhe e ngurtë.

Këtë më së miri e dëshmon Projektligji mbi ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale i cili po ashtu do të jetë pikë e rendit të ditës të seancës të sotme të Kuvendit. Nga shkresat përcjellëse të këtij Projektligji, shihet se Qeveria për kategorinë sociale të popullatës kosovare nuk ka paraparë kurrfarë ngritje gjatë periudhës 2012-2014, respektivisht buxheti për këtë kategori do të mbetet i njëjtë nga 28 milionë euro në vit.

Andaj, duke pasur parasysh rrethanat ekonomiko-sociale, varfërinë, papunësinë dhe inflacionin e lartë, propozoj që ky nen, pra neni 2 i këtij Projektligji të përpunohet dhe të rishqyrtohet edhe një herë në tërësi, që do me thënë tarifat tatimore për pronën e paluajtshme në Kosovës të jenë më të ulëta se ato të propozuara me këtë nen, sepse edhe si të tilla janë mjaft të larta për xhepin e qytetarit kosovar. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse u thanë shumica e çështjeve, do provoj të jem i shkurtër. Megjithatë gjatë fjalës së ministrit, unë e dëgjova që u arsyetua në kuptimin e përafrimit të legjislacionit me BE-në, por dje hiq më larg unë e kam parë një deklaratë të ministrit në shtyp që nuk e ka pëlqimin e FMN-së, po mendoj për rritje të kësaj. Konkretisht në shtyp dje e kemi pasur dhe kërkesa tjetër e eliminimit të dallimit në mes të komunave lidhur me këtë normë, mendoj që është një konstatim jo i qëndrueshëm sepse diferenca në mes 0.15 e deri në 1%, nuk është fjala këtu vetëm për objektet banimore por për të gjitha kategoritë për të cilat do të ketë tatim në pronë.

Një çështje tjetër, që ministri e tha, se janë disa komuna ose mesatarja është në 0.11%, E vërteta është që vetëm tri komuna janë 2 me 15 dhe 1 me 20, por me kategorinë e objekteve banimore mos të harrojmë se i kemi disa kategori të pronave të cilat tatimohen me këtë tatim. Prandaj, shumë komuna janë edhe në normën 010% dhe kjo gjithsesi do të ketë implikime të drejtpërdrejtë tek qytetarët tonë.

Ky ligj pretendon dy çështje kryesore me i rregulluar. E para, do të thotë, me rritë vlerën e përlllogaritjes të tatimit në pronë dhe çështja e dytë dyshkallshmëria, përkatësisht ankesa në tatimin në pronë.

Derisa me Ligjin ekzistues, neni 22 ka rregulluar që e drejta e ankesës prej bordit komunal të vazhdohet në Ministrinë e Financave, tani me këtë Ligj, në nenin 4 e kemi një ri-definim që nga bordi i komunës drejtpërdrejt i drejtohem gjykatave themelore. Bile, bile Ligji është kontrovers, neni 4, 4.1 dhe 4.2, sepse se zoti ministër në nenin 4.2 thirreni në paragrafin 7 të këtij neni, derisa ky nen fare nuk i ka 7 paragraf, aq sa u e kam para veti këtë Projektligj. Kështu që, mendoj se është shumë e nevojshme që ky Projektligj me u harmonizuar edhe me Ligjin për gjykatat, sepse në njëfarë forme ka ingerenca edhe në kompetencën e gjykatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur nga deputetët. Fjalën e ka në emër të Qeverisë ministri Hamza. Zoti Hamza, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, i nderuari zoti nënkryetar!

I falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet e tyre, mirëpo ka nevojë për disa sqarime.

E para. Nuk do të ketë ngritje të tatimit në pronë për 300%. Nuk do të ketë! Nëse i shikojmë se cilat norma të tatimit në pronë i aplikojnë komunat, unë them se komuna e Dragashit nuk do të ketë ngritje as 1%. Do të jetë 0.

Komuna e Istogut, do të jetë 0, Komuna e Klinës e ka 0,20, mirëpo është e padrejtë që qytetarët e një komune të paguajnë normën e tatimit 0,15 ndërsa disa kryetarë të komunave, edhe pse këto të hyra, të cilat inkasohen nga tatimi në pronë 100% i kthehen komunave. Nuk janë atë hyra që i takojnë nivelit qendror. Janë të hyra të komunave.

Unë i kuptoj drejtë deputetët kur brengosen për gjendjen sociale të shtresave të caktuara. Unë i kuptoj deputetët kur kërkojnë më shumë projekte zhvillimore në secilën komunë. Mirëpo, është një rregull. Për me dhënë fillimisht duhet me marrë diku.

Nëse nisemi prej logjikës që po e ngrisin disa deputetë këtu, kishte me qenë shumë populllore dhe mirë me thënë: në Kosovë nuk ka tatime dhe janë të përjashtuar prej pagesës së tatimeve të gjitha kategoritë.

Tatimi në pronë, është një prej një tatimeve më të drejta. Ata që kanë prona më të mëdha, ata që kanë prona më të kushtueshme - kanë me paguar më shumë. Ata që nuk kanë prona, nuk kanë mundësi, nuk kanë nevojë me paguar se nuk kanë pronë. Prandaj është një prej tatimeve më të drejta.

Ky Ligj, ky projektligj është i harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Është i diskutuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ne si Ministri e Financave, duke pasur për bazë që ka të bëjë direkt me interesin e komunave dhe të qytetarëve të komunave, kemi organizuar takime me asociacionin e komunave, ku kanë marrë pjesë, për mos me thënë të gjithë, por pjesa dërmuese e kryetarëve të komunave dhe fillimisht e kemi marrë pajtimin e kryetarëve të komunave dhe pastaj e kemi proceduar në Kabinetin qeveritar. Do të thotë është ligj i diskutuar dhe i harmonizuar edhe me pëlqimin e kryetarëve të komunave, pa dallim se cila parti i udhëheqë komunitat. Kanë qenë edhe kryetarët e komunave të Partisë Demokratike, edhe të Lidhjes Demokratike, edhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Prandaj, deputetë të nderuar, qëllimi është që të vendosim një rend, që të vendosim një rregull, që disa kryetar të komunave dhe komunat mos të bijmë në një situatë ky kryesisht varen prej grandeve që vijnë nga niveli qendror, por të bazohen në të hyrat e tyre të qëndrueshme. Në Kosovë, duke ju falënderuar në përkrahje së SIDA-së suedeze e USAID-it, është zhvilluar programi i tatimit në pronë i cili është më i avancuari në regjion, edhe sa i përket vlerësimit të pronave, edhe sa i përket faturimit, dhe kemi nivel dhe ngritje shumë të madhe të faturimit dhe gjithashtu edhe inkasimi është shumë i kënaqshëm.

Nuk është ky qëllimi që të kemi ngarkesa, por është qëllimi që ne t'i barazojmë qytetarët. Pse në Dragash të paguhet 15% e vlerës së pronës tatim, e në Gjilan paguhet 0,07? Dhe nesër një kandidat për kryetar të komunave vjen të thotë, dhe nëse ia lëmë mundësinë, ai ka me thënë: valla unë për me qenë më popullor, dua me propozuar edhe më tutje uljen e normës së tatimit në pronë;

Edhe një çështje tjetër. Këtu kemi të bëjmë vetëm me pronat rezidenciale, ndërsa janë të përjashtuara pronat komerciale dhe industriale. Qëllimi ka qenë që bizneset mos të ngarkohen me obligime shtesë.

Prandaj, unë konsideroj se pjesa dërmuese e komunave nuk kanë nevojë të bëjnë përmirësime në shkallën të cilën e aplikojnë, ndërsa disa komuna të cilat në mënyrë të padrejtë kanë bërë konkurrencë të padrejtë me komuna tjera, ta ngrisin normën e tatimit në pronë 0,15%.

Dhe për informatën tuaj, deputetë të nderuar, ju lutem referojuni Raportit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, se rekomandimi i tyre është që norma e tatimit në pronë të jetë 0,5.

Dhe, ju lutem, hyni edhe në vende tjera, ku tatimi në pronë është një prej të hyrave më të qëndrueshme të komunave, dhe bëni krahasimin me Kosovën. Unë ju garantoj se, jo vetëm sa i përket tatimit në pronë, por edhe sa i përket ngarkesave tjera - ekonomia e Kosovës i ka ngarkesat më të vogla në regjion e Evropë dhe vetëm rreth 25% e GDP-së së Kosovës paguhet në emër të taksave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Për shkak të rëndësisë që ka Ligji, dhe jo për replikë, do t'ia jap fjalën deputetit Naser Osmanit, për 2 minuta, edhe pse sipas Rregullores, s'ka të drejtë! Faleminderit!

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Ashtu siç e kanë konsideratën ndaj ministrit! Sepse, sot është një ditë që të gjitha këto çështje që janë në rend dite i kushtohen punës që e ka bërë Ministria e Financave.

Mirëpo, për shkak të korrektësisë, domethënë edhe të ministrit ndaj deputetëve, unë diskutimin e kam bazuar në dokumentin, të cilin e ka sjellë Qeveria, respektivisht ministri pranë deputetëve, e që ka të bëjë me çështjet e adresuara nga Projektligji, e që thotë kështu:

“Ky ndryshim ka për qëllim rritjen e normës për tatimin në pronën e paluajtshme nga 0.05% në 0.15%”.

Ministër, e llogaritur me dorë, e llogaritur me kompjuter, e llogaritur me digitron - del se rritja është 300%. Do të thotë, ky është limiti i poshtëm, që nga ky limit tani shkohet deri 1%.

Mirëpo, unë gjithmonë e kam dhënë edhe variantin. Unë i respektoj procedurat tuaja të dëgjimeve dhe diskutimeve, por të njëjtat procedura i ka edhe Komisioni për buxhet dhe financa të takojë asociacionin e komunave për me bë një ligj të përbashkët i cili ka me qenë i aplikueshëm. Domethënë, nuk kemi keqkuptime por kemi, do të thotë, argumente pse duhet rritur në këtë masë dhe cilat janë arsyet që duhet rritur në këtë masë. A ka përmbushje të pagesave të kënaqshme që tash të shkojmë me një stad tjetër të rritjes, apo ka diçka tjetër këtu, për të cilin ne si deputetë duhet ta kemi atë informacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Osmani!

Për sqarim shtesë, jam i obliguar që t'ia jap edhe një herë, ministrit Hamza fjalën. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ne e përkrahim punën e komisione rreth këtij projektligji, pse jo ne të kemi edhe përfaqësues të komunave dhe ne dakordohemi për atë. Ne kemi pasur takime me ta, dhe gjithmonë jemi të gatshëm që të kemi takime.

Mirëpo, këtu i kemi dy dallime. Ligjin ekzistues norma e tatimit në pronë, domethënë limitet, janë nga 0,05 deri 1% maksimum. Ndërsa realiteti nëpër komuna i cili aplikohet, është ky:

- Komuna e Deçanit, aktualisht në vitin 2011 e ka 0,10;
- Gjakova 0,08;
- Gllgovci e ka 0,11;
- Gjilani 0,08;

- Dragashi 0,15;
- Istogu 0,15;
- Klina 0,20.

Prandaj ne flasim këtu për dy momente: Për momentin e normës reale e cila është duke u aplikuar në komuna të caktuara, që në disa prej tyre është 0,15 dhe s'ka nevojë të ngritët, vetëm nëse atë e caktojnë kryetarët e komunave, dhe atë çka e ka dhënë mundësinë Ligji 0,05 që nuk e ka asnjë komunë në Kosovë 0,05.

Prandaj, nuk kemi të bëjmë, realisht me ngritje të normës së tatimit në pronë me mesatare çfarë po përmenden. Në disa komuna do të ketë nevojë që të korrigjohet kjo normë, ndërsa në disa komuna nuk do të ketë nevojë që të korrigjohet kjo normë. Ligji nuk e kërkon.

KRYEESUESI: Faleminderit! Atëherë, shkojmë në votim. Prezentë në sallë janë 85 deputetë. Lus deputetët që të përgatiten për votim, dhe votojmë tani.

Faleminderit! Konstatoj se me 51 vota për, 21 vota kundër, 5 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës, që është:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Hamza që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin. Zoti Hamza, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari, nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Me qëllim të avancimit dhe konsolidimit të bazës ligjore për sistemin financiar në Kosovë, është hartuar Draft-ligji i ri për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare.

Draft-ligji i ri është hartuar në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, standardet dhe direktivat e BE-

së në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, si dhe në përputhje me parimet bazë të Bazelit për mbikëqyrje bankare efektive.

Veprimtaria e institucioneve bankare mikro-financiare dhe jo bankare në Kosovë, është e rregulluar sipas rregulloreve të UNMIK-ut, respektivisht me Rregulloren numër 1999/21 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave, si dhe me Rregulloren numër 2008/28 për regjistrimin, licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve mikro-financiare.

Ndërsa veprimtaria e institucioneve financiare jo bankare është e rregulluar me rregullat e nxjerra nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Rritja e sistemit bankar gjatë dhjetë viteve të fundit në Kosovë, si dhe ndryshimet në praktikën e mbikëqyrjes bankare, shtrojnë kërkesën për nxjerrjen e Ligjit të ri për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet tjera financiare jo bankare me qëllim të reflektimit të ndryshimeve që kanë ndodhur që nga viti 1999 deri më sot.

Draft-ligji i ri, me shfrytëzimin e rregulloreve aktuale në fuqi, do të forcojë kornizën institucionale për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare, duke siguruar qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sektorit financiar.

Ligji i ri do të mbulojë, përveç bankave komerciale dhe institucionet mikro-financiare, edhe ato financiare jo bankare.

Pra, Ligji është i ndarë në dy kapituj:

Kapitulli i parë, do t'i mbulojë bankat dhe veprimtarinë bankare, dhe

Kapitulli i dytë, do t'i mbulojë institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare.

Ligji përmirëson standardet e qeverisjes së bankave, forcon kufizimet për kreditimin e bankave dhe personave të lidhur me bankat dhe lejon mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare.

Dispozitat e këtij ligji i japin autoritet Bankës Qendrore të ndërmarrë masa përmirësuese si dhe të vendosë gjoha administrative për shkelje të ndryshme të Ligjit, e të gjitha këto me qëllim të forcimit të stabilitetit financiar. Po ashtu, tani krijohet mundësia e vënies së bankës nën administrim zyrtar, respektivisht marrjen e kontrollit të bankës me qëllim të rehabilitimit.

Sa i përket institucioneve mikro-financiare, Ligji e përcakton një strukturë të përcaktuar qartë të pronësisë si dhe në të njëjtën kohë eliminon paqartësitë ekzistuese në drejtim të institucioneve mikro-financiare dhe atyre jo bankare.

Në përgjithësi, ky ligj ka për qëllim ndërtimin e një infrastrukture moderne ligjore për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave, institucioneve mikro-financiare dhe institucioneve financiare jo bankare, duke siguruar objektivin e saj kryesor për avancimin e sistemit bankar e financiar të shëndoshë dhe stabil, dhe sigurimit të nivelit të përshtatshëm të mbrojtjes së interesave të depozituarve.

Aprovimi i këtij ligji mundëson harmonizimin në masë aq sa është e mundshme, me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, që do të jetë e dobishme për arritjen e ambicieve të Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Ju ftoj që ta votoni këtë ligj të rëndësishë së veçantë për sektorin financiar të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani hap debatin për diskutim. Kryetarja e Komisionit për buxhet dhe financa, deputetja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për buxhet dhe financa, e ka shqyrtuar Projektligjin për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare.

Komisioni për buxhet dhe financa, e ka vlerësuar progresin e arritur në krijimin e kornizës ligjore për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare, sepse rregullimi me ligj i kësaj fushe ka qenë më se i nevojshëm.

Ky ligj ka qenë shumë i nevojshëm për mbarëvajtjen e një sistemi të qëndrueshëm financiar, sepse deri më tani, sistemi bankar në Kosovë ka qenë i rregulluar me rregullore të UNMIK-ut, veprimtaria e institucioneve financiare po ashtu ka qenë e rregulluar me rregullore të UNMIK-ut kurse veprimtaria e institucioneve jo bankare ka qenë e rregulluar vetëm me Rregullore të Bankës Qendrore.

Meqenëse këto institucione kanë funksionuar pa ligje të mirëfillta, ku rregullohet mënyra e funksionimit të tyre, atëherë vlerësojmë se është shumë e rëndësishme që sot po e shqyrtojmë këtë projektligj që rregullon një sferë shumë të rëndësishme në vendin tonë.

Në këtë projektligj përcaktohet mënyra e licencimit, rregullimi dhe mbikëqyrja e bankave.

Në përgjithësi, në këtë projektligj përmirësohen standardet e qeverisjes dhe krijohet mundësia për një mbikëqyrje më të mirë të këtyre institucioneve dhe për avancimin e një sistemi bankar të shëndoshë e stabil dhe për sigurimin e një niveli më të përshtatshëm të mbrojtjes së interesave të depozitarëve.

Projektligji nuk përmban kosto buxhetore shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe është në pajtim me standardet dhe direktivat e Bashkësisë evropiane, bën avancimin e

bazës ligjore sa i përket veprimtarisë së bankave financiare dhe jo bankare të personave dhe institucioneve që angazhohen në këtë veprimtari, andaj në emër të Komisionit për buxhet dhe financa, ju ftoj ta miratoni në shqyrtim të parë në këtë seancë plenare. Kurse, çdo vërejtje, sugjerim apo rekomandim i deputetëve do të jetë objekt shqyrtimi në Komisionin për buxhet e financa, ashtu që këtij Projektligji t'i bëhen përmirësime e plotësime, ashtu që Ligji të bëhet sa më i implementueshëm në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare, si përfaqësues. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Krasniqi.

(Ndërhyrje)

Atëherë, fjalën e ka deputeti Gashi! Urdhëroni, zoti Gashi, e keni fjalën!
Ju kisha lutur, paraqituni më herët, sepse po është problem me u orientuar.

LATIF GASHI: Faleminderit, nënkryetar!
Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare me të cilin projektligj do të avancohen dhe do të konsolidohen bazat ligjore, që ka të bëjë me veprimtarinë bankare, financiare dhe jo bankare të personave apo institucioneve që angazhohen në këtë veprimtari, andaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, do ta votojë në parim, për lexim të parë.

Vërejtjet dhe rekomandimet tona do t'i japim gjatë procedurave në vazhdim.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Osmani e ka fjalën!

NASER OSMANI: Faleminderit kryetar!
Ne e mirëpresim këtë projektligj i cili rregullon funksionimin e qëndrueshëm të sistemit financiar bankar dhe jo bankar në Kosovë.

Ky projektligj adreson çështjet funksionale dhe organizative brenda sistemit bankar dhe bankave në veçanti. Njëherit, po ashtu, mundëson mbikëqyrjen më efikase dhe efektive të sistemit bankar dhe jo bankar në Kosovë.

Prandaj, Projektligji mbi bankat mund të konsiderohet që ofron apo përmirëson drejtimin e sistemit financiar në Kosovë dhe mbikëqyrjen e tij, duke e ngritur nivelin e sigurisë dhe stabilitetin financiar në vend, dhe po ashtu promovon një komoditet tek depozituesit gjegjësisht investitorët aktual dhe potencialë të sistemit financiar në vend.

Atë, që e kam vërejtur, disa ndryshime esenciale të cilat i promovon drafti, janë:

- organizimi i funksionimit të brendshëm të bankave dhe institucioneve jo bankare;

- organizimi sipas praktikave të mira të menaxhimit të korporatave;
- adreson menaxhimin e kapitalit dhe ngritjen e minimumit të kapitalit themeltar nga 5 milionë në 7 milionë euro;
- përcakton kufizime të reja të koncentrimit të ekspozimit kreditor ndaj një personi apo palëve të ndërlidhura nga 20% të kapitalit në 10%;
- mundëson dhe adreson menaxhimin e riskut apo kategorive të ndryshme të riskut ndaj të cilave institucionet financiare janë të ekspozuara;
- njëherit mundëson përcaktimin apo rregullimin e menaxhimit të institucioneve financiare dhe jo bankare;
- Adreson apo cek sistemin bankar islamik si një mundësi e re për investimet potenciale të sistemit financiar në Kosovë.

Duke i pasur parasysh specifikat e sistemit financiar, ndjeshmërinë dhe rëndësinë e tij për stabilitet dhe zhvillim ekonomik të vendit dhe në mënyrë që ky projektligj të arrijë efekte të përcaktuara, duhet që sa më parë të përcillet me rregullat dhe rregulloret adekuate nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Disa mangësi të cilat janë vërejtur, kanë të bëjnë me atë se nuk i qaset rregullimit të tregut financiar përmes konkurrencës si kategori kushtetuese, gjegjësisht nuk krijon instrumente rregullative mbrojtëse nga përpjekja e mundshme e rrënimit të konkurrencës përmes marrëveshjeve të dyshimta në mes të bankierëve.

Në të njëjtën mënyrë vepron me kategoritë kryesore të riskut kreditor, riskut të tregut, likuiditetit, riskut kamator dhe valutor.

Këto kategori janë jashtëzakonisht të rregulluara në mënyrë perfekte në Marrëveshjen e Bazelit 2 përmes të cilës menaxhmentit i jepet mundësi që në rrethana të caktuara të menaxhojë në mënyrë maksimale me rrisqe me qëllim të minimizimit të riskut, kështu që aktiva e rrezikshme e bankës të jetë në limite të caktuara.

Mirëpo, edhe kjo rregull, në disa raste në këtë krizë globale financiare, është treguar si e gabueshme dhe është marrë si një nga elementet kryesore të rrezikshmërisë në banka.

Grupi Parlamentar, e ka mirëpritur këtë ligj, do ta votojë këtë ligj dhe shpresojmë që ta plotësojmë në punën e komisionit funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje konsideron që ky ligj në përgjithësi është i mirë dhe në njëfarë mënyre e normalizon aktivitetin bankar në Bankën Qendrore të Kosovës.

Ligji me sa duket synon përafrimin e legjislacionit me ligjet e BE-së, veçanërisht që është e nevojshme tash pas reflektimit të krizës globale financiare dhe për këtë arsye duket një ligj i kujdesshëm.

Megjithatë, vërejtjet tona kanë të bëjnë me një frymë që është e pranishme në ligj, frymë e dallimit në mes bankave vendore dhe bankave të huaja, që operojnë në Kosovë përmes degëve, si në paraqitjen e dokumentacionit të regjistrimit ashtu edhe në përzgjedhjen e institucioneve të rregullatorëve të brendshëm, siç janë bordi i drejtorëve, auditimi, e tjera.

Pavarësisht se Ligji nënkupton që edhe këto banka të huaja kanë një rregullim të ngjashëm, pasi rregullohen në shtete prej të cilave vijnë, ne e shohim si pakujdesi këtë frymë që e përshkon Ligjin.

Gjithashtu, vëmë re se institucionet jo bankare, financiare dhe mikro-financiare mund të krijojnë hapësira për aktivitet të pastrimit të parave për shkak të mos rregullimit. Prandaj, konsiderojmë që një rregullim më i fortë për këto institucione nevojitet dhe është i domosdoshëm këtu në Kosovë.

Gjithsesi, në përgjithësi Ligji e forcon Bankën Qendrore të Kosovës në sistemin bankar të Kosovës dhe konsiderojmë se është një Ligj i vlefshëm dhe do të votojmë për të.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Neziraj!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka mirëpritur këtë projektligj dhe e ka shqyrtuar me seriozitet dhe qysh në fillim po cekim se do ta përkrahim.

Mirëpo, me qëllim të rregullimit të veprimtarisë dhe të aktivitetit financiar, bankar dhe të institucioneve financiare, të institucioneve tjera jo financiare dhe mikro-financiare ne i kemi disa vërejtje tona të cilat do t'i japim gjatë leximit të parë dhe kontributi ynë do të jetë në komisionet funksionale dhe në komisionet e përhershme.

Vërejtjet kryesore si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, i ka ato që i përmendi deputeti Osmani dhe po ashtu, tek dënimet që i parasheh Banka Qendrore që të ndryshohen mirëpo edhe te organizatat mikro-financiare.

Unë besoj që organizatat mikro-financiare duhet të kenë ligje dhe rregullore më strikte që do të nxirren nga Banka Qendrore, për arsye se ato aktivitetin e vet në Kosovë e kanë zhvilluar që një kohë të gjatë, të regjistruara si shoqata jo qeveritare, të cilat nuk i kanë paguar tatim këtij vendi dhe të cilat janë paraparë që të zhvillojnë biznese të vogla dhe të mesme, si ndërmarrje të cilat do të jenë bartëse të zhvillimit ekonomik. Ato përkundrazi, me kamata të tyre vetëm kanë dhënë kredi konsumuese dhe shumë pak kanë bërë në drejtim të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ku ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, po e them edhe një herë, janë bartëse të zhvillimit ekonomik dhe në këtë drejtim duhet të mundësohet që kamatat e tyre të jenë shumë të ulëta, me qëllim të zhvillimit ekonomik.

Prandaj, në këtë sferë ne do të analizojmë më tepër. Është një projektligj që do të ketë edhe dëgjime publike, por do t'i marrim parasysh edhe vërejtjet edhe të deputetëve edhe të kolegëve të cilët merren me financa dhe besojmë që të bëhet një projektligj i cili do t'i mbrojë edhe depozitarët por do të jetë edhe i implementueshëm në praktikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, zoti Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar përfaqësues i Kabinetit qeveritar,

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah këtë ligj që të shkojë në procedurë të mëtejme dhe njëkohësisht theksojmë se ky ligj ka bërë një avancim në rregullimin e këtij sektori tejet të rëndësishëm për ekonominë tonë.

Ne mendojmë se janë dy çështje që duhet të meritojnë vëmendje të veçantë në trajtimin e mëtejme, e këto janë: qeverisja korporative e bankave dhe e institucioneve mikro-financiare, si dhe rregullimi më i mirë i konkurrencës.

Tek qeverisja korporative janë një tri probleme, sipas mendimit tim, që duhet t'i analizojmë.

E para. Duhet të shohim kryeshefi ekzekutiv i Bankës a duhet të jetë anëtar i Bordit të Drejtorëve, meqenëse ai duhet t'i japë llogari këtij bordi të drejtorëve dhe kjo mund të jetë një lloj konflikti i interesit. Në praktikën bankare ka raste kur është anëtar i bordit të drejtorëve dhe kur nuk është, por sipas mendimit tim, ndoshta do të duhej ta shqyrtojmë seriozisht mundësinë që kryeshefi ekzekutiv mos të jetë anëtar i Bordit të Drejtorëve. Ishte kjo çështja e parë.

Dhe, çështja e dytë, te qeverisja korporative, ka të bëjë me përbërjen e bordit apo të drejtorëve jo ekzekutivë. Këtu thuhet se duhet të kemi dy të pavarur dhe ky është një problem shumë i theksuar dhe ka qenë një problem në praktikën bankare të Kosovës, sepse e dimë që infiltrimi i aksionarëve në bord ka krijuar falimentimin e një banke dhe i ka prurë edhe një dy banka tjera në një gjendje shumë serioze, pak para falimentimit.

Prandaj, këtu duhet të themi se kjo çështje meriton një kujdes më të madh, e unë do të them se Bordi i Drejtorëve i cili merr vendime për kredi, do të duhej të përbëhej nga shumica e anëtarëve që nuk janë aksionarë dhe që nuk janë në menaxhmentin e Bankës, sepse në atë mënyrë krijojmë një drejtpeshim në qeverisjen korporative midis aksionarëve, midis menaxhmentit, midis depozitarëve, midis krejt akterëve të interesuar lidhur me një bankë të caktuar.

Prandaj, këtë nen dhe këtë pjesë ende duhet ta shqyrtojmë dhe sidomos duhet ta shohim neni 26.3 ku lejohet mundësia që drejtori i pavarur, domethënë mban aksione në bankë.

Këtu e kemi pastaj një konfuzion, midis tri palëve të interesuara për një bankë: të aksionarëve që e kanë mbledhjen e aksionarëve, dhe atje marrin vendime. Kemi bordin dhe kemi menaxhmentin. Prapë, te menaxhmenti kryeshefi ekzekutiv është anëtar i bordit. Këtu do të thotë, kemi një përzierje të këtyre tre akterëve kryesorë, të cilët mund të shprehen negativisht në menaxhimin e bankave.

Prandaj, besoj se ka mundësi që kjo të analizohet edhe një herë dhe të shikohet edhe më mirë.

Ajo që është shumë esenciale, ka të bëjë me faktin se këto nene që i rregullojnë bordet e drejtorëve ekzekutivë në banka, nuk kanë vënë kushte të cilat duhet t'i plotësojnë ata që zgjedhën, anëtarët e bordeve joekzekutivë, anëtarët e bordit të drejtorëve apo drejtorët jo ekzekutiv. Nuk kemi kushte minimale që duhet t'i plotësojnë. Domethënë, kjo është esenciale. Kemi kushte që ata s'mund të jenë, se kanë bërë ndonjë delikt apo vepër penale. Mirëpo këtu janë po aq të rëndësishme përcaktimi edhe i kushteve profesionale që duhet t'i përmbushin ata që zgjedhën në drejtorë të bankave.

Dhe unë e mbështes edhe këtë që u tha këtu se nuk është mirë të krijojmë zgjidhje të ndryshme për bankat e huaja dhe bankat vendore, sepse në atë mënyrë ne mund të rrezikojmë edhe konkurrencën e drejtë.

Çështjet e qeverisjes korporative duhet të rregullohen me ligje të Kosovës dhe çdo bankë që realizon punë në Kosovë duhet tu nënshtrohet ligjeve të Kosovës pa marrë parasysh a është me kapital të jashtëm apo çfarë është.

Sa i përket rregullimit të konkurrencës, mendoj se këtu kemi një hap pozitiv, sepse kemi mundësuar që të hyjnë edhe bankat tjera, siç janë bankat islamike, mirëpo nuk jam i sigurt, sepse ende nuk ka hapësirë që ne të krijojmë një konkurrencë më të madhe e cila do të ndikonte edhe në uljen e normave të interesit sepse interesat e larta në Kosovë janë problemi numër 1 lidhur me funksionimin e bankave. Jo shumë sistemi i stabilitetit bankar, sepse edhe ligji i deritashëm e ka siguruar një stabilitet shumë të mirë të bankave dhe ne duhet të shohim tash athua kemi lënë hapësirë që bankat të kenë ndonjë marrëveshje, të them ashtu, të ndonjë trusti apo të ndonjë oligopoli apo diçka që nuk siguron një konkurrencë të drejtë në tregun e kredisë dhe shprehet me norma të larta të interesave.

Ne do të jemi aktivë në komision dhe mendoj se komisioni ka krijuar kushte optimale për shqyrtimin e kësaj dhe do të ketë dëgjime publike, do të ketë ekspertë të jashtëm të angazhuar përmes GTZ-ës dhe falënderojmë dhe ministrinë që na e ka sjell një projekt kaq të mirë, por ende kemi mundësi t'i diskutojmë këto çështje dhe të bëjmë zgjidhje më të mira. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për 6+, zoti Damka e ka fjalën!

FIKRIM DAMKA:

Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkan yardımcısı, bakanlar, milletvekilleri,

Bankacılık, mikrofinans ve banka dışında kalan finans kuruluşlarını düzenleyen Yasa Tasarısını incelediğimizi ve Kosovanın ekonomi alanında önemli yere sahip olan finans sektörünü düzenlenmesi son derece önemli olduğunu grup adına görmekteyiz. Bankacılık sisteminde bir düzenin olması şarttır, çünkü bankacılık düzenlemesi, bütün ekonomi alanını düzenleyecektir.

Bankacılık ve finans sektöründeki kayıt dışı ekonomiyi ve kayıt dışı para akımının da kontroll altına alınması düzgün yatırımcıya da güven verecektir. Aynı zamanda bankalara halk tarafından da bir güven oluşturacaktır. Bu yüzden 6+ Parlamento Grubu adına bu Yasa Teklifini desteklemekteyiz.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi, e ka fjalën!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e mora fjalën për disa shqetësime që i kam lidhur me këtë ligj.

Parimisht, unë mendoj që ligji duhet të bëhet, mirëpo para se të bëhet ligji duhet t'i adresojmë saktë disa probleme.

Problemet kryesore që unë i identifikojë janë te institucionet mikro-financiare dhe institucionet jo bankare financiare.

Ne e dimë se këto institucione fillimisht kanë operuar deri sot, nëse jam duke gabuar, dhe kanë operuar e operojnë mbi rregulloren e UNMIK-ut dhe janë regjistruar si organizata jo qeveritare me qëllim jo fitimin. Dhe, ne e dimë se duke operuar si të tilla këto institucione jo bankare financiare, kanë arritur që të akumulojnë një kapital të jashtëzakonshëm, kapital i cili mbërrin shuma shumë të mëdha, prandaj unë mendoj se ne duhet si Parlament dhe sidomos si Komision për mbikëqyrjen financiare dhe Komisioni për buxhet e financa t'i drejtohen Bankës Qendrore dhe të marrin një raport prej Bankës Qendrore i cili tregon se cili është kapitali i akumuluar dhe duke marrë parasysh se ky kapital dhe vetë qëllimi i funksionimit të këtyre organizatave është qëllimi jo fitimprurës dhe funksionimi i tyre në interes të publikut, sa këto institucione mikro-financiare apo institucione jo bankare financiare kanë punuar në interes të publikut dhe cilat janë projekte ato që këta i kanë realizuar në interes të publikut.

Këtu i kam parasysh disa elemente shumë të rëndësishme, sepse këto institucione jo bankare financiare kanë akumuluar dhe kanë qarkulluar shumë të madhe parash dhe si rezultat nuk kanë paguar as tatime, as taksa dhe asnjë formë tjetër të obligimeve shtetërore. Kjo edhe ka shkaktuar një pasojë tjetër e cila është akumulimi i një shume të madhe të depozitave dhe likuiditet shumë të lartë dhe çështjen tjetër – mungesën e konkurrencës në treg, konkurrencë në kuptimin e akumulimit të këtyre parave dhe e kthimit prapa si institucione jo qeveritare, sepse ne e dimë që këto institucione jo qeveritare kanë pasur për qëllim interesin e publikut sepse si të tilla edhe janë regjistruar si OJQ.

Duke i pasur parasysh këto elemente, unë mendoj se është shumë me rëndësi dhe jashtëzakonisht me rëndësi që të kemi një raport të detajuar nga Banka Qendrore se sa pare janë akumuluar nga këto institucione financiare jo bankare, si janë përdorur këto institucione financiare jo bankare, po edhe një çështje tjetër që për mua është shumë shqetësuese dhe duhet të merret seriozisht në konsideratë është çështja se me këtë ligj jepet mundësia që këto institucione financiare jo bankare të shndërrohen në institucione me qëllim fitimi, në ndërmarrje fitimprurëse.

Në momentin kur këto shndërrohen në ndërmarrje fitimprurëse çka ndodhë me kapitalin e akumuluar? Si trajtohet ai kapital duke marrë parasysh se ky kapital nuk ka paguar as taksa, as tatime, nuk ka paguar asnjë obligim shtetëror dhe si trajtohet kjo çështje.

Mendoj se duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe në kuadër të këtij kujdesi duhet të kemi parasysh që patjetër Banka Qendrore e Kosovës të jetë e përfshirë në këtë proces dhe Banka Qendrore e Kosovës t'i raportojë Kuvendit nëpërmjet këtyre dy komisionëve se cila është gjendja e këtyre institucioneve mikro-financiare dhe institucioneve jo bankare financiare, sepse me këtë ligj po krijohet mundësia që këto të shndërrohen në kompani fitimprurëse dhe duhet të sqarohen disa çështje se a do të tatimoren reteroaktivisht, a si do të trajtohet ky kapital i akumuluar dhe sa është përdorur në interes të publikut sepse si organizata jo qeveritare kanë pasur për qëllim të punojnë në interes të publikut, dhe kapitali i akumuluar sa është përdorur në interes të publikut. Kaq kisha unë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për fjalë. Përfaqësuesi i Qeverisë, nëse e dëshiron fjalën? Jo, nuk e do fjalën.

Atëherë, në vazhdim po hyjmë në votim. Në sallë janë 72 deputetë. Ju lus të bëhemi gati për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj se me 65 vota për, 2 abstenime, asnjë kundër, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo bankare.

Kërkojmë nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime.

A doni të bëjmë tani një pushim për drekë? Meqë jeni dakord, do të bëjmë një pushim deri në ora 14,30. Faleminderit!

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën pas dite)

(Kryeson mbledhjen, nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Ju lutem, para se të fillojmë, do të ishte mirë që t'i thërrasim ata deputetë që janë në holl sepse janë disa deputetë duhet të udhëtojnë goxha larg dhe ne duhet me i pasur parasysh edhe ata, meqë nuk banojnë në Prishtinë, e meqë moti është i tillë, edhe rrugëtimi është i vështirë.

Atëherë, po fillojmë. Në qoftë se nuk ka kuorum në vijimësi, e lëmë të votojmë më vonë.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës, që është:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor të akcizave

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Hamza që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin. Zoti Hamza, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të përmirësimit të ambientit të biznesit, propozojmë ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor të akcizave.

Kodi i doganave të akcizave ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2008. Me futjen në fuqi të Kodit të doganave dhe akcizës, kaluan Doganat nga kompetencat e UNMIK-ut në kompetencë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjatë përgatitjes së Kodit të doganave dhe akcizës kishim një bashkëpunim të ngushtë me Drejtoratin gjeneral për dogana dhe tatime në Komisionin Evropian në Bruksel.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, ky Drejtorat e certifikoi Kodin që ishte në përputhje me legjislacionin evropian për dogana.

Tani nga ajo periudhë e deri më sot, janë sjell disa direktiva të institucioneve evropiane, që kërkojnë që edhe ne të inkuorpojmë në Kodin e doganave dhe akcizës.

Këto ndryshime dhe plotësime kanë të bëjnë me çështje të sigurisë, që Dogana jonë si të gjitha doganat evropiane dhe ajo e Amerikës i marrin për të ofruar një ambient të sigurt të vendit tonë nga grupe të ndryshme kriminale. Po ashtu, ne me këto ndryshime, në Ministrinë e Financave kemi marrë vendim për uljen e minimumit të kundërvajtjes doganore nga 5.000 euro sa ishte deri më tani, në 500 euro sa kemi paraqitur në Projektligj. Kjo do të jetë në përputhje me direktivat e BE-së që kërkojnë se kundërvajtja doganore të jetë proporcionale me shkeljen e kryer nga tatimpaguesi.

Ministria e Financave, në kuadër të objektivit të saj, për luftimin e korrupsionit të ekonomisë jo formale ka marrë për bazë praktikat më të mira evropiane dhe ka propozuar në projektligj që mallrat të cilat zbulohen nga Doganat e Kosovës me kontrabandë në vlerë deri në 5.000 euro t'i nënshtrohen gjobës administrative prej dyfishë të detyrimeve deri në dhjetë fish. Kjo do të na ndihmojë që të realizojmë qëllimin e luftimit të kontrabandës, korrupsionit dhe që është më e rëndësishme, prokurorët do të shkarkohen nga lëndët me vlera të vogla dhe të rëndësishme të ulët.

Po ashtu, përmes këtyre ndryshimeve, ne kemi futur institutin e zgjedhjes së lëndëve në mënyrë alternative përmes marrëveshjes. Kjo do të jetë shumë e favorshme për biznesin për shkak të shkurtimit të kohës dhe shpenzimeve për zgjedhjet e kontesteve, ndërsa për Doganën për të ardhur deri te të dhënat e vërteta për mallin. Këto marrëveshje do të jenë edhe preventivë dhe mundësi për eliminimin e keqpërdorimeve.

Të nderuar deputetë,

Duke kuptuar rëndësinë e këtyre ndryshimeve në thjeshtësimin e procedurave për lehtësimin e qarkullimit të mallit dhe ngritjen tutje të administratës doganore të Kosovës në standardet më të avancuara evropiane, kërkoj që ta votoni këtë ndryshim-plotësim të Kodit të doganave dhe akcizës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pas prezantimit të Projektligjit, e hap debatin lidhur me Ligjin, për të diskutuar në parim. Radhën e ka kryetarja e komisionit funksional për buxhet e financa, deputetja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar,

I nderuar zoti ministër,

Deputetë të nderuar,

Komisioni për buxhet dhe financa, në mbledhjen e mbajtur me datën 18.1.2012 e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave, numër 03-L/109 ku ka analizuar ndryshimet dhe plotësimet që janë bërë në këtë ligj dhe pas marrjes së sqarimeve nga sponzorizuesi për arsyen e këtyre ndryshimeve, që kryesisht kanë të bëjnë me procedurat e operatorëve të autorizuar ekonomik, procedurën e parashtrimit të deklaratës përmbledhëse, vlerësimin e riskut, procedurën e ankesës dhe kundërvajtjes administrative, i ka vlerësuar këto ndryshime dhe plotësime si pozitive sepse Ligji bëhet më i zbatueshëm dhe i afrohet më shumë direktivave të Bashkësisë Evropiane.

Komisioni unanimsht e ka përkrahur Projektligjin për plotësim dhe ndryshim të Kodit doganor dhe të akcizave dhe ka rekomanduar që në seancën e sotme plenare të miratohet në shqyrtim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare ose i përfaqësuesve të tyre. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-ës, deputetja Krasniqi, e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave Numër 03-l/109 dhe do ta përkrahë në parim.

Ky projektligj ka për qëllim ndryshimet që kanë të bëjnë me procedurat e operatorëve të autorizuar ekonomik, procedurës së parashtrimit të Deklaratës përmbledhëse, vlerësimit të riskut, procedurës së ankesës dhe kundërvajtjes administrative.

Projektligji në fjalë përmban gjithsej 9 nene dhe njëkohësisht është në përputhje me parimet themelore dhe politikat e Bashkimit Evropian. Po ashtu, në aspektin e ndikimit buxhetor, ky projektligj është pa ndikime shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe ne si Grup Parlamentar, kontributin tonë do ta japim nëpër komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Zharku e ka fjalën.

(Ndërhyrje)

Atëherë, më fal! Fjalën e ka deputeti Asllanaj!

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës të shpreh opinionin lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave.

Mendoj se rëndësia e këtij ligji është e jashtëzakonshme, pikërisht për atë se mbi 70% të buxhetit të Kosovës grumbullohet pikërisht nga doganat dhe në këtë aspekt mendoj që çdo proces i ndryshimit dhe thjeshtësimit të procedurave të doganave është i mirëseardhur.

Përkundër këtyre aspekteve pozitive që kanë këto ndryshime, ne vlerësojmë se realisht do të duhej të ruhet zgjidhja e parë, që ka qenë me Ligjin aktual, që në Komisionin për rekrutimin e stafit doganor prapë të qëndrojnë edhe përfaqësuesit e KMDLNJ-ës dhe të gjykatës, kurse procedurat tjera të cilat kanë të bëjnë me operatorët legalë ekonomikë si dhe të riskut të jenë procedura të cilat objektivisht e thjeshtësojnë dhe ndihmojnë bizneset në përgjithësi.

Është diçka që për mendimin tonë është pak një absurditet, sepse në procedurat e ankimimit thirren në Ligjin i cili është në procedurë – Ligji mbi administratën tatimore. Konsiderojmë se nuk mund të thirremi në një procedurë për formimin e divizionit të veçantë pranë gjykatës së qarkut, pa u aprovuar a jo. Pra, është diçka sikur të thirresh në diçka pa qenë.

Në këtë aspekt, konsiderojmë se kontributin më të madh do ta japim edhe në komisionin funksional po edhe si Grup Parlamentar përmes amendamenteve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Edhe Grupi Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje konsideron se ky ligj ose plotësim ligji e përmirëson deri diku Kodin doganor dhe rrjedhimisht është i pranueshëm për Grupin Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

Natyrisht se i kemi disa vërejtje, të cilat nuk po dua me i përmend këtu se tashmë u ngritën si vërejtje, kështu që ato do t'i japim në komisionin përkatës të Kuvendit i cili do të merret me amendamentimin e këtij plotësim-ndryshimi.

Kisha dashur me ngrit vetëm një çështje këtu. E kam pa këtë edhe në Kodin doganor kur i referohet Kosovës, thuhet “Kosova është territor doganor”. Të qenit unik doganor natyrisht se është element i shtetësisë, po nuk është secili shtet doganor shtet, dhe rrjedhimisht konsiderojmë që këtu doemos në këtë kod duhet të përmendet që territori i Republikës së Kosovës është territor unik doganor dhe doganat duhet doemos të quhen Doganat e Republikës së Kosovës për shkak se janë të Republikës së Kosovës. Ne nuk jemi vetëm territor doganor, ne para se gjithash dhe mbi të gjitha jemi Republikë dhe duhet ta trajtojmë veten si të tillë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës, zoti Neziraj e ka fjalën!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuari zoti nënkryetar!

Ministër, dhe kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës e përkrah në parim këtë projektligj, edhe pse disa ndryshime mund të bëhen edhe me akte nënligjore që mund t'i nxjerrë Ministria. Prandaj, e përkrahim dhe kontributin tonë do ta japim nëpër komisione përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe të akcizave, dhe duke marrë parasysh prezantimin i cili u bë nga vetë ministri i Financave për një ambient më të mirë biznesor, dhe duke marrë parasysh se

buxheti i Kosovës për momentin mbushet nga Doganat, atëherë mund të themi se ky ligj është më i përafëruar me konditat e BE-së dhe në parim Koalicioni për Kosovë të Re, e përkrah Projektligjin. Shpresojmë se zbatueshmëria e tij është më e lehtë sesa të ligjit të mëparshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, zoti Marinković!

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, gospodine potpredsedniče!
Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržace u načelu Nacrt zakona o dopuni Carinskog koda i akciza i preko funkcionalnih komisija i stalnih, daće svoj doprinos. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! 6+, deputetja Shinik!

MÜFERRA ŞİNİK: Teşekkür ederim!

Var olan Gümrük Kodu ve Tüketim Vergisi Yasa Tasarısı, ekleme ve tamamlamalarının birinci okunuşunu 6+ Parlamenter Grubu olarak kabul etmekteyiz ve tabi ki katkımızı komisyonlarda sinacağiz. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Zharku, e ka fjalën!

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Të nderuar kolegë,
Ë nderuar minsitër,
Kam një dilemë sa i përket arsyeshmërisë së nenit 252 mbi të drejtën e oficerëve doganorë që të arrestojnë. Ky është mendim i imi personal, dhe mendoj se është në kundërshtim me parimin bazë të funksionimit të doganës që e ka vlerësimin, përcaktimin e doganës, inkasimin e doganës.

E dyta, është një e drejtë që i takon policisë, nuk do t'i takojë doganierit.

Dhe e treta. Besoj se në praktikë është shumë vështirë, është pak rëndë, vështirë me pa, bajat me i pa oficerët doganierë me armë e në anën tjetër, në praktikë është vështirë me arrestuar oficeri doganorë njerëz. E humb kuptimin dogana nga ajo që e kemi një doganë miqësore për biznes dhe për njerëz me kalimin e saj në një, të themi, aparat policor. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Shumë miqësore, bile! Atëherë, zoti ministër, e doni fjalën? Jo. Në vazhdim, shkojmë në votim. Në mbledhje janë prezent 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj se me 61 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në pariam Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit!

Pika e tetë e rendit të ditës, është:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin e të ardhurave të korporatave

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Hamza që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin. Zoti Hamza, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Pa analizave tona në Ministrinë e Financave për tatimin e parashikuar, kemi ardhur deri në vendimin që tatimpaguesit e një korporate, ndërmarrje, shoqërie tregtare dhe një OJQ-ëje për veprimtaritë afariste me të ardhura bruto vjetore deri në 50.000 të cilat tani taten për të ardhura bruto të realizuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme për çdo tre mujor do të paguajnë 9% të ardhura bruto vjetore por jo më pak se 37.5 euro për tremujor.

Këtë vendim për ngritjen e tatimit të parashikuar për tatimin e paguesit të lartshënuar e kemi marrë me konsultim dhe jemi në pajtim të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe komunitetin e biznesit.

Deri më tani kjo kategori e tatimpaguesve ka qenë më e privilegjuar në pagesë të tatimit të parashikuar kundrejt tatimit të pagesave tjera me normë më të ulët të tatimit për të ardhur bruto vjetore deri në 50.000 euro të cilat janë tatuar për të ardhurat bruto të realizuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme.

Me ngritjen e normës së tatimit të parashikuar nga 5%, sa është deri më tani, në 9% arrijmë që tatimpaguesit e një korporate, ndërmarrje, një shoqërie tregtare dhe një OJQ-ëje për veprimtaritë afariste të tatimohen me normën reale të tatimit të parashikuar.

Edhe Ligji pasues, që do të vjen, e që ka të bëjë me tatimin e të ardhurave individuale. Edhe ky ligj qëllimin e ka që disa veprimtari... Dihet se të gjithë ata që i realizojnë pagat përmes buxhetit të Kosovës apo në biznesin privat për të gjitha të ardhurat e tyre të realizuara mbi 450 euro paguajnë 10%.

Të gjitha ndërmarrjet që paguajnë tatim në fitim të korporatave paguajnë 10%. Ndërsa, disa kategori të profesionistëve, siç janë avokatët, kontabilistët dhe kategoritë tjera, edhe

me të ardhurat e tyre deri më tash kanë paguar 5%, prandaj qëllimi është që këto të barazohen me kategoritë tjera, që paguajnë tatim 90%. Prandaj, ju lus që këtë projektligj ta votoni.

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës dhe rregullës, kryetarja e komisionit funksional për buxhet e financa, deputetja Hadergjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për buxhet e financa unanimisht e ka përkrahur plotësim- ndryshimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave që ka të bëjë me ndryshimin e normës për pagesën e tatimit për veprimtaritë afariste me të ardhura bruto vjetore deri në 50.000 euro të cilat tatohen për të ardhurat bruto të realizuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit e të ngjashme si dhe me ndryshimin e procedurave të ankesës.

Projektligji nuk ka kosto shtesë buxhetore por përkundrazi reflekton në rritjen e të hyrave buxhetore. Këto ndryshime të cilat janë bërë në këtë projektligj nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane, por përkundrazi i afrohen legjislacionit të Bashkësisë Evropiane, prandaj Komisioni për buxhet e financa i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë miratimin e këtij projektligji në parim dhe të gjitha rekomandimet apo sugjerimet të cilat i japin deputetët e Kuvendit të Kosovës ne do t'i kemi në shqyrtim në Komisionin për buxhet dhe do t'i kemi parasysh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-ës, deputetja Krasniqi, e ka fjalën!

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Duke pasur parasysh se Ligji i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e parapara me Ligj për lexim të parë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të jetë pro këtij projektligji dhe në vazhdim do të kontribuojmë në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-ës, zoti Zharku!

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-ës do ta votojë në parim. E vetmja çështje, besoj se ndoshta do të ishte mirë që krahas rritjes së përqindjes së tatimit të rritet edhe në vlerë absolute shuma minimale për pagesë. Nëse, pothuaj se e kemi dyfishuar prej 5.9 do të ishte mirë që edhe 37.5 t'i afrohet, 65 apo 70.

Përndryshe, në parim do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje konsideron që, meqenëse po flasim për tatime tash dhe jemi duke folur për një kategori të caktuar, domethënë të tatimpaguesve, jo për të gjithë ata që e paguajnë tatimin, konsiderojmë se ky ndryshim nuk do të ketë kushedi çfarë ndikimi në përgjithësi, as në aspektin e barazisë, sikur që e përmendi ministri, por as në aspektin e të hyrave buxhetore, konsideroj.

Natyrisht, se sistemi tatimor në Kosovë është, mendoj unë, goxha i pa barabartë meqenëse shumë më pak kërkohet që të paguajnë ata që fitojnë më shumë dhe shumë më shumë kërkohet të paguajnë nga ata që fitojnë më pak dhe konsideroj se një ndryshim i tillë i nevojitet sistemit tatimor të Kosovës e jo kësi ndryshime kozmetike, të cilat po i bëjmë tash.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje do të votojë kundër këtij ligji edhe të Ligjit tjetër që e kemi, do të thotë, për të ardhurat personale, i cili pak a shumë, apo saktësisht e mbulon të njëjtën kategori të njerëzve.

Unë konsideroj që, po qe se personat të cilët marrin të ardhura personale nga këto kompani, korporata apo ndërmarrje që u përmendën këtu, domethënë që mbulohen me këtë ligj, atëherë ata me të ardhura personale, natyrisht, do të duhej t'i nënshtroheshin përshkallëzimit të tatimeve, siç e kanë të gjithë tjerët që marrin paga, pra të paguajnë tatim në paga. Ndërkohë që, për sa i përket korporatave, këto janë ndërmarrje të cilat qarkullimin e kanë më të vogël se korporatat të cilat, do të thotë, mund të konsiderohen korporata që paguajnë tatim përmbi 50.000 euro qarkullim vjetor dhe rrjedhimisht nuk do të duhej që këto pastaj të paguanin normën e njëjtë të tatimit.

Dhe, kur kemi parasysh këtu, me përjashtim të ndoshta avokatëve dhe disa shërbimeve tjera, dhe kur i kemi parasysh zanatet dhe shitoret e vogla të cilat mezi e mbulojnë muajin e tyre, e tash t'i rëndojmë më shumë me tatime, nuk mendoj se kjo i kontribuon zhvillimit të bizneseve të vogla në përgjithësi në Kosovë, siç pretendohet nga kjo qeveri se edhe do ta bëjë.

Prandaj, ne jemi kundër këtyre dy ndryshimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-ës, zoti Neziraj!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi i Aleancës e përkrahë në parim dhe kontributin tonë do ta japim nëpër komisione përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatim në të ardhurat e korporatave dhe duke marrë parasysh prezantimin i cili

na u bë nga ministri, e po ashtu i përkrah vërejtjet dhe sugjerimet të cilat i dha kolegu Zharku dhe shpresoj se gjatë amendamentimit të Projektligjit në Komisioni do ta ketë mundësinë që ky projektligj të kompletohet dhe të gjejë zbatueshmëri shumë të mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, deputetja Kostiq!

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

I Parlamentarna grupa Samostalne Liberalne stranke je razmotrila Nacrt zakona i podržaće u načelu, a doprinos daće u Komisiji. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! 6+, Mufera Shinik.

MÜFERRA ŞİNİK: Teşekkür ederim sayın başkan vekili,

Ortak Şirketlerin Gelir Vergisine ait Yasa Tasarısında ekle ve tamamalamalara ihtiyaç duyulmaktadır. Bu yüzden bu konuyla ilgili komisyonlarda katkımızı sunacağız, öyleki birinci okunuşunu 6+ Parlamenter Grubu olarak kabul etmekteyiz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, e ka fjalën!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë flas për dy ligjet, për këtë dhe Ligjin që vjen pas këtij dhe dua të tërheq vëmendjen e qytetarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të këtij Parlamenti se si rezultat i keqmenaxhimit të buxhetit dhe planifikimit jo të drejtë të të hyrave dhe shpenzimeve, kjo Qeveri deri tash është financuar nga rezervat buxhetore që i kanë krijuar qeveritë paraprake e tash e tutje po planifikon t'i financojë me shitjen e aseteve publike, e pse jo duke i ndëshkuar edhe bizneset.

Ne e dimë shumë mirë se Qeveria ka premtuar rritje të punësimit 10%, rritje ekonomike 8%, përmirësim të ambientit të biznesit në përmasa ekstreme, e këto nuk mund të rriten me rritjen e tatimeve.

E vetmja gjë që mund të arrihet me rritjen e tatimeve është pagesa e faturave të Behtelit.

Në gusht të vitit të kaluar, ministri pati pas një fushatë me bizneset dhe odat ekonomike dhe iu pati premtuar atyre një pako të re fiskale, e cila në vete përmbante lirim nga taksa doganore e lëndës së parë, lirim nga taksa doganore për ambalazh, lirimi i TVSH-ës për mjetet kapitale, lirim nga tatimi në fitim, mandej zvogëlimin e kamatave.

Qeveria e ka marrë një vendim që ta bëjë zvogëlimin e kamatave dhe ne e përshëndesim këtë akt, edhe pse asnjëherë bizneset nuk kanë realizuar kamata, e këtë e kemi konfirmuar nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe do të thotë asnjëherë në historinë e ATK-ës asnjë biznes nuk ka marrë kamatë për rimbursimet e vonuara.

Kjo pako në gusht të vitit të kaluar u pat premtuar që do të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2012, kurse tash kur pyesim, thonë se do të hyjë në fuqi gjatë vitit 2012. Mirëpo, pas kësaj pasoi një vizitë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar i tha Qeverisë tonë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave se kjo pako me kapacitetet që i keni në administratën tatimore është e pamundshme të realizohet. Kështu që ata i rekomanduan Qeverisë që me shpenzimet që i ka planifikuar, ajo duhet t'i rrisë disa tatime.

Prandaj, me këtë nuk u lejua përshkallëzimi i TVSH-ës, se Qeveria pati planifikuar ta lirojë TVSH-ën deri në 7% për produktet jetësore, siç janë buka, vaji, mielli e të tjera dhe ta ngris për produkte tjera në 17% gjë që do t'i sillte Qeverisë humbje prej 4 milionëve për lirimin e TVSH-ës në 7% mirëpo do t'i sillte të hyra prej 32 milionëve.

Meqenëse kjo nuk ndodhi, Qeveria u detyrua të marrë masa për rritjen e tatimeve në sfera të tjera.

Ne kërkojmë nga Qeveria e Kosovës t'i mbajë premtimet. Ne kërkojmë që të implementohet pakoja e re fiskale.

Ndoshta po dal pak prej temës, sepse po diskutojmë, do të thotë për një ligj tjetër tani, mirëpo është shumë diskutabile dhe është shumë aktuale kjo.

Pra, ne kërkojmë që të ka përshkallëzim të TVSH-së, sepse është më se e nevojshme që TVSH-ja, e kjo është shumë aktuale, do të thotë të lirohen nga TVSH-ja deri në 7% dhe të bëhet përshkallëzimi i TVSH-së për produktet që iu duhen njerëzve për të mbajtur familjet e tyre gjallë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti Kuleta, e ka fjalën!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!
Lëvizja për Bashkim konsideron se rritja e shkallës tatimore nga 5 në 9% mbi qarkullimin total, për bizneset që ofrojnë shërbime është masë që prodhon dekurajim të këtyre të fundit.

Gjithashtu konsiderojmë se në këtë rast po përdoren standarde të dyfishta për biznese që ofrojnë shërbime ndaj atyre tregtare dhe prodhuese.

Përveç kësaj, nëse rritet tatimi për një biznes që ofron shërbime, në fakt kemi rritur koston edhe të atyre bizneseve që prodhojnë sepse në funksionimin e tyre edhe ata pranojnë shërbime të ndryshme nga këto biznese.

Diferenca e shkallës tatimore midis këtyre llojeve të bizneseve me ligjin e vjetër ka qenë më arsyeshme, pra 3% për biznese që merren me tregti dhe prodhim, ndërsa 5% ato që merren me shërbime. Kjo ka ndikuar në ruajtjen e njëfarë bilanci midis tyre dhe mund të thuhet se është përdorur njëfarë standardi i përafërt.

Siç e përmenda më lartë, rritja e kësaj shkalle tatimore i dekurajon bizneset e vogla dhe konsiderojmë se është në kundërshtim me planin strategjik të Qeverisë, ku si një prej synimeve theksohet pikërisht përkrahja e këtyre bizneseve.

Prandaj, në këtë kuptim, rritja e shkallës tatimore për to, gati për dyfishin e asaj që ka qenë, nuk mund të përkthehet si përkrahje por vështirësim i kushteve për bërje biznes.

Dihet që ekziston mundësia ligjore që edhe bizneset që e kanë qarkullimin nën 50.000 euro në mënyrë vullnetare të regjistrohen për pagesën e tatimit në fitimin real duke aplikuar shkallën tatimore prej 10%.

Prandaj, duke pasur parasysh këtë mundësi me rritjen e kësaj shkalle prej 5 në 9%, praktikisht të gjitha këto biznese do ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe në mënyrë vullnetare do të kalojnë në mënyrën e pagesës së tatimit në baza reale të fitimit, gjë që bënë që planifikimi për rritjen e të hyrave nga këto tatime midis 150.000 e 500.000 euro përmes rritjes së shkallës tatimore prej 5 në 9%, të dalin të dështuara.

Gjithashtu një vërejtje tjetër është edhe ajo që ne e kemi konsideruar si jo profesionalizëm, i treguar me rastin e parashikimit të shifrave të të hyrave. Aty ku flitet për shifrat e parapara thuhet: prej 150.000 deri në 300.000. Pra, diferenca midis minimumit dhe maksimumit është paradoksale sepse në fakt maksimumi paraqet dyfishin e minimumit. Pra diferenca midis 150.000 e 300.000 është plotë 150.000 euro. faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur. Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Hamza!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Me respektin më të madh, dhe konsideratën më të madhe për kohën e deputetëve, edhe pse ne po diskutojmë sot një ligj shumë specifik. Mirëpo u ngritën disa tema që s'kon fortë të bëjnë me këtë ligj, siç është rritja e buxhetit dhe rritja e buxhetit nuk ka ardhur në Kosovë si rezultat i suficitit nga vitet e kaluara, por ka ardhur edhe si rezultat i rritjes së hyrave për buxhetin e Kosovës dhe vetëm në vitin 2011, në krahasim me vitin 2010, të hyrat të cilat i administron Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës e kanë pasur një rritje prej 18% apo shprehur në milionë janë 167 milionë më tepër.

Sa i përket rritjes ekonomike, Kosova vlerësohet që për vitin 2011 e ka pasur një rritje ekonomike 5.3% dhe ju lutem referojuni raporteve të Bankës Botërore, që është prej rritjeve më të mëdha në regjion.

Ndërsa, sa i përket reformave fiskale, çdo ditë janë duke ndodhë veprime në përmirësimin e ambientit për biznes.

Ju e dini që është marrë vendim për uljen e normave të kamatave të cilat i aplikon Administrata Tatimore me rastin e vonesës së pagesave të tatimeve. Është ndërruar

momenti i pagesës së akcizës me rastin e importit të produkteve të duhanit, janë thjeshtësua dokumentet të cilat janë të nevojshme me rastin e importeve, eksporteve dhe nga 9 dokumente janë sjell në 3 dokumente.

Ju e dini se është proceduar Ligji për lirimin e mediave të shkruara dhe elektronike nga pagesa e TVSH-së dhe e universiteteve private, e po ashtu edhe shërbimeve mjekësore.

Më herët janë zvogëluar ndëshkimet për kundërvajtje nga 5000 në 500 dhe ne jemi çdo ditë duke marrë veprime të cilat kanë për qëllim krijimin e një ambienti më të favorshëm për biznesin. Dhe, qëllimi ynë është që ne të lëvizim, dhe të gjithë këta të cilët janë duke paguar aktualisht këtë lloj tatimi me normën prej 5% të lëvizin dhe të hyjnë në formën e pagesës së tatimit në bazë të ardhurave reale.

Këta kanë të drejtë të zgjedhin dhe nëse këta mendojnë që është më e përshtatshme për ta atëherë normalisht që ligji ua njuh edhe të ardhurat e tyre dhe nga të ardhurat e tyre i zbriten shpenzimet dhe mbi bazën e të ardhurave reale ata mund të përcaktohen për pagesën e tatimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

(Ndërhyrje)

Në mbledhje janë prezentë 73 deputetë.

Arben nuk ka nevojë për këtë! Rregulli është. Deputetja e ka pasur fjalën 10 minuta, e ka thënë fjalën e vetë. Ministri kur ta përfundojë fjalën e vet, nuk ka më, dhe më tutje nuk zhvillohet debat.

(Ndërhyrje)

Po, kështu është rregullorja! Ndryshoni rregulloren ju, ndryshoni rregulloren mua nuk më prishë punë asgjë, unë as që ta marrë fjalën.

Në mbledhje janë prezentë 73 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet se me 50 vota për, 16 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e nëntë e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Hamza që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAZMA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale, caktohet që veprimtaritë afariste me të ardhura bruto vjetore deri në 50.000 euro, të cilat tatohen për të ardhura bruto të realizuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme në çdo 3 mujorë të paguajnë 9% të ardhura bruto, por jo më pakë se 37.5 euro për tatim 3 mujor.

Deri më tani norma e tatimit e parashikuar për këto veprimtari ka qenë 5% të ardhura bruto. Deri te ngritja e normës së tatimit të parashikuar ka ardhur për dy arsye:

E para, për shkak të kërkesave për të hyra më të mëdha buxhetore, dhe e

Dyta për eliminimin e diskriminimit me personat që paguajnë tatim në të ardhurat personale në paga.

Edhe kjo normë e tatimit e propozuar prej 9% në Ligjin për të ardhurat personale është harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në pëlqim të plotë me komunitetin e biznesit.

Me ngritjen e kësaj norme ne do ta eliminojmë dallimin në mesë të tatimpaguesve të lartshënuar dhe do të kemi të hyra reale.

Prandaj, duke parë rëndësinë e ndryshimit të normës së tatimit të parashikuar kërkoj që ta votoni këtë ndryshim plotësim të Ligjit për tatim në të ardhura personale.

Deri më tani të gjithë ne që realizojmë paga, pavarësisht prej buxhetit apo në sektorin privat dhe janë në lartësi më të madhe se 450 euro këto tatimohen me 10%. Ndërsa kategoritë si avokatët, kontabilistët, këngëtarët që realizojnë paga ndoshta edhe 3.000, 4.000 euro në muaj ata paguajnë 5%. Prandaj, qëllimi është që edhe të kemi të hyra më të mëdha për buxhetin e Kosovës por realisht edhe këta trajtohen barabar sikur të tjerët që për lartësinë mbi 450 euro paguajnë 10% tatim në të ardhurat individuale. Faleminderit!

KRYESUESI: faleminderit!

Radhën e ka kryetarja e komisionit funksional për buxhet dhe financa, deputetja Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit!

Komisioni për buxhet dhe financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale, që ka të bëjë me ndryshimin e normës së pagesës së tatimit për veprimtaritë afariste me të ardhurat bruto vjetore mbi 50.000 euro, si dhe përkrahë edhe disa ndryshime të cilat janë bërë në procedurën e ankesës.

Komisioni për buxhet dhe financa unanimisht i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë në shqyrtim të parë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, sipas radhës, në emër të PDK-së deputeti Latif Gashi.

LATIF GASHI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhura personale.

Gjithashtu me këtë projektligj paraqitet ndryshimi i normës për pagesën e tatimit për veprimtarinë afariste në të ardhura bruto vjetore deri në 50.000 euro të cilat tatohen për të ardhurat bruto të realizuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të arkëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori dhe ndryshimi i procedurës së ankesës.

Andaj, Grupi Parlamentar i partisë Demokratike të Kosovës do ta votojë në parim për lexim të parë. Gjithashtu vërejtjet dhe rekomandimet tona do t'i japim gjatë procedurave në vazhdim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kush e ka fjalën? Deputeti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Në kuadër të këtyre ndryshimeve fiskale që sot janë paraqitur përmes këtyre projektligjeve, ne këtij projektligji i japim përkrahje në parim, për vetëm një arsye se krijohet një bazë reale e pagesës së tatimit në të ardhurat personale apo individuale.

Këtë e them se deri më tani me të vërtetë ka pasur një diskrepancë të madhe ndërmjet atyre të cilët kanë kontribuar përmes tatimeve nëpërmes formave të ndryshme, sidomos në këtë që e quajti edhe ministri, të veprimtarive profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme.

Por për një vërejtje e jona që është shumë parimore, mendoj dhe ne mendojmë që duhet të saktësohen dhe të definohen me ligj që këto që quhen veprimtari profesionale, të

zanatit dhe të argëtimit të jenë të definuara mirë dhe të saktësohen edhe me ligj. Sepse edhe vetë ministri i përmendi 2 – 3, ndoshta ka edhe më shumë të tjera, e të cilat i kontribuojnë normës reale të tatimpaguesve në të ardhurat individuale.

Prandaj, ne i japim përkrahje në parim dhe përmes anëtarëve tonë në komisionin funksional, do të ngrisim këtë çështje dhe të definohet qartazi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Vetëvendosjes kryetari i Grupit Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Pra, ato vërejtje që i dhashë në Ligjin e mëparshëm për tatime për korporata, natyrisht se qëndrojnë edhe për këtë, dhe iu referova edhe këtij ligji edhe këtij ndryshimi, për shkak të ngjashmërive në të.

Mendoj se ministri që i përmendi disa kategori të cilat do të mbulohen me këtë ligj, mendoj që i zgjedhi qëllimisht, me shumë kujdes cilat kategori. Pra tha, avokatët, këngëtarët e këta që të gjithë e dinë që fitojnë shumë dhe do të tatohen shumë, dhe po pajtohem plotësisht.

Mirëpo, në këtë nen, në të njëjtin nen, tash ministër, të bëhemi realë - mbulohen edhe disa veprimtari tjera profesionale edhe të zanatit, të cilat edhe nuk fitojnë edhe aq shumë, dhe duhet me pas parasysh që dallimi prej 0 në 50 mijë nuk është i vogël, është shumë i madh. Pra, është një kategori jashtëzakonisht e gjerë me të cilën rritja e tatimit për të cilën, natyrisht disa i shtynë me pagua më shumë tatim, po disa tjerë i ndëshkon goxha shumë. Edhe unë mendoj që këtë dallim duhet me bë.

Prandaj, kur fola për ndryshimin rrënjësor të sistemit tatimorë në Kosovë është e domosdoshme që ta kemi një sistem tatimor i cili është më kompleks, është më i komplikuar, mirëpo i cili natyrisht është më i barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Për shkak se me këtë thjeshtësinë të cilën po e aplikojmë këtu në Kosovë, sikur në sistemin tatimorë por edhe të tjera, me thjeshtësinë të cilën po aplikojmë me shumicën e rasteve pra përveç tatimin në pagë krejt të tjerat i kemi tatime të thjeshta. Atëherë ne në një farë mënyre po shkaktojmë shumë pabarazi ndaj qytetarëve të Kosovës, po edhe në anën tjetër po e thjeshtësojmë aq shumë shtetin deri në zhdukjen e tij.

Pra, në vend se të investojmë në ngritjen e kapaciteteve shtetërore të Administratës Tatimore, të Doganave të Kosovës e kështu me radhë ne po shkojmë duke ua pamundësuar atyre zhvillimin, rritjen dhe profesionalizmin, për shkak se me thjeshtësimit tatimor natyrisht që nuk mund të presim një profesionalizëm shumë të madh të inspektorëve tatimorë kur sistemi tatimorë është kaq i thjeshtë.

Secili shtet demokratikë në botë me ekonomi të zhvilluar, sistemi tatimor e ka kompleks, edhe ky kompleksitet ka ardhur si rrjedhojë historike e ngritjes së nivelit të barazisë në

atë se kush sa fiton, sa paguan për të mirën e përgjithshme. Këtu në Kosovë po e mohojmë këtë gjë.

Prandaj, kur t'i përmendësh kategoritë që po i mbulon neni, përmendi të gjitha. Mos i përmend vetëm disa, të cilat e din se do të tingëllojnë mirë në veshë të qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, Xhevdet Neziraj, e ka fjalën.
Urdhëro deputet!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!
Zoti ministër,
Grupi i Aleancës e mbështetë në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Koalicioni për Kosovë të Re, e përkrahë në parim Projektligjin për tatim në të ardhurat personale dhe shpresoj që Ligji të gjejë zbatueshmëri shumë të mirë, edhe siç u prezantua nga ministri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së? Milivoje Stojanović, e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala, predsedniče!
Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala ovaj Nacrt zakona odnosno izmenu i dopunu ovog Zakona i podržaće ove izmene. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit “6+”, deputetja Myferra Şinik, e ka fjalën.

MÜFERRA ŞINIK: Teşekkür ederim sayın başkan,
Kişisel gelirler vergi yasasının değişme ve tamamlamalarına ait Yasa Tasarısında dikkat edilmesi gereken çok önemli eklemeler var, bu eklemeleri gerekli komisyonlara grup olarak sunacağız. Onun dışında 6+ Parlamento Grubu olarak bu Yasa Tasarısını kabul etmekteyiz. Teşekkür ederim

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të lajmëruar për diskutim. Ministër, a e do fjalën? Urdhëro e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Se sistemi tatimor, Kosova është i thjeshtë apo i komplikuar - sistemi tatimor në Kosovë është në harmoni dhe përputhshmëri me sistemin e tatimeve i cili funksionon brenda

Bashkimit Evropian. Në gjithë Evropën e kemi TVSH-në, e kemi tatimin në fitim të korporatave, e kemi tatimin në fitim të ardhurave individuale.

Prandaj, qëllimi dhe një prej parimeve bazë të tatimeve është edhe parimi i drejtësisë. Nuk munden kategori të caktuara, nuk mundet një minator i cili punon në minierë të paguan për të ardhurat të cilat i realizon më tepër se 450 euro 10%, ndërsa disa kategori profesionistësh të cilët realizojnë paga më të mëdha me një lehtësi më të madhe të kenë normën e tatimit 5%.

Prandaj, një prej parimeve është edhe parimi i drejtësisë dhe qëllimi jonë është që të gjithë tatim paguesit maksimalisht t'i trajtojmë barabar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Vazhdojmë me procesin e votimit.

Sa deputet i kem në sall, a e dimë?

I kemi prezentë 67 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 47 vota për, 5 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Punës së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin, ministër e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAZMA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Në vështrim të Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat numër 03/L-222 është themeluar Bordi i Pavarur për Shqyrtime.

Bordi i Pavarur për Shqyrtim, megjithë përkushtimin për ta ndihmuar, asnjëherë nuk ka qenë në situatë për zgjedhjen e ankesave brenda afatit ligjor.

Deri më tani në bord janë grumbulluar një numër i konsiderueshëm i ankesave të cilat janë në pritje për zgjedhje për disa vite.

Statusi i pazgjedhur i Bordit të Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave është kritikuar në Raportin e progresit të Komisionit Evropian por edhe po ndikon në rritjen e riskut për keqpërdorim në Doganë dhe Administratë Tatimore të Kosovës.

Po ashtu, kjo gjendje nuk është në përputhje me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut, e cila është e aplikueshme te ne në mënyrë të drejtpërdrejtë në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Po ashtu nuk është e drejtë ndaj bizneseve që presin zgjedhje të ankesës për 2 apo 3 vite.

Me asistencën e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë, neve me këtë projektligj e kemi vendosur bazën ligjore për themelimin e divizionit fiskal i cili do të jetë në kuadër të Departamentit të Ankesave të Gjykatës Qendrore në Prishtinë.

Qëllimi ynë është që me hyrjen në fuqi të Ligjit për gjykata në janar të vitit 2013 të funksionalizohet Divizioni i Ankesave ku në të ardhmen ankesat e Doganës, të Administratës Tatimore të Kosovës dhe të Departamentit të Tatimit në Pronë të gjykohen nga gjykatësit të cilët do të zgjedhën në fillim të këtij viti nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe do të trajnohen për legjislacione tatimore dhe doganore gjatë vitit 2012.

Në Projektligj e kemi caktuar të gjithë procedurën e ankesës dhe kompetencës lëndore dhe territoriale për gjykimin e ankesave.

Themelimi i Divizionit të Ankesave përveç që do t'i ndihmojë shumë bizneset në zgjedhjen e ankesave në mënyrë ekonomike, efikase dhe profesionale - do t'i ndihmojë Doganës dhe Administratës Tatimore që të zhvillohen më shumë profesionalisht.

Po ashtu, në këtë projektligj kemi caktuar edhe fazën kalimtare të Bordit të Pavarur për Shqyrtim, i cili është duke funksionuar sot.

Për të realizuar këtë reformë të gjyqësisë fiskale në Kosovë, ju lus që ta votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit funksional për buxhet dhe financa, deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për buxhet dhe vinanca e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat dhe e ka përkrahë në parim këtë projektligj.

Komisioni për buxhet dhe financa i ka vlerësuar si pozitive këto ndryshme të cilat janë bërë në kuadër të këtij projektligji, që kanë qenë ndryshime të domosdoshme për tu bërë sepse ne jemi dëshmitarë këtu që sa herë që e kemi shqyrtuar Raportin e progresit ne kemi marrë vërejtje pikërisht për çështjen e Bordit të Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave. Prandaj, me këto plotësime ndryshime të këtij ligji bëhet një ngritje e këtij bordi, që do të thotë është bërë përmirësim dhe janë rregulluar më mirë çështjet që kanë të bëjnë me procedurat e ankesave.

Vërejtjet kryesisht kanë qenë në forcimin e kapaciteteve të këtij bordi dhe në plotësimin e kushteve që në fakt në mënyrën se si ka funksionuar deri më tani, nuk kanë qenë të përshtatshme.

Prandaj, Komisioni për buxhet dhe financa i rekomandon Kuvendit që ta miratojë në parim këtë projektligj, kurse vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet e deputetëve, meqenëse ka të bëjë me përgjegjësi tjera të këtij bordi, ne do t'i analizojmë dhe shqyrtojmë me kujdesin më të madh në Komisionin për buxhet dhe financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-222 për Administratën tatimore dhe procedurat, duke pasur parasysh se organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e gjykatave në Republikën e Kosovës, do të ndryshoj nga janari i vitit 2013 sipas Ligjit numër 03/L-199 për gjykatat, atëherë është e domosdoshme që Projektligji për Administratën tatimore dhe procedurat të harmonizohet me Ligjin për gjykatat.

Projektligji në fjalë ka për qëllim themelimin e Divizionit fiskal dhe ndryshimin e procedurës së ankesës, në bazë të të cilit kompetencat e Bordit të Pavarur për Shqyrtime të transferohen në kompetencat e Divizionit Fiskal, i cili do të veprojë në kuadër të Departamentit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Ky projektligj vlerësohet pa ndikime buxhetore për vitin 2012 dhe nuk cenon parimet themelore të BE-së.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta përkrahë në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisione funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ndryshimet që shihen në Ligjin për Administratën tatimore dhe procedurat.

Realisht ne jemi skeptik pak a shumë, se bëhet një ndryshim esencial i Bordit të Pavarur për Shqyrtime, i cili do të bartet në kompetencë në gjykatat themelore - konkretisht krijimi i një Divizioni të ri fiskal brenda Gjykatës Themelore dhe kjo detyrimisht nënkupton se pak a shumë ne hezitojmë sipas neneve të paraqitura, se krijon një konfuzitet rreth përgjegjësisë që do merret nga gjykata kompetente dhe trajtimi i deritanishëm i këtij bordi për shqyrtime, i ashtuquajtur i pavarur, edhe pse për ne asnjëherë nuk ka qenë i pavarur.

Prandaj, kështu si është në këtë formë ne i japim përkrahjen në parim, dhe mendojmë që duhet një vëmendje shumë më e veçantë sepse ngritë një dilemë rreth krijimit të Divizionit të ri fiskal në Gjykatën Themelore dhe çështjeve të bartura nga e kaluara.

Parimisht, e përkrahim, por duhet një fokus shumë më i gjerë dhe një diskutim shumë më gjerë edhe me Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Vetëvendosjes, deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrahë në parim këtë ligj.

Natyrisht këto vërejtje që i kemi në të, do t'i paraqesim përmes komisioneve. Këtu disa u përmendën, e disa të tjera do të paraqiten përmes Komisionit në mënyrë që ta bëjmë këtë ligj edhe më të mirë se që është, ose një plotësim edhe më të mirë se sa që është sjell këtu nga Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj, e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuari zoti kryetar,

I nderuar zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrahë në parim këto ndryshime dhe dëshirojmë që mos të pritët si në Bordin e Ankesave me 2 – 3 vite dhe shpresojmë që nuk do të na vije më që të lypet ndonjë mekanizëm shtesë për zgjedhjen e këtyre problemeve dhe besojmë që do të gjendet një mekanizëm më efikas në zgjedhjen e problemeve se sa Bordi i gjertanishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat.

U tha nga gjithë kolegët këtu çështja e Bordit për Ankesa dhe formimi i një Divizioni Fiskal i cili shkon nëpërmes Gjykatës Themelore, dhe do të shohim lidhur me çështjen e amendamentimit të këtij projektligji, duke marrë parasysh se këto ankesa të bizneseve duhet të kenë konsideratë shumë të madhe.

Atëherë, Koalicioni për Kosovë të Re e përkrahë në parim Projektligjin dhe shpreson që gjatë amendamentimit të gjitha dilemat të hiqen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së, deputeti Goran Marinković, e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržava u načelu Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o poreskoj administraciji i proceduri, i radom u komisijama daće svoj doprinos. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të “6+”, deputetja Duda Balje, e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona za poresku upravu i postupke, čije je cilj formiranje fiskalne divizije izmena postupka žalbe, Parlamentarna Grupa „6+“ podržava i svoj dalji doprinos daće kroz rad u funkcionalnoj komisiji.

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e diskutuesve. Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Kam rezerva në dy çështje. Çështja e parë ka të bëjë me përparsimin e tatim paguesve para gjykatës kompetente. Ligji në mënyrë decitive nuk e ndalon, por thotë “tatimpagues deri në 15.000 euro.

Nëse është shuma deri 15.000 euro mund të përfaqësohen vetë, kurse mbi 15.000 euro duhet të kenë avokat apo këshilltarë tatimorë. Në realitet unë mendoj se tatimpaguesve duhet t’i lihet liria e plotë se a do të angazhojnë avokat apo këshilltarë tatimorë që mos të ketë një kosto shtesë përpos asaj pagesës së tatimit.

Çështja e dytë ka të bëjë me marrëveshje tatimore. Personalisht mendoj që marrëveshjet tatimore posaçërisht sa i përket lartësisë së tatimit janë shumë të dëmshme. Është çështje tjetër marrëveshja për mundësinë e pagesës së tatimit në këste apo periudha, por për

lartësinë e tatimit, për shumën e tatimit marrëveshja para seancës besoj se e shtinë edhe Administratën tatimore me një rrugë që është shumë e përfolur, shumë e vështirë për me u kryer.

Kështu që, ne kemi pasur edhe raste edhe masa tjera. Për shembull e kemi pas për faljen e kamatave, e tjera për me i paguar tatimet që kanë pas në bord por që faktikisht përshtypjen e kam pas që s'kanë pas njëfarë efekti. Kështu që e njëjta gjë është edhe këtu, plus që mendoj se tatimi nuk është çështje që mundet me u diskutua lartësia, nëse ka drejtë ka drejtë, nëse nuk ka drejtë gjykata duhet ta vërtetojë.

E vetmja marrëveshje që mendoj se duhet të bëhet është mënyra e pagesës apo periudha e pagesës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutuesi i fundit, deputeti Sadri Ferati, e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Unë shkurt, e kam një çështje. Shpresoj se me këtë ligj, domethënë pas aprovimit, do të shërbehet, do të fitohet në efikasitetin e trajtimit të këtyre lëndëve.

Mirëpo, ajo çka më shqetëson është se, edhe nga vetë fjalëve të ministrit por edhe nga njohurit që i kemi, e kemi një akumulim të lëndëve atje - me kohë të tanë. Tani nuk parashikohet një përshpejtim i atyre lëndëve tash, dhe deri sa të aprovohet ligji e hynë në fuqi, deri sa të ngritën kapacitetet në gjykatë - ky është një lajmë i keq për të gjithë ata njerëz të cilët janë të interesuar që lëndët e tyre të shqyrtohen.

Do të ishte dashur të mendohet se cila do të jetë një fazë kalimtare e përshpejtimit të lëndëve ekzistuese, ndërsa pas hyrjes së ligjit në fuqi ajo të administrohet me kapacitetet e plota me gjykatën kompetente.

KRYETARI: Faleminderit!

Para se të japë fjalën ministrit, për fjalë është paraqitur edhe deputeti, Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që u thanë shumica e çështjeve dhe natyrshëm se mbes në qëndrimin e Grupit Parlamentar që ta mbështesim në parim këtë projektligj.

Megjithatë, pas fjalës së ministrit, mendoj që është dashur të ketë një kujdes pak më i madh i hartuesve të këtij projektligji, sepse gjithë materia i referohet termave që nuk ekzistojnë. Për shembull për gjykatë qendrore, në gjithë materien flitet për gjykatë qendrore. As sot, e as me ligjin e ardhshëm që fillon të implementohet prej janarit të vitit 2013 nuk ka gjykata qendrore, nuk ka gjykata të ankesave siç i referoheni ju këtë, por ka gjykatë të apelit që do të jetë. Domethënë në gjithë materien përdoren terma që fare nuk

ekzistojnë dhe unë çuditëmi këta hartuesit e këtij projektligji se ku janë thirr në këto norma.

Çështje evidente dhe rëndësishme është me këtë projektligj synohet të krijohen dy divizione, Divizioni Fiskal në kuadër të Administratës në Gjykatën Themelore të Prishtinës, sepse çështjet administrative dhe ekonomike janë kompetencë ekskluzive vetëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, jo të gjykatave themelore të tjera në teren. Dhe të njëjtën kohë formohet Divizioni Fiskal edhe në Gjykatën e Apelit, kjo do të ketë edhe kosto financiare sepse edhe në deklaratën financiare të vetë kësaj ministrie thuhet që ka kosto financiare dhe mund të ketë implikime financiare me vështirësi.

Edhe një çështje shumë të rëndësishme, është ajo që e tha edhe deputeti Ferati. Nuk mendoj që kjo do të përshpejton shqyrtimin e lëndëve të grumbulluara në këto borde, por përkundrazi do të ketë edhe më shumë ngarkesë sepse sipas kompetencës lëndore këto lëndë do të shqyrtohen nga gjyqtari i vetëm, jo nga kolegjet gjyqësore, pra aktualisht me Ligjin mbi gjykatat e rregullta.

Thjeshtë, mendoj që edhe neni 81.b i këtij projektligji ku flet për juridiksionin të këtyre divizioneve që pretendohet të themelohen, mendoj që janë shumë të pa harmonizuara me Ligjin për gjykatat. Kështu që kërkesa ime është që në vazhdim të punës së komisioneve ky projektligj të harmonizohet edhe me Ligjin për gjykatat. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Të lajmëruar për diskutim nuk ka. Ministër e ke fjalë!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Sa i përket lëndëve të cilat janë në procedurë të shqyrtimit në kuadër të bordit për shqyrtimin e ankesave, ju e dini, deputetë të nderuar se Bordi është funksional, është thuaj se i kompletuar me të gjithë anëtarët, është kryetari i Bordit dhe është përshpejtuar dinamika e punës së këtij bordi dhe realisht nuk është duke u rritur numri i lëndëve që presin për shqyrtim por është duke u zvogëluar dhe deri në momentin e funksionalizimit të kësaj gjykate Bordi do të vazhdojë ta kryej punën e vetë dhe nuk do të ketë grumbullim të lëndëve.

Kurse, unë jam shumë i sigurt që ekspertët e Komisionit Evropian dhe të gjithë juristët që janë duke punuar në këtë drejtim do ta harmonizojnë në përpikërie ligjin me kërkesat që janë me ligjet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në sallë janë 78 deputetë, se po vijnë kështu kohë pas kohe.

Të lajmëruar s'ka. Tash, janë 81 deputetë prezentë janë, 82.

Tash po hyjmë në procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Konstatohet se me 75 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për fondet pensionale të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Punës së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të avancimit të infrastrukturës ligjore ekzistuese për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve pensionale, duke siguruar mbrojtjen e pjesëmarrësve në fondet pensionale të Kosovës, Ministria e financave, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore e kemi draftuar këtë Projektligj për fondet pensionale.

Me nxjerrjen e këtij ligji do të avancohet rregullimi i funksionimit dhe mbikëqyrjes së formave të ndryshme të ofrimit të pensioneve qeveritare dhe private në Kosovë në pajtim me parimet e sigurta dhe shëndosha që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Gjer më tani sistemi pensional është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut numër 2001/35 mbi pensionet në Kosovë duke vazhduar me ndryshimin e kësaj rregullore më 29 prill 2005, Rregullorja e UNMIK-ut 2005/20 si dhe nxjerrjen e Ligjit numër 03/L-084 për fondin pensional të Kosovës më datën 13 qershor 2008.

Me këtë projektligj caktohen dhe rregullohen format e pensioneve, mënyra e kontribuimit, e licencimit, e mbikëqyrjes dhe pagesës së tyre.

Projektligji kërkon që fondet pensionale të organizohen sipas një strukture ligjore, transparente dhe se mjetet që u përkasin pjesëmarrësve të menaxhohen në përputhje me interesat e tyre.

Çështjet kryesore të adresuar në këtë projektligj janë: pensionet bazike; pensionet e kursimeve individuale të detyrueshme; fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit dhe pensionet plotësuese individuale.

Ky ligj po ashtu rregullon mënyrën e investimit të mjeteve pensionale duke përfshirë tani edhe mundësinë e investimit në letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe duke rregulluar edhe përqindjen e këtyre investimeve në mjetet e emetuesit ku është rritur mundësia që nga 5%, sa është aktualisht, të jetë deri në 30%.

Në përgjithësi projektligji përbën avancim të kornizës ligjore ekzistuese të pensioneve me qëllim të pasqyrimin të standardeve më të mira ndërkombëtare për fondet pensionale.

Aprovimi i këtij ligji do t'i mundësojë Kosovës që të bëjë një hapë përpara në përmbushjen e standardeve evropiane, duke krijuar një sistem të pensioneve në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Andaj, ju lus që ta aprovoni në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Fjala është për kryetaren e komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për buxhet dhe financa e ka shqyrtuar Projektligjin për fondet pensionale të Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të përkrahët në shqyrtim të parë.

Është mirë që më në fund po e shqyrtojmë Projektligjin për fondet pensionale sepse disa herë në Kuvend është ngritur kërkesa që të kemi një ligj më të mirë të Fondit pensional të Kosovës.

Me Projektligjin që sot po shqyrtohet përcaktohet mënyra e licencimit, përcaktohet edhe mënyra e mbikëqyrjes dhe investimi i fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësve dhe e fondeve plotësuese individuale.

Po ashtu është rregulluar baza e sistemit pensional, janë të përcaktuara standardet për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemit pensional.

Projektligji krijon një kornizë ligjore më të avancuar në drejtim të krijimit të standardeve të nevojshme për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemit pensional në drejtim të mbrojtjes së pjesëmarrësve të mjeteve pensionale.

Me këtë projektligj, po ashtu mundësohet investimi i mjeteve të Fondit të kursimeve pensionale të Kosovës përfshirë edhe letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Ligji i plotëson kërkesat formale për tu proceduar në seancën e leximit të parë sepse përveç strukturës së standardizuar përmban edhe dokumentin përcjellës si Deklaratën për

përputhshmërinë me standardet e Bashkimit Evropian, Deklaratën financiare për implikimet buxhetore dhe ndikimin e ligjit në përmirësimin e infrastrukturës legislative ekzistuese.

Sipas deklaratës së Ministrisë për Integritet Evropian, Ligji nuk i cenon parimet themelore të legjislacionit të Bashkësisë Evropiane.

Ligji nuk përmban kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, çka do të thotë se nuk ka nevojë për angazhim të stafit shtesë mbi fondet buxhetore në dispozicion për institucionet e ndikuara nga projektligji.

Pra, për zbatimin e ligjit nuk kërkohen kapacitete shtesë, sepse Ligji do të zbatohet me mekanizmat ekzistues.

Të gjitha implikimet e mundshme buxhetore të cilat mund të shfaqen gjatë zbatimit të ligjit janë të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, projektligji duhet të shqyrtohet me kujdes dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme qofshin ato përmbajtjesore apo edhe teknike, ashtu që ligji të rregullojë sa më mirë që të jetë e mundur këtë sferë të ndjeshme dhe shumë të diskutueshme për vite të tëra.

Në bazë të atyre që i thash më lartë, pra pasi që ligji i plotëson kushtet formale dhe përmbajtjesore, Komisioni për Buxhet dhe financa iu rekomandon deputetët që në këtë seancë plenare të miratojnë në parim këtë projektligj.

Vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj do të adresohet në fazën e amendamentimit në Komisionin për buxhet dhe financa. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Latif Gashi.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Projektligji për fondet pensionale të Kosovës ka për qëllim që të përcaktojë bazat e sistemit pensional në Kosovë që përfshin pensionet bazë dhe pensionet e kursimeve individuale.

Me këtë projektligj mundësohet investimi i mjeteve të Fondit të kursimeve pensionale të Kosovës nga 5%, sa ka qenë deri më tani, në 30% të këtij Fondi në Kosovë, që ka qenë kërkesë po thuaj se e të gjitha grupeve parlamentare.

Sipas Departamentit të buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për këtë projektligj vlerësohet se nuk prodhon kosto shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nuk i cenon parimet themelore të legjislacionit të BE-së.

Prandaj, duke u bazuar në atë që u tha edhe më lartë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështetë në parim këtë projektligj, i cili i plotëson të gjitha kushtet për lexim të parë, kurse ne do të japim kontributin tonë edhe në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike Armend Zemaj, e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj.

Ndryshimi kryesor ka të bëjë, jo vetëm në bazën e sistemit pensional, por ajo çka është e rëndësishme është bartja e mjeteve apo lejimi i mjeteve që me vendim të Bordit të Trustit, ku deri më tani ka qenë e lejuar nga 5% të shumës së akumuluar të kalojë në 30% të shfrytëzimit të këtyre mjeteve të cilat do të shfrytëzohen në Republikën e Kosovës.

Ajo që për ne i shprehim dilemat është se deri më tani nuk kemi pa politika të qarta të investimit të këtyre mjeteve, sepse edhe në Raporti vjetor i Trustit Pensional të Republikës së Kosovës është theksuar që pak nga këto mjete janë shfrytëzuar edhe në bankat komerciale që veprojnë në Republikën e Kosovës, por ne shpresojmë që tani me politikën e re përmes letrave me vlerë do të kemi një qasje më zhvillimore në zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Parimisht, i japim përkrahje dhe të gjitha këto dilema mendojmë që t'i zgjidhim përmes anëtarëve tanë në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Vetëvendosjes, deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ligji për fondet pensionale qartazi nuk ka ndonjë ndryshim në substancë prej atij që e kemi tash në fuqi, përveç pjesës që ka të bëjë kryekëput me investimet e mjeteve pensionale në obligacione qeveritare të Republikës së Kosovës. Pra, ideja është që të ndryshohet baza regullative, që Qeveria ta ketë mundësinë të ketë qasje në këto mjete.

Me interes të veçantë me këtë ligj është natyrisht neni 9.7, 9.8, 9.9 dhe ai 9.10. Këto nene na tregojnë qartazi që në asnjë moment nuk mund të ketë më shumë se 30% të totalit të mjeteve të trustit të investuara në obligacione qeveritare, mirëpo mund të investohen deri 50% të fondeve të mbledhura gjatë një viti kalendarik në to.

Për më shumë, edhe një pikë e cila është goxha interesante, është fakti se në nenin 9.7, pika b), c) dhe d) hapin rrugën për investime edhe në instrumente tjera financiare në Kosovë, pra përveç depozitave edhe të obligacioneve qeveritare. Kjo natyrisht në vete nuk është problematike, por duke e pasur parasysh faktin që nga tregu kapital vazhdon të mungojë në Kosovë atëherë e bënë këtë pikë problematike, ose e bënë si një lloj dëshire e cila vështirë se do të realizohet në një afat të shkurtër kohor.

Vetë fakti që ky ligj po ndryshohet, jo për interesat e krijimit të një sistemi të qëndrueshëm pensional, por me idenë që të ketë qasje, Qeveria në fakt, në këtë rast të ketë qasje në paratë e këtij sistemi, tregon për një mos përgjegjshmëri të skajshme të kësaj qeverie ndaj pensionistëve të ardhshëm - atyre të cilët janë duke paguar kontribute aktualisht në Trustin e Kursimeve Pensionale.

Për më tepër, pjesa e investimeve e cila parasheh investime vetëm në shtetet e OECD-ës tregon që Qeveria me këtë ligj nuk është marrë fare seriozisht me politikat investive sepse pikërisht janë shtetet e OECD-së ato që aktualisht po kalojnë nëpër një krizë të madhe ekonomike, ndërsa shtetet ku zhvillimi është më i hovshëm e rrjedhimisht edhe mundësia për të pasur kthim më të madh është jashtë OECD-së.

Pra, edhe atë pjesë të ligjit e cila modifikohet me këtë ligj që e kemi përpara është bërë vetëm për nevojat të Qeverisë aktuale të kryeministrit Thaçi, nevojat buxhetore të Qeverisë e jo për nevojat e personave ose punëtorëve të Kosovës të cilët kontribuojnë në këtë skemë pensionale, pra për kthim më të mirë në investime, nevojë kjo edhe interes i tyre.

Edhe një herë duhet të përmend këtu që politika investuese e Trustit të Kursimeve Pensionale, e aplikuar për një kohë të gjatë, e cila faktikisht nuk ndryshohet me këtë ligj, po e përsëris prapë, ka rezultuar deri tash për 10 vite prej se ekziston Trusti në agregate 2% kthim pozitiv, ndërkohë që ne e dimë që diku inflacionin vjetër e kemi pasur 5, 6, 7 varësisht prej viti. Pra, nuk e ka mbuluar as atë inflacion vjetor.

Lëvizja Vetëvendosje do të abstenojë në këtë ligj për dy arsye kryesore: Njërin anë për shkak se ky ligj nuk e bënë ndryshimin rrënjësor të sistemit pensional që është i nevojshëm për Kosovën dhe nuk e integron këtë sistem pensional por e mbanë ashtu të ndarë dhe gjend, si të them, zgjidhje ad-hoc të atypëratyshme për pjesë të caktuar të sistemit, duke e rrezikuar kështu për ta shkatërruar atë tërësisht. Dhe në anën tjetër, ne natyrisht që jemi që t'i sjellim parat e kursimeve pensionale por edhe fondit të privatizimit e kështu me radhë në Kosovë, mirëpo ato duhet të dimë se ku po i investojmë.

Aktualisht Qeveria përmes letrave me vlerë, të cilat po i lëshon, që iu shiti bankave një pjesë e tash të tjerat po do me ia shitë edhe Trustit të Kursimeve Pensionale nuk po investon, nuk po i shet, në fakt, për me marrë para për me investuar në ekonomi por vetëm për t'i mbuluar dështimet në planifikimin buxhetor edhe fiskal të cilat po na paraqiten e për të cilat ministri asnjëherë, e as kryeministri, s'e kanë pranuar se do të paraqiten.

Pra në njërin anë thonë që nuk do të kemi vështirësi financiare, ndërkohë që në anën tjetër të gjitha masat i marrin për t'i evituar ato vështirësi financiare.

Rrjedhimisht Lëvizja Vetëvendosje do ta abstenojë këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIAJ: Faleminderit, kryetar!

Projektligjin për fondet pensionale të Kosovës është një projektligj mjaft i rëndësishëm me të cilën synohet avancimi i infrastrukturës ligjore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve pensionale.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta përkrahë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputeti Gëzim Kelmendi, e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Kolege dhe kolegë deputetë të nderuar,

Ligji të cilin kemi para veti, pa dyshim se është një ligj i cili shqyrton gjithashtu problematikën e një shtrese i cili është lënë pas dore në kohë të luftës. Ne jemi të gjithë dëshmitarë për atë situatë të cilën ka kalua dhe po kalon një pjesë e popullatës do të thotë pjesa më e shquar dhe e nderuar e popullit, do të thotë, pensionistët.

Pa dyshim që me një menaxhim të mirëfilltë dhe do të arrihet ajo që është një mirëqenie më e mirë e pensionistëve të Kosovës, ngase Kosova sikur të gjithë e dimë si pjesë e rajonit është vendi me përqindjen më të re të popullatës, andaj, edhe pensionistët nuk janë shumë nëse merren në përqindje sa i përket Kosovës.

Përgjegjësia nuk bie, në këtë rast mbi Qeverinë aktuale të Kosovës, mbasi me një problematikë të tillë janë marrë edhe të gjitha qeveritë e kaluara në mandatet e kaluara. Prandaj, nuk është e udhës që ne këtu të adresojmë kritika por të gjejmë një rrugë zgjidhje se si të tejkalohet kjo situatë, në mënyrë që të ketë një menaxhim më të mirë të Fondit të Trustit Pensional dhe që të rritet mirëqenia e pensionistëve të Kosovës të cilët vite me radhë janë duke e marrë, të themi më mirë, një asistencë sociale se sa një pension të mirëfilltë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së? Nuk ka të lajmëruar.

Në emër të “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për fondet pensionale dhe në parim e përkrah, kurse kontributin tonë do të japim përmes komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk është mirë me ta dhënë fjalën Naser! Je vonua! Por, urdhëro! Deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Me respekt kryetar, por kam obligim me qenë se jam me mandate goxha herët këtu, edhe një kërkesë të vazhdueshme të gjitha grupeve parlamentare, gjithë deputetëve, një kërkesë intensive ka qenë që mjetet e Trustit Pensional të plasohen mundësisht në Kosovë.

Mirëpo, duke marrë parasysh rrethanat që kanë qenë dhe rregulloret e UNMIK-ut lidhur me këtë Fond, që kanë qenë të pamundura, për arsye të mossigurimit të investimeve në Kosovë. Kjo është një dobi reciproke, një dobi e ekonomisë së Kosovës që ka me i qarkullua këto mjete, ka mi re-gjenerua, dhe një mundësi e mirë që pensionistëve, domethënë, të iu rriten kontributet e tyre. Domethënë është një dobi e dyfishtë për pensionistë dhe për Kosovën.

Ne kemi pasur dëshirë që të gjitha mjetet e Trustit të plasohen në tregun e Kosovës, mirëpo duke marrë parasysh potencialin ekonomik të absorbimit të nevojave të këtyre mjeteve financiare që nuk është një ekonomi e zhvilluar dhe nuk ka mundësi me i futur në funksionim të gjitha këto mjete, ne e përshëndesim këtë hapë të guximshëm edhe të Ministrisë, edhe të Fondit Pensional që edhe 30% nuk janë pak pare se Fondi i Trustit Pensional disponon gati sa gjysma e buxhetit të mjeteve financiare, dhe këto pare janë të mirëseardhura për ekonominë e Kosovës.

Pra, e pata këtë për obligim për arsye se kemi pasur kërkesë të vazhdueshme zoti kryetar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Para se t'ia japë fjalën ministrit, dua t'i them edhe unë 2 – 3 fjalë, dhe më lejoni t'i them prej këtu.

Dhe unë mendoj që është mirë që është shtuar mundësia që mjetet e Trustit të investohen në Kosovë, bile ndoshta do të ishte mirë të shqyrtohet mundësia e 50%, jo e 30%.

Por edhe një kërkesë e kam nga ministri për Ekonomi dhe Financa, dhe nga ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale dhe sigurisht këtu do të hynë edhe ndonjë ministri tjetër.

Realisht ne duhet të flasim haptas se pak më herët e kthyem një ligj prapa. Pra, është mirë që të mendojmë ta gjejmë një mundësi që pensionistët, kjo gjeneratë e pensionistëve që nuk është në gjendje të mirë, është në gjendje të vështirë sociale - të kërkohet edhe ndonjë rrugë tjetër për ngritjen e pensioneve të tyre, dhe ndoshta është një mundësi që gjenerata të kontribuojë për gjeneratën së paku për një periudhë dhjetëvjeçare që kjo gjeneratë që i jep 5% për pensionin dhe kemi një shumë të caktuar të mjeteve në buxhet, pra të krijohet mundësia që pensionistëve t'u jepet një pension më i dinjitetshëm se sa që është dhe se sa janë këto mundësi që i ka Qeveria. Prandaj, edhe unë mendoj që po të shikohet e analizohet, mirë ka mundësi që pensionet e pensionistëve të merren nga Fondi i Trustit Pensional e që pastaj gjenerata vërtetë t'i kontribuojë për gjeneratën dhe kjo së

paku të bëhet për një periudhë së paku 10 vjeçare. Unë mendoj që mund të gjendet mundësi për të ndihmuar gjenerata gjeneratën.

Dhe në fund të fundit, është ndoshta pak çështje humanitare, por ne jemi këtu edhe për të gjetur rrugë dhe mundësi që një shtrese të caktuar që nuk është në gjendje të mirë materiale, t'ia lehtësojmë ose t'ia mundësojmë këtë.

Kjo ishte një kërkesë e imja, e ndoshta është pakë humanitare, por realisht ne jemi këtu për të qenë edhe humanitarë. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni që t'i falënderoj të gjithë deputetët për përkrahjen dhe kontributin e tyre për këtë projektligj.

Është një ligj i cili është pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe jemi të vetëdijshëm se ka mundësi që të përmirësohet në të ardhmen, dhe duhet të përmirësohet në të ardhmen edhe më tepër. Mirëpo për këtë fazë, kemi mundur të shkojmë deri në këtë shkallë.

Nganjëherë mund të kontribuohet edhe brenda sistemit dhe kur i dëgjoj sot njerëzit këtu duke diskutuar, besoj që në të ardhmen do të ketë mundësi që duke punuar brenda atij institucioni kanë mund me dalë me ide të mira se qysh me e përmirësua gjendjen në këtë drejtim por s'kam pasur që ka pasur ndonjë ide prej tyre, por mirë që kanë punuar aty. Nuk jam kundër që kanë realizuara paga të mira, por kanë realizuar paga të mira.

Sidoqoftë unë konsideroj që është shumë pozitive që në Kosovë po krijohet mundësia që këto mjete të investohen deri në lartësi prej 30%. Është mundësi e mirë për investitorët dhe është mundësi e mirë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Është gjithçka transparente. Në pjesë e tabelave të buxhetit të Kosovës është e paraparë që Qeveria e Kosovës në këtë vit të ketë në buxhetin e Kosovës nga letrat me vlerë shumë prej 74 milionë eurove. Se kur do të investohen ato, për këto projekte ka vendos Kuvend dhe janë pjesë e tabelave të buxhetit.

Konsideroj që është gjithçka transparente. Është një lëvizje pozitive, është një përmirësim substancial i bazës legale ekzistuese që e rregullon këtë lëmi, dhe jam shumë i vetëdijshëm dhe shumë i sigurt që ne kemi dëshiruar dhe kemi kërkuar më shumë por në këtë moment duke pas për bazë që është pjesë e Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtarë ne kemi mund deri në këtë shkallë të lëvizim dhe besoj që është diçka pozitive.

Edhe një herë, gjithë deputetët i falënderoj për kontributin e tyre. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Jo, jo, nuk ka replika! Mos ta krijojmë një praktikë të tillë!

(Ndërhyrje)

Nuk është mirë ta bëjmë praktikë, realisht. Më kuptoni. Unë mendova, para se të shkojmë në procedurën e votimit t'ua tregoj një praktikë parlamentare të komunikimit në parlament.

Në Parlamentin e Francës deputetët nuk mund të bisedojnë, kështu siç bisedohet tek ne. Ata bisedojnë përmes letrave, dhe janë punëtorët e Parlamentet ata që e përcjellin letrën prej një deputeti në deputet tjetër dhe nuk komunikohet kështu siç komunikohet tek ne dhe sikur krijohet zhurmë.

Ju lus edhe juve edhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Prezentë janë 78 deputetë. Tash, me Lutën 79!

Faleminderit! Konstatoj se me 64 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjit për Fondin Pensional të Kosovës.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqes raportin me rekomandime.

Pikën e dymbëdhjetë e kemi heqë nga rendi i ditës.

Në radhë është pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.

Para se të hymë në pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës, unë në emër të Kuvendit dhe në emër të Administratës së Kuvendit për Grupin Parlamentar të Grave deputete - kërkojmë falje dhe ju njoftojmë se fletorja në fjalë hiqet nga përdorimi. Pra, dhe një herë po them se ka qenë një gabim, hiqet nga rendi i ditës.

Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Në bazë të të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq që para deputetëve ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovani, dame i gospodo narodni poslanici,

Jedan od, verovatno bitnih zakona, ne samo za Ministarstvo za rad nego i za samo kosovsko društvo je i šema socijalne pomoći, a samim tim i ovaj današnji Nacrt za

promenu je u funkciji boljeg zastupljanja socijalne pomoći i takođe i njihovu upotrebu koja bi moglo da služi za smanjenje i samog broja siromašnih kao i onih koji žive ekstremno u siromaštvu.

Cilj je smanjenja siromaštva, s toga da se stopama od 34% siromaštva koje danas procenjeno da je po samom Izveštaju Svetske banke i od toga 12% ekstremnog, i koje je u samom planiranju, gde je bilo negde oko 35.000 porodica, koji su do sad primali i nastaviće i dalje da primaju iznose od 40 do 80 evra prema aktuelnom zakonu, šema socijalne pomoći je predstavljena još u 2000 godini, i ponovno razmatrana u 2003 koja obuhvata dve vrste, dve osnovne vrste korisnika, a to je prva kategorija koja ima za cilj da pruži finansijsku pomoć porodicama koje nemaju nijednog člana porodice sposobnog za rad ili ne očekuju da se osposobljavaju za rad, i druga kategorija koja ima za cilj da pruži prvenstveno pomoć porodicama sa članovima sposobnih za rad ali trenutno koji ne mogu da nađu posao.

Uzimajući u obzir okolnosti i uslove života koje su se promenile od 2003. godine, Ministarstvo za rad je učinila kontinuirane napore i insistirala da je neophodno da se obavljaju promene u Zakonu šema socijalne pomoći 2003/15.

U vezi sa ovim, tokom 2011. sa podrškom Projekta Evropske komisije, to je takozvani Projekat IPA, koji je bio predviđen da nas se pruži jedna tehnička pomoć od strane nekoliko pripremljenih i eksperata i jednog koji će biti u stalnim bazama prisutan u Ministarstvu za rad, takođe, uz naravno podrške Svetske banke koje je pratila tu samu tehničku verifikaciju Zakona i Međunarodnog fonda koji je bio elemenat sa strane fiskalne ekonomije morao da potvrdi taj jedan dogovor. Mi smo imali ovu našu potvrdu i takođe UNICEF dao jedan svoj skroman doprinos u smislu podrške projekta odnosno tok tehničkog evauliranja Projekta i samim tim i njihove procene.

Uprkos željama i preporukama, što bi ste vi verovatno voleli da čujete, za promenu još nekoliko kriterijuma, za koje se procenjuju u Ministarstvu za rad da su trebali biti promenjeni, nismo bili u mogućnosti jer jednostavno finansijska mogućnost i budžetska mogućnost Kosova nije toliko da može u ovom momentu da obezbedi takvu jednu podršku.

Najbitnije stvari, koje bih tu napomenuo, a koje se ističu kao vrlo pozitivne i produktivne su promena prava socijalnih usluga za porodice koje su do sada bile predviđene od 1 do 7 članova porodice, a sada je taj broj proširen čak do 15 članova porodice, da mogu da koriste pravo jer do sada je bilo da, recimo od 1 do 7 članova porodice bila ta najveća kvotacija do 80 evra za korišćenja, ali sad i samim tim i oni koji ima više od 7, znači 8, 9 ili koliko već, do 15 onda imaju prava da za svakog članu porodice dobijaju 5 evra dodatka.

Sa druge strane, sa izmenama i dopunama ovog zakona broj korisnika socijalne pomoći na Kosovu će biti smanjen, za negde od prilike 6.900 porodica, zbog primene novih mera uslovljavanja i promena kriterijuma, pogotovo prve i druge kategorije.

Biću konkretan u tome i da vam kažem u kojim kategorijama će doći do promena. Pre svega, svi smo svesni da ima određeni broj porodica koje nisu odnosno ne ispunjavaju sve ulove za socijalnu pomoć. Zakon je bio takav i mi iz Ministarstva smo se trudili da budemo fleksibilni, u ne nametanju nekih određenih kriterijuma koji može, na jedan tako način radikalno da nazovem moći da odvoji veću grupu porodica, ali smo kroz taj naš filter kada smo sve analizirali, kada se budu umanjili oni kriterijumi, kao na primer što se sama procena navodi ovde, da će recimo kriterijumi vozilo koji je sasvim realno i nigde nije odobreno i dozvoljeno da jedan vlasnik vozila, takođe može da bude korisnik i socijalne pomoći.

Taj kriterijum vozila bi umanjio negde za 1.600 porodica aktuelnih koje su sada na šemi socijalne pomoći. Zatim kriterijume ojačavanja verifikacije nesposobnosti, odnosno kao što je i rečeno, bilo je primera zloupotrebe i verovatno ste i vi sami bili svedoci da u određenim momentima vidite i vi korisnike te socijalne pomoći koji nisu bili baš da kažem na tom nivou ugroženi da bi trebali da ih koriste, ali ipak mogu reći, bili smo fleksibilni i na centralnim i na lokalnom nivou.

Treći, i jedan od bitnih faktora i najznačajnije je ojačana u uslovljavanju na tržištu rada. Imali smo prilike da svi ti koji su bili na tržištu rada prisutni pa su mnogo od njih zahtevali da njihov, da kažem tretman, bude da oni nisu u stanju da nađu ni mesto za rad, a pored toga nisu ni sposobni da nađu mesto za rad što taj sam kriterijum će da umanji jedan određeni broj koji će biti 3.300 porodica. Prema tome, ono smanjenje, što sam rekao 6.900, čini ovaj broj ukupan od 6.900 porodica.

Jedan od bitnih elemenata koji treba samo da naznačim je dečiji dodatak koji će sa ovim primenom zakona, primenom izmenu zakona biti dostupan, jer je prihvaćen kao dobra praksa sa uticajem na smanjenje siromaštva za decu i pristupa u obrazovanju i zdravstvu.

Predložen je da će dete dobiti jedan dodatak od 5 evra koji će biti povezan sa podsticajem za pohađanje u školu i za lekarskim zdravstvenim pogledima i majke i deteta. Jedan takav dodatak, na osnovu broja dece će imati budžetsko uticaj za 3,7 miliona evra. Ovo naznačavam samo kao jedan od faktora koji će biti, da kažem, malo beneficiraniji u ovom pogledu, koji će pružiti dodatne mogućnosti i dodatne beneficije za sve te siromašne porodice.

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Jedna od najbitnih stvari i jedna od parametara koji je pokazan da je onaj koji stalno odražava neku sliku siromaštva našeg društva, su i izveštaji koji prema samoj Svetskoj banci kaže da im imamo negde procenat siromašnih porodica koji živi u takozvanoj ekstremnom siromaštvu, negde između 12 i 14%, zavisno od toga ko daje izveštaj.

Ja sam sa ovim zakonom stvarno siguran i ja bih voleo da ga stvarno dobro proučite i analizirate. Ja sam siguran da će ovim zakonom, taj procenat od 12%, uzeću ga kao 12% ekstremno siromaštvo, biti smanjen a čak što više ja mislim da će biti prepolovljen, jer mi ćemo ovim omogućiti da iz celine siromaštva jednostavno pomerimo, odnosno jedan

određeni broj porodica gurnemo, kada kažem nagore, mislim svi su da prođu taj limit koji se određuje koje su porodice ekstremno siromašne a koji nisu.

Ja ovim stvarno verujem da će taj broj, taj procenat ekstremnog siromaštva da se promeni čak što više, više njih, više predstavnika raznih je rekao iz zemalja Evropske Unije, i takođe i sa stranih ekspertskih komisija, da ovaj zakon ne samo da je dobar u smislu da je dobro izbalansiran istim budžetom, nego da može biti korišćen kao primer za u buduće.

Ja, ono što mogu da prenesem je da sigurno nisam dobio nijedan negativni komentar što se tiče stručne strane gledišta na ovaj zakon. I tako vam ga i predlažem, bez obzira što će sigurno naići na različite predloge, negde će možda biti u smislu i kritikovanja našeg rada, ali bez obzira na to, ja znam da niko od nijednog eksperta sa nijedne strane nije rekao da je ovaj Zakon loš.

Ovaj zakon ima isti kosto kao što je imao dosadašnji, znači znači 28 miliona evra, a uz korekciju, odnosno uz jednu informaciju da je predviđeno indeks akcija koja će biti u visinu od 28%, odnosno u nivou inflacije koja je procenjena da je bila u periodu od 2007. do danas 2012. godine. Znači taj indeks akcija nije ubačena sad, nije predložena sad, ali u momentu kada bude moguća odnosno....

KRYETARI: Regjia, vazhdojeni edhe nje minut!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: ...da budu bili stvoreni uslovi, odnosno to je predviđeno da u sledećoj godine bude urađeno, ja vam garantujem da će taj procenat ekstremnog siromaštva biti još više smanjen od onoga što sam ja već rekao.

Ja se vam unapred zahvaljujem! Stvarno je Zakon jeste tehnički ispravan i naravno mi očekujemo sve one pozitivne i dobre predloge koje mogu i dalje uticati na poboljšanje ovog Zakona. Hvala vam puno na pažnji!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është për kryetarin e komisionit funksional për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, deputeti Fikrim Damka.

A është këtu deputeti? Urdhëro deputet, e ke fjalën!

FIKRIM DAMKA: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, në mbledhjen e mbajtur me 25 janar 2012, shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmë sociale në Kosovë, dhe njëzëri e përkrah miratimin në parim të këtij Projektligji.

Komisioni do të punojë në amendamentimin e këtij Projektligji, në mënyrë që ky ligj të jetë një ligj sa më i zbatueshëm. Komisioni i mirëpret vërejtjet dhe amendamentet e deputetëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Flora Brovina, e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrahë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat sociale në Republikën e Kosovës.

Ky ndryshim- plotësim bëhet me qëllim të mbrojtjes sociale dhe përkrahjes së familjeve të rrezikuara në aspektin social, pra të familjeve vërtetë skajshmërisht të varfra, duke e kontrolluar dhe përcaktuar dhe kriteret për përfshirjen e familjeve në mbrojtjen sociale.

Konsiderojmë se ky Projekt-ndryshim i Ligjit nuk do të ketë implementime shtesë buxhetore, sepse kursimet që parashihen të bëhen dhe kriteret që do të jenë më të ashpra për përfituesit, do të jenë të mjaftueshme si mjete që do të jenë edhe të përfshira në skemën sociale.

Janë bërë analiza dhe është parë në terren se dispozitat e mëparshme ligjore, kanë mundësuar favore edhe për familjet që realisht nuk kanë qenë të rrezikuara skajshmërisht, të varfra pra, ndërsa, përkundrazi janë pakësuar familjet e rrezikuara së tepërmi nga familjet e rrezikuara së tepërmi nga varfëria. Është konstatuar se dispozitat e ligjit të skemës së ndihmës sociale, kanë pasur paqartësi, konfuzit dhe kundërshti ndërmjet veti. Disa dispozita kanë qenë tepër të buta prandaj dhe i kanë mundësuar familjet jo të varfra të përfitojnë, ndërsa i kanë përjashtuar familjet vërtetë të varfra dhe ato shpeshherë as nuk kanë mundur të regjistrohen si të tilla dhe përfituese.

Ky ndryshim duhet ta jap edhe efikasitetin e vet në punën e qendrave sociale, dhe të eliminoj disa kriterë financiarë për ndihmën sociale, që nuk kanë qenë të qarta dhe në përputhshmëri me gjendjen reale materiale të familjeve.

Pritet që t'u dilet në ndihmë familjeve të varfra sidomos me anëtarë të moshuar në familje, me persona me aftësi të kufizuara dhe, siç tha edhe vet ministri, ata me më shumë fëmijë prej moshës 1 deri në 18 vjeç dhe gjithashtu personat që kanë pësuar nga lufta në Kosovë, çfarëdo kategorie e qofshin ata.

Nga risitë, do të jetë decentralizimi, kontrollimi dhe menaxhimi ma i mirë i kësaj problematike në nivelin komunal.

E drejta në ndihmë sociale do t'u takojë të gjithë shtetasve të Kosovës, me përjashtim edhe të atyre që kërkojnë dhe e gëzojnë statusin e azil kërkuesve refugjatëve dhe të

tjerëve dhe që bëjnë të gjitha shtetet e pavarura dhe kjo çështje do të rregullohet me një akt të veçantë nën-ligjor. Kështu dëshmojmë se jemi një shtet që po ndërtohet realisht.

Për përfituesit e skemës sociale, u tha se përfitues do të jenë edhe personat, familjet që kanë persona të papunësuar e që janë në listë, dhe patjetër kërkohet që ata të jenë në listën e punëkërkuesve pran zyrave të punësimit, një dëshmi që edhe mund të kontrollohet edhe papunësia edhe varfëria në familje.

Përcaktimi i të mirave materiale, të llogaritura dhe të parregulluara gjithashtu iu nënshtrimit kritereve më të veçanta.

Dhe këtu krejt në fund, do të veçoja nenin 9/a, një nen i ri i cili për herë të parë e vë në vëmendje fëmijun. Këtu parashihi që familjet me fëmijë prej 1 deri në 18 vjeç të gëzojnë shtesat e fëmijëve me qëllim të përmirësimit të mundësive për arsimim dhe shëndet më të mirë të tyre. E përgëzoj Ministrin pikërisht me këtë nen sepse jam shumë e interesuar që fëmijëve të varfër të Kosovës, t'u jepet një mundësi tjetër.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, sikur që thash, e përkrahë dhe fton që ta votojmë këtë ligj dhe gjithashtu do të jep kontributin në komisionin gjegjës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, e ka shqyrtuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/15 për skemën e ndihmës sociale dhe ka konstatuar se është i domosdoshëm ndryshimi dhe amendamenti i tij, që të bëhet një ligj i mirë i cili do të ndërtojë kritere të mirëfillta për skemën e ndihmës sociale dhe do të mundësonte përzgjedhjen e familjeve që vërtetë janë të varfra dhe eliminimin nga skema për ndihma sociale të atyre familjeve që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmë sociale.

Kjo do të mundësonte ngritjen e shumës së financave të ndihmës sociale për familjet që e gëzojnë këtë të drejtë. Por për këtë, duhen ndërgjegjësimet në të gjitha nivelet, duke filluar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, nga Departamenti për Çështje Sociale në këtë Ministri, nga Qendra për Punë Sociale, Komisioni shëndetësor, të cilin e emëron kjo ministri deri te vetë ata që aplikojnë për ndihmë sociale.

Ne Grupi Parlamentar i LDK-së, e përkrahim në parim këtë projektligj dhe kontributin tonë për amendamentimin e tij, e japim përmes Komisionit përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Vetëvendosje, deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputet,
I nderuari kryetar,
Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, do ta votojë në parim.

I kemi edhe disa vërejtje, të cilat do t'i përcjellim në punën e Komisionit përkatës dhe të cilat do t'i trajtojmë edhe tani.

Tek përkufizimi i familjes, në nenin 2 të Ligjit aktual në fuqi, pra 2003/15, duhet të bëhet harmonizimi i përkufizimit të familjes në përputhje me Ligjin për familjen, e që në këtë Projektligj nuk është paraparë. Pra, të inkorporohet përmbajtja e Ligjit për familjen siç është, pra ku definohet familja, që trajtohet se familja është bashkësi vitale e prindërve dhe i fëmijëve të tyre, si dhe e personave të tjerë në gjini.

Ky definicion do të duhej të ishte pjesë e definicionit për familjen në kuadër të Ligjit aktual të cilin mëtojmë ta plotësojmë dhe ndryshojmë.

Tek neni 1 i Projektligjit, kur bëhet fjalë për plotësim-ndryshimin e nenit 2 të Ligjit aktual, te paragrafi 2.2, ku listohen personat që nuk do të merren parasysh kur do të llogaritet madhësia e familjes, në pikën 2 i trajton personat me aftësi të kufizuara dhe ata i përjashton, pra i trajton si kategori përjashtuese, dhe si e tillë pra kjo duhet të hiqet pasi që ata duhet të trajtoheshin si pjesë që duhet të marrin ndihmën sociale, sepse kjo është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit kundër diskriminimit.

Personat e tillë e gëzojnë ndihmesën në bazë të rrethanave subjektive, dhe assesit për shkak të këtyre rrethanave nuk bënë të jenë të diskriminuar dhe i përjashtuar nga llogaritja e anëtarëve të familjes për caktimin e lartësisë së ndihmës sociale.

Gjithashtu, arsyeja e pensionit për këta persona ka qenë: jo shkak është, janë aftësitë e kufizuara; dhe pensionin pra ata e marrin për shkak të aftësive të kufizuara, por kjo nuk do të thotë që ata tash ose familjet e tyre do të hiqen, apo do të duhej të hiqeshin nga ndihmat sociale, meqenëse munden të jenë akoma kategori sociale. Pra, kjo pra është ndihmesë në të cilën synohet që familjes dhe personit të tij t'i lehtësohen nevojat e veçanta mbi bazën e të cilave kategorizohet ai si person me aftësi të kufizuara.

Po ashtu edhe personat tjerë, nga pika 4, e që janë persona që konsiderohen si përfitues të pensioneve, si rezultat i kontributit, sakrificës apo pasojave të luftës të UÇK-së, edhe kjo kategori nuk do të duhej të përjashtohet nga pjesa e familjes që do të merrte ndihmë sociale me qenë se edhe në këtë rast janë rrethanat e veçanta subjektive ato të cilat ua kanë dhënë këtë ndihmë sociale dhe ata që e marrin pensionin ata prapë si kategori e tillë në kuadër të familjes mund të kategorizohen si pjesë e familjeve për ndihmë sociale dhe do të duhej t'u takonte ndihma sociale. Pra, janë rrethanat subjektive për të cilat ata marrin pensione tjera.

Po ashtu në këto kategori do të duhej të përfshiheshin edhe personat nga mosha 18 deri në moshën 26 vjeçare, të cilët janë ende në shkollim dhe në përkujdesje të prindërve pasi që, sipas Ligjit për familjen, tek neni 28 paragrafi 2, ata prindër të këtyre fëmijëve - pra të personave prej 18 deri 26, obligohen që të sigurojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre në këtë moshë. Dhe meqenëse Ligji obligon ata që të kenë përgjegjësi financiare mbi ta, ata nuk mund të përjashtohen edhe nga skema e ndihmës sociale. Pra ata duhen të jenë edhe personat e moshës 18 deri në moshën 26, të cilët janë nën përkujdesjen e prindërve, para ata duhet të trajtohen këtu.

Tek neni 5 i Projektligjit, që mëton të plotësojë dhe të ndryshojë nenin 7 të ligjit aktual, te paragrafi 7.2 do të duhej që periudha e marrjes së ndihmës sociale të shtyhet në afat sa më të gjatë, pra nga 6 muaj siç është tani, të shtyhet edhe më shumë, për shkakun se është procedurë burokratike e tepruar nëse familja përfituese detyrohet që në çdo 6 muaj t'i nënshtrohet procedurës për përfitim të ndihmës sociale dhe me këtë ata po detyrohen çdo 6 muaj të vijnë dhe ta vazhdojnë. Pra, duhet që ky afat të jetë më i gjatë.

Ky ligj gjithëherë ka karakter solidar dhe nuk duhet të ketë për qëllim supozues e paragjykses, por gjithëherë duhet të ofrojë lehtësira për familjet që kanë nevojë dhe përkujdesje shoqërore.

Tek neni 6 i Projektligjit që e trajton nenin 9 të Ligjit aktual, e që ka të bëjë me llogaritjen e pagesave mujore të ndihmave sociale, tek paragrafi 9.1 gjatë llogaritjeve të pagesave krahas trajtimit të shpenzimeve dhe shportës së konsumatorit, duhet të kemi gjithmonë parasysh edhe lartësinë e pages minimale që caktohet me vendim të Qeverisë sipas rekomandimit të Këshillit ekonomiko-social.

Tek neni 8 i Projektligjit që e trajton nenin 11 të ligjit aktual dhe që ka të bëjë me shqyrtimin e ankesave, kërkuesit për ndihmë sociale, në rast se janë të pakënaqur me aktvendimin zyrtar, iu lëshon afat vetëm afat vetëm prej 5 ditëve që të parashetrojnë kërkesë për rishqyrtim të atij vendimi. Ky është afat jashtëzakonisht i shkurtër, 5 ditë. Këtë duhet ta kemi parasysh se kemi të bëjmë me persona që kërkojnë ndihmë sociale dhe normalisht ata nuk do të kenë mundësi që të bëjnë ankesë aq shpejtë, sepse zakonisht po flasim, janë të detyruar të kërkojnë ose avokatët, ose një person zyrtar që do t'iu ndihmonte ta bënte atë ankesë dhe rrjedhimisht afati 5 ditor është aq i shkurtër sa që ata nuk do të kenë kohë për me e bë atë ankesë. Prandaj ky afat do duhej të shtyhet. Normalisht për shumë të tjerë të gjykata është afati më i gjatë, e në këtë rast, duke i marrë parasysh që kemi raste sociale, do të duhej të ishte bile 15 ditë.

Tek neni 9 i Projektligjit e që e trajton, pra synon ta ndryshojë dhe plotësojë nenin 12 të Ligjit aktual e që ka të bëjë me ndihmat e veçanta, e ndihmat e tilla janë ndihma të menjëhershme si nevojë momentale, nuk mbështeten nga ky nen nëse ato përsëriten më shumë se 1 herë brenda 12 muajsh. Konsiderojmë se ky afat duhet të reduktohet ose në 6 muaj, ose të shtohet 2 herë brenda 12 muajsh, pasi që natyra e ndihmës së veçantë mund të jetë e llojit të tillë që të paraqitet më shpesh se sa një herë në muaj, por së paku dy herë.

Mirëpo, kuptohet kur është rasti që është më tepër, është diçka tjetër. Mirëpo, kemi raste kur bile brenda 12 muajsh mund të ketë raste që të jetë dy herë, është afat tepër i gjatë 12 muaj, pra ose të kufizohet në 6 muaj, një herë në 6 muaj ose të thuhet: jo më tepër se dy herë brenda 12 muajsh.

Ndërsa te paragrafi 12.4 i po këtij ligji, parashihet që kjo shumë e ndarë për një vit për ndihma të veçanta të jetë 100.000. Pra është dhënë vlera fikse 100.000 euro. Do të duhej të ndryshohej në jo më pak se 100.000 euro. Pra jo të kufizohej edhe pragu i sipërm edhe i poshtëm, por të kufizohet dakord pragu i poshtëm dhe të thuhet: jo më pak se 100.000 euro, por t'i lihet mundësia që ky 100.000 euro të jetë edhe më i madh, pra të kemi një far lloj komoditeti dhe mundësie që shuma të jetë dinamike në raport me kërkesat shoqërore.

Këto ishin vërejtjet tani për tani. Natyrisht, në punën e Komisionit do të bëjmë përpjekje që ta trajtojmë edhe më thellësisht, me synim që ta përmirësojmë edhe më tutje këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadriaj, e ka fjalën.

TIME KADRIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ligji për skemën sociale, për ndihma sociale në Kosovë ka pasur paqartësi, konfuzion, kundërshti edhe dispozita kontradiktore.

Në bazë të kriterëve kontradiktore, ky ligj nuk ka qenë funksional në terren dhe iu ka mundur që ndihma sociale të marrin familjet të cilat nuk kanë pasur nevoja sociale, ndërsa iu ka mohuar kjo e drejtë familjeve që vërtetë kanë pasur nevojë për ndihma sociale.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe do ta përkrahë në parim dhe ndihmën e vet do jep gjatë amendamentimit të këtij projektligji në komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Koalicioni për Kosovë të Re, Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

I nderuari ministër,

Kolegë dhe kolege deputetë,

Janë për t'u përshëndetur këto ndryshime të cilat janë paraparë në këtë Projektligj të cilin sot i kemi para veti, për vet faktin se gjatë periudhës së kaluar apo gjatë këtyre 11 viteve, kemi qenë të gjithë dëshmitarë për parregullsitë të cilat janë paraqitur në anën e zbatimit të këtij ligji, ku kanë përfituar familjet të cilat nuk e kanë merituar, ndërsa ato të cilat vërtet kanë merituar, kanë mbetur jashtë skemës për shërbime sociale.

Andaj ne të gjithë, por në radhë të parë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, së bashku me qendrat për punë sociale dhe komisionet përgjegjëse, duhet të jenë më koshiente që t'i përfshijnë në këtë klasifikim të vërtetë ato familje të cilat e meritojnë një ndihmë të tillë sociale.

Unë e përshëndes këtë iniciativë dhe këto ndryshime në Projektligj, e veçanërisht për mos të humbur kohë, duke respektuar kokën e deputetëve dhe juve të gjithë këtu, e përgëzoj ministrin, e sidomos lidhur për nenin 9/a ku parashihen këto ndryshime dhe që fëmijët menjëherë pas lindjes e deri në moshën 18 vjeçare të përfitojnë ndihma në mënyrë që ato ndihma të përfshihen edhe gjatë shkollimit të tyre parauniversitare.

Koalicioni për Kosovë të Re, do ta përkrahë këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të SLS-së, Boban Todoroviq, e ka fjalën.

BOBAN TODOROVIC: Hvala, gospodine predsjednice!

I Parlamentarna grupa samostalne liberalne stranke razmatrala je Nacrt zakona o šemi socijalne pomoći, i glasaće za isti. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit

Në emër të Gruit “6+”, deputeti Albert Kinolli, e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” në parim do ta përkrah këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Për diskutim është deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë që Qeveria, gjegjësisht Ministria e Punës për Mirëqenie Sociale, ka vendosur që një ligj të rëndësishë së veçantë, siç është Ligji i skemës së ndihmave sociale, ta sjell në Kuvend për plotësim-ndryshim dhe ne të japim kontributin tonë.

Në bazë të asaj që e kam analizuar Ligjin në fuqi dhe Projektligjin, por edhe duke u bazuar në vizitat dhe sugjerimet nga vetë punëtorët e asistencës sociale, sugjerimet e mia janë këto:

Për shembull neni 2, paragrafi 2, ku thuhet “shefi i Shërbimit të ndihmave sociale, të zgjidhet nga komuna në bashkëpunim me Ministrinë.” Mendoj se duhet të jetë, të zgjidhet vetëm nga komuna nga se shefi i Shërbimit të ndihmave sociale, është punëtor i komunës.

Paragrafi 1 i nenit 3, është plotësuar dhe ndryshuar. Me këtë rast Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale i ka plotësuar standardet që i kanë shtetet e zhvilluara evropiane. Domethënë i është e njohur e drejta në ndihma sociale personave që kanë leje qëndrimi në Kosovë, azilkërkuesit, refugjatët si dhe me këtë projektligj janë përfshirë në mbrojtje materiale viktimat e dhunës në familje, të cilat janë në mbrojtje të përkohshme, gjegjësisht në strehimore.

Paragrafi 6 i nenit 4, është mirë që është ndryshuar, nga se nuk do të jenë valide vetëm certifikatat mjekësore të lëshuara nga ordinancat e ndryshme.

Në Projektligj thuhet se duhet bërë ekzaminimin e rasteve nga komisioni mjekësor që e formon Ministria e Punës dhe e Mirëqenies sociale.

Do të ishte më mirë që Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale të kontraktonte komisionet mjekësore nga regjionet përkatëse për ekzaminimin e rasteve për arsye të numrit të madh të rasteve, sepse një komision i vetëm nuk mund të jetë në nivel të detyrës.

Neni 12, i cili flet për ndihma të veçanta, nuk i kategorizon rastet të cilat kanë të drejtë ta kërkojnë këtë ndihmë. Kjo është lënë të rregullohet në udhëzim administrativ, por edhe në udhëzimin administrativ të Ligjit në fuqi nuk është paraparë kategoria e personave me sëmundje të rënda akute si dhe të aksidenteve.

Prandaj konsideroj se duhet të saktësohet se në të cilat raste mund të kërkohej kjo lloj ndihme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nuk ka të lajmëruar për diskutim. Shkojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Prezentë janë 74 deputetë.

Konstatohet se me 62 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e punës të Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e radhës:

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për diasporën në Kosovë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin, përkatësisht zëvendëskryeministrin Bujar Bukoshi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BUJAR BUKOSHI: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Zoti ministër,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush shkurtimisht të paraqes Projektligjin për diasporën e Kosovës, të miratuar nga Qeveria me një vendim të datës 21 dhjetor 2012.

Ky Projektligj përcakton rregullat bazë për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së diasporës.

Projektligji ka për qëllim ruajtjen e identitetit dhe zhvillimin e kulturës së diasporës dhe lidhshmërinë e tyre me Ministrinë e Diasporës së Republikës së Kosovës, që ndihmon në organizimin e mërgimtarëve në shtetet e ndryshme ku jetojnë ata, si dhe të ndihmojë, të nxisë dhe të zhvillojë marrëdhënie ndërkulturore në me të Republikës së Kosovës me shtetet ku gjenden mërgimtarët.

Projektligji parasheh themelimin e qendrave kulturore të Kosovës për diasporën, që kanë për qëllim të promovojnë Kosovën, të nxisin dhe të zhvillojnë njohuri për gjuhët, kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Kosovës dhe të nxisin bashkëpunimin në mes Kosovës dhe mërgimtarëve.

Ministria e Diasporës bënë koordinimin e realizimit të interesave të mërgimtarëve nëpërmjet të ministrive përkatëse dhe qendrave kulturore të Kosovës për diasporën.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën tonë dhe me standardet e Bashkimit Evropian.

Të nderuar deputete,

Të nderuar deputetë,

Ju propozoj që ta miratoni këtë Projektligj. Ju faleminderit, që më dëgjuat me vëmendje, sidomos atë zotëriun nga LDK-ja.

KRYETARI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministër!

Fjala është për kryetarin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport dhe Administratë Publike e Qeverisje Lokale, Media, deputetin Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zotëri zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin për Diasporën e Kosovës dhe ka vlerësuar se Projektligji i plotëson të gjitha kriteret dhe standardet konform Rregullores së Kuvendit, prandaj i rekomandojmë Kuvendit për miratim në parim.

Të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet do të merren parasysh nga ana e komisionit funksional që Ligji të jetë sa më komplet dhe i zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYTARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit, deputetja Flora Brovina e ka fjalën,

FLORA BROVINA: Jo unë nuk e mora në emër të grupit. Ju e patët fjalën! Unë desha veçantë me diskutuar.

KRYETARI: Mirë, mirë, më fal se unë ndoshta e ngatërrova. Deputeti Ramë Vataj, e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës, me vëmendje e ka shqyrtuar këtë Projektligj. Në fakt ky është plotësim-ndryshim i një ligji që është aprovuar këtu në Kuvend para më shumë se një vit e gjysmë, ka qenë Ligji për mërgatën e Kosovës.

Ne e vlerësojmë shumë të rëndësishëm këtë ligj sepse ky rregullon edhe ndikon drejtpërdrejtë në organizmin e jetës së mërgimtarëve tanë që janë jashtë Kosovës. Sidomos është i rëndësishëm për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit gjuhësor dhe kulturor të mërgimtarëve tanë.

Ne do të punojmë në grupet përkatëse dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet përkatëse dhe e votojmë në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, fjalën e donë deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra, kolegë,

Edhe ne në Grupin Parlamentar të LDK-së e kemi shqyrtuar ligjin. Dhe, duke e ditur edhe vetë rëndësinë e Ligjit, ne jemi që ta përkrahim këtë fazë, por realisht e konsiderojmë se është një ligj shumë i varfër, posaçërisht tani kur Kosova e ka Ministrinë përkatëse - pra për Diasporën. As për afërsisht ky ligj nuk i rregullon përgjegjësitë dhe detyrat e një Ministrie që do tu kishte marrë me këtë fushë në mënyrë më gjithëpërfshirëse.

Në rend të parë mendojmë se që në ligj duhet të definohet obligimi i Ministrisë për të krijuar regjistrin e të gjithë qytetarëve me prejardhje nga Kosova, që cilësohen në grupin e qytetarëve të diasporës. Pastaj, përveç qendrave kulturore, asgjë më shumë nuk parashikohet se si do të jetë kontributi i kësaj Ministrie në drejtimin e qytetarëve tanë dhe t'ju ndihmoj në ruajtjen e identitetit kombëtar, zhvillimi në kulturës, kontributin në

arsim dhe në fusha tjera. Dhe posaçërisht asgjë në ligj nuk ka të definuar në raport me kontributet që ne duhet dhënë me rastin e vizitave të tyre, sidomos në kohën e vizitave kur në Kosovës vjen një numër i madh i qytetarëve.

Prandaj, unë mendoj se pikërisht kjo Ministri në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës dhe të fushave të tjera përgjegjëse të kësaj ministrie, pastaj me Ministrinë e turizmit dhe me komunat duhet ta caktojnë një agjendë të saktë se si do të kishim mundur me zhvilluar aktivitete, në mënyrë që bashkatdhetarët tanë të ndihen mirë në vendlindjen e tyre dhe sidomos fëmijët e tyre të lidhen më mirë me vlerat që i kemi, dhe shumëzimin dhe afirmimin e këtyre vlerave në vendet ku ata jetojnë.

Pastaj, edhe kur flitet për kontributin, gjegjësisht bashkëpunimin në drejtimin e thithjes së investimeve dhe kur lidhet me kapitalin e bashkatdhetarëve, me asnjë fjali me asnjë ligj tonin akoma nuk kemi se cilat duhet të jenë lehtësirat që duhet t'ju mundësohet bashkatdhetarëve tanë që ata të joshën dhe të vijnë të investojnë në Kosovë.

Mirëpo, duke marr parasysh se e kemi një Ministri të posa formuar, dhe ministri nuk është këtu dhe unë e di që zëvendëskryeministri e ka marrë hua këtë që e paraqiti këtu, edhe pse nuk e kemi dëgjuar krejt, por e dinim që hua e ka ky, hua po i themi ne, por sido që të jetë, pres që ministri të angazhohet me gjithë potencialin që e ka dhe Zyra e kryeministrit, në mënyrë që këtë ligj ta begatojmë dhe ta dizajnojmë komform përgjegjësi dhe obligimeve që duhet me pas në ministri me kapacitet të plotë për një fushë kaq të rëndësishme, siç është diaspora.

Ne pra e përkrahim n parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale apo në grupin e punës që të ndërtohet, në mënyrë që ky ligj të kompletohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Vetëvendosjes, deputeti Florin Krasniqi, e ka fjalën.

FLORIN KRASNIQI: Ju faleminderit, kryetar!

Për faktin që ministri nuk është këtu, është edhe një provë se në ç'mënyrë trajtohet diaspora.

Ky Ligj as për së afërmi nuk i plotëson kërkesat dhe nevojat e diasporës.

Vetë fakti se Ministria e Diasporës lindi si rezultat i pazareve politike, jo ide nevojë, për të cilën ne ishim gjithmonë po ajo kaloi. Dhe, vetë përkufizimi i fjalës mërgimtar është aq i gjerë sa që në këtë përkufizim do të kishin hyrë edhe disa qindra mijëra shqiptarë të Shqipërisë që e kanë origjinën prej Kosove. Shtrohet pyetja: a janë këta diasporë? Nuk përkufizohen.

Unë kam jetuar tash e 22 vjet në diasporë. Kamë parë gjithë diasporën prej Australie në Evropë dhe në Amerikë. Diaspora e Kosovës, në fakt nuk ekziston. Në asnjë komunitet

as në Evropën perëndimore as në Amerikë, nuk kam parë që ka një diasporë që quhet diaspora e Kosovës, ka diasporë shqiptare, ose gjithë-shqiptare.

Në këtë Projektligj, parashihen disa qendra kulturore të Kosovës për diasporën. Mënyra e zgjedhjes së drejtorëve të këtyre qendrave, është krejtësisht politike dhe mënyra se si zgjedhën këta drejtorë - është një përfaqësues i Zyrës së kryeministrit, dy të Ministrisë të Diasporës, një i Ministrisë së Kulturës, edhe një i Ministrisë të punëve të jashtme. Çka do të thotë kjo? Ne do ta politizojmë diasporën edhe më shumë. Dhe, nuk është pse nuk pyetët opozita rreth emërimit të këtyre drejtorëve, por nuk pyetet as diaspora.

Këto emërimë do të bëhen vetëm sa për t'i gjetur punë disa të afërmeve të qeveritarëve, disa militantëve politikë ose të ndonjë të dashur të qeveritarëve.

Ne nuk mundemi ta votojmë këtë Projektligj se as për së afërmi nuk i plotëson kushtet edhe nevojat e diasporës shqiptar.

Dhe, për faktin se nuk ekziston diaspora kosovare, prapë po them, kjo është edhe një përpjekje për ndarjen e shqiptarëve këtu edhe atje. Mirëpo, besoj se kjo përpjekje do të dështojë, të paktën atje.

Po edhe sikur të kalonte ky ligj, në nenin 14 thuhet: “Ky Ligj do të jetë i zbatueshëm në qoftë se ka mjete”. Çfarë kuptimi ka kjo? “... në qoftë se ka mjete”?! Në qoftë se s’ka, s’ka! Ligj koti që thotë Shqipëria, kështu që na nuk mundemi ta votojmë këtë ligj.

Kjo është mendoj fyerja e radhës që i bëhet diasporës. Diaspora ka kapacitete shumë të fuqishme për faktin se diaspora e ndihmoi aq shumë në shtet ndërtimin e Kosovës, po ndihmon aq shumë në shtet-formimin e Kosovës, e ka ndihmuar aq shumë shtet-mbajtjen e Kosovës.

Mendoj se diaspora meriton një trajtim shumë më të mirë se ky, kështu që na nuk do të mund ta votojmë këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ne emër të AAK-së, kush e do fjalën? Teuta Haxhiu, e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mbi një e katërta, apo mbi 500.000 qytetarë, pa e llogaritur Turqinë, jetojnë dhe veprojnë jashtë kufijve të Kosovës.

Reduktimi i nevojave, i obligimeve dhe kërkesave të një numri kaq të madh të qytetarëve të Kosovës, me një Projektligj i cili ka 17 nene, që e dallon nga ligji i mëparshëm nga Agjencioni për Mërgatën e Kosovës, ligj ky i cili duhet të shfuqizohet me ligjin e ri që po diskutohet këtu, është tregues më i qartë se me çfarë serioziteti është trajtuar problematika e kësaj pjese të popullsisë që jeton jashtë shtetit dhe në instancën e fundit, nxjerr në shesh të vërtetën se si sa çmohet kapitali njerëzor i mërgimtarëve të Kosovës,

të cilët gjatë periudhave të rënda nëpër të cilat kaloi Kosova në dekadat e kaluara nuk kursyen asgjë që patën, qoftë për të siguruar mbijetesën e banorëve të saj, qoftë për të ndihmuar çlirimtarët e Kosovës nga okupatori, e madje një numër jo i vogël i tyre e dhanë edhe jetën e tyre për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Kjo sjellje e Qeverisë së Kosovës, për mos të thënë, e të zgjedhurit të këtyre qytetarëve me votën e këtyre që këta sot po e mbajnë pushtetin - është e pakuptimtë dhe aspak serioz, kur dihet që edhe sot e kësaj dite nga diaspora kosovare hyjnë mbi 500 milionë euro të hyra në vit.

Ky ligj sa shihet është i mangët sepse si i tillë, përfundimisht përjashton komunitetin e mërgimtarëve të Kosovës për të mos marrë pjesë në jetën politike të Kosovës.

Qytetarit të Kosovës që jeton jashtë Kosovës, sipas këtij ligji, i tregohet se si duhet të organizohet përmes formimit të qendrave kulturore për diasporën, por në të njëjtën kohë qendrën apo drejtorin e qendrës e zgjedh Qeveria përmes konkursit në të cilin fare nuk merr pjesë në vendimmarrje mërgata e Kosovës.

Sipas nenit 7 të propozuar në këtë ligj, i cili e përcakton zgjedhjen e drejtorit të qendrës përkatëse kulturore të diasporës, ku në komisionin për zgjedhjen e drejtorit, anëtarët e komisioneve janë përfaqësuesit e Zyrës së kryeministrit, Ministrisë së Diasporës, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Nga vetë komuniteti i diasporës të cilëve u dedikohet ky Projektligj në përzgjedhjen e drejtorit, nuk ka asnjë anëtar.

Për të mos mjaftuar kjo, në nenin 8 për financimin e qendrave kulturore të diasporës, shkohet akoma më larg. Për financimin e këtyre qendrave kërkohet të paguhet anëtarësimi nga mërgimtarët.

Pika 1, 2 e nenit 8 financimi, mjete për funksionimin dhe veprimtarin e qendrës, të sigurohen nga anëtarësimi. Kjo do të thotë lirisht formim i një partie të re.

Në nenin 4, Ministria për Diasporën në pikën 1.8 thuhet se “Ministria do të hartoj regjistrin e mërgimtarëve”, përderisa në fakt Ministria dhe Qeveria e Kosovës, do të duhet që në bashkëpunim me Agjencionin e statistikave dhe institucionet tjera të thirrura për këtë temë, të bëjnë regjistrimin e mërgimtarëve të Kosovës, pasi që deri më sot asnjë institucion nuk ka të dhëna të sakta për numrin e mërgimtarëve dhe vendndodhjen e tyre.

Kjo është edhe më e nevojshme kur dihet se në regjistrimin e fundit të popullsisë së Kosovës mërgata ka mbetur jashtë procesit të regjistrimit nën arsye se janë rezidentë në Kosovë.

Në këtë ligj, fare nuk është paraparë trajtimi i diasporës shqiptare në Turqi, e të mos flasim për mundësinë e kthimit të tyre pasi që këtë kthim e pamundëson Konventa turke – jugosllave, e nënshkruar në vitin 1937.

Një pikë e veçantë në këtë projektligj, t'i kushtohet koordinimit të Ministrisë së Diasporës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për kthimin e kapitalit intelektual e mendor nga mërgata, e jo Ligji të merret me përcaktimin e nivelit të pagës apo mënyrën e sigurimit të mjeteve financiare për drejtorin e qendrës kulturore, shih nenin 7 pika 2, që propozon se paga e drejtorit të Qendrës kulturore të jetë e nivelit të njëjtë me sekretarin e Ambasadës së Kosovës në vendin ku vepron qendra.

Me gjithë mangësitë e shumta që janë në këtë projektligj, Aleanca do ta votojë në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar, Koalicioni për Kosovë të re, Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Ju faleminderit, kryetar!
I nderuar Zëvendëskryeministër,
Ministër,
Të nderuar Kolegë deputetë,
Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar dhe do ta votojë Projektligjin.

Projektligji është mirë i përgatitur, por ka nevojë për disa plotësime dhe ndryshme, të cilat do t'i shqyrtojmë në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Në emër të SLS-së, deputeti Milivoje Stojanviq, e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Gospodine predsjedniče!
Prisutni ministri i poslanici,
Poslanička grupa SLS je razmotrala Nacrt zakona o dijaspori.

Pozdravljamo donošenje ovakvog Zakona, jer svi znamo da ima veliki broj iseljenika našeg stanovništva u svetu. Potrebno je očuvati identitet, negovati i razvijati kulturu svih zajednica, povećati obrazovne i ekonomske kapacitete naših iseljenika.

Ovim Nacrtom zakona stvaraju se uslovi preko Kulturnog centra za dijasporu za očuvanje i negovanje jezičkog, kulturnog, obrazovnog identiteta pripadnika dijaspore.

Struktura organizacije i delovanje Kulturnog centra za Kosovo, Nacrtom zakona je predviđeno da se reguliše podzakonskim aktom.

Mišljenja smo da je bolje da se ova materija reguliše samim zakonom, a ne podzakonskim aktima.

Pozdravio bih ono što je u članu 9. precizno utvrđeno da se daje podrška učenju i unapređenju službenih jezika u dijaspori, odnosno što se Vlada obavezuje da svoje iseljenike pomaže preko odgovarajućeg Ministarstva dijaspore, u stvaranju uslova za očuvanje i učenje službenih jezika i na jezicima drugih zajednica na kojima se izvodi obrazovni sistem kao i razvoj nastavnog procesa obrazovnih radnika za zvanične jezike i na jezicima drugih zajednica, na kojima se izvodi obrazovni sistem.

Ovo kako je dato u Zakonu, veoma je dobro, što se tiče implementacije zvaničnih jezika i jezika drugih zajednica.

Međutim ja izražavam jednu bojaznost da će to biti, na neki način, mrtvo slovo na papiru, jer Zakon o jezicima, na neki način svedoci smo da se u potpunosti ne primenjuje ni ovde u kosovskom društvu.

Član 11. definiše informisanje dijaspore i predviđa da Javna televizija obezbedi 6 do 9 procenata mesečne programske šeme za poseban program za dijasporu. Međutim, ovim zakonom nije definisanje informisanje i svih zajednica i korišćenje jezika svih zajednica, što bilo poželjno da se definiše zakonom.

Pozdravio bih da se što pre donese strategija o dijaspori, a istovremeno ističem da će Poslanička grupa podržati ovaj Nacrt zakona o dijaspori i svoj doprinos će dati kroz rad u komisijama. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të grupit parlamentar “6+”, deputeti Enis Krvan, e ka fjalën.

ENIS KRVAN: ju faleminderit, kryetar!

Bu Yasa Tasarısının amacı kültür, eğitim, bilim, ekonomi gibi toplumun önemli alanlarında kimliğin, dillerin, kültürlerin korunması ve geliştirilmesiyle aynı zamanda ülkeler ve halklar arasında çok yönlü işbirliğin daha üst düzeye çıkarılmasıdır.

Kosovalı Türklerin beklentilerinin içeren Yasa Tasarısının 7. maddesinde internet ağı söz konusu olunca Türkçenin kullanımıyla ilgili bazı düzeltmelere gidilmesi gerekmektedir. Dolayısıyla Yasa Tasarısının önemli hedeflerinden biri de Kosova Diaspora Bakanlığının faaliyetleri ve ülke dışında mevcut olan Kosova Kültür Merkezlerinin işlevsel olmasıdır. Önerilerimizi mevcut komisyonda sunacağız. Prensipite Yasa Tasarısını kabule ediyoruz.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Dhe tani, është radha e diskutuesve. Fjalën e ka deputeti, Sabri Hamiti,

SABRI HAMITI: Zotni kryetar,
Zotni zëvendëskryeministër,

Deputetë të nderuar,

Po dal kështu, se kam qejf me u pa sy më sy, se ashtu diqysh me shpinë, nuk po më pëlqen shumë.

Ky është një ligj që është ndërtuar, faktikisht është rimarrje e një ligji, e tha një kolegë pak para meje këtu dhe bëri mirë që e tha. Me të vërtetë është një rimarrje i një ligji që ka qenë Ligji për mërgatën me ndryshime, unë do të thosha, shumë të vogla.

U tha pastaj, edhe që ky ligj edhe në arsyetimin e zëvendëskryeministrit, që ka të bëjë kryesisht me dy elemente - me çështjen e identitetit, çështjen identitare që lidhen me arsim kryesisht dhe me kulturë.

Menjëherë po them që është një ngushtim i jashtëzakonshëm i materies, i substancës që do të duhej të kishte një ligj i cili e ka emrin Ligji për diasporën.

Ngushtim i jashtëzakonshëm! E thash me qëllim që është faktikisht derivim gati i njëjtë, me derivim të vogël, gati i njëjtë me Ligjin për mërgatën, sepse tash ne jemi në një situatë tjetër.

Ai ligj për mërgatën pak a shumë ka qenë reflektim i një departamenti, qoftë pranë Ministrisë, qoftë pranë një Kryeministrie një ministri tjetër.

Sot ne jemi në një situatë tjetër. Ne kemi Ministri të Jashtme, kemi Shërbim diplomatik dhe në të njëjtën kohë kemi një ministri të përcaktuar me sektorë diasporën. Në kuptimin e organizimit të Qeverisë, kemi një rrjet të tërë i cili merret me këtë problematikë, ndërsa ligji, të cilin e propozon Qeveria dhe Ministria sot është ligj me pak substancë.

Përpos pjesës identitare dhe kulturore, Ligji nuk merret me atë që quhet kapacitet i vërtetë i diasporës shqiptare, rëndësia e saj, përcaktimi dhe strukturimi ligjor i saj në komunikim me Kosovën, jo vetëm në aspektin kulturor e identitar, por në aspektin politik dhe në aspektin ekonomik.

Nuk është mirë diaspora të trajtohet si ndihmë për mbijetesë në Kosovë, çfarë është e që trajtohet në esencë e pa deklaruar dhe të kujtohet që është mirë që është një substancë nacionale e Kosovës, e cila është mirë të mos harrojë të flas shqip në familje, ose eventualisht i ka do orë plotësuese në gjuhën amëtave, ose eventualisht t'i krijohet mundësia që të krijojë shoqëri kulturo-artistike, që të vishen me tierqi dhe të këndojnë këngë folklorike.

Ky është një simplifikim i palejueshëm. Dhe unë mendoj që me të tilla kritere nuk duhet të ndërtohet ky ligj.

Unë e pash dëshirën edhe të komisionit funksional që të kaloj ky ligj, por unë kam një problem rreth këtyre ligjeve. Ne kemi mirësi të mos i ndalim ligjet, por është pak problem se për t'u bërë kjo që unë po lypj dhe që e konsideroj të domosdoshme - ky ligj

duhet të rishikohet 40-50%. Është një punë sizifi që në lexim të parë të kalohen ligjet, të cilët paraprakisht ne e dimë dhe jemi të vetëdijshëm që duhet shkruar në 30-40%.

Unë nuk dua tashi këtu të bëj fajtor asfare komisioni, por unë po e ritheksoj problemin që duket që është problem i madh dhe i pazgjidhur me draftin që e kemi ne përpara.

Dhe mos të harrojmë, ligjin ne po e marrim pak si lehtë në leximin e parë. Në të vërtetë leximi i parë e kalon ligjin. Dhe ky është problem i këtij Kuvendi, problem sistematik i punëve të ligjeve.

Kur e kalojmë ligjin në lexim të parë, në tëra parlamentet normale, ai është ligj i kryer dhe leximi i dytë perfeksionin diçka, por strukturë nuk ndërron.

Te ne qëkur në Komision kjo kalohet lehtë, dhe ju merreni të gjitha komisionet, unë të 16-at i kam lexuar, e kanë një skemë. Komisionet, ato janë kryesore, ato thonë është ligji në rregull dhe a kalon në lexim të parë.

Janë krejt formale, tani i kam dy fjali dhe është një nen 56 që është formal, se atë nen 56, administrata e Kuvendit mundet me e pa, është në tri gjuhë, a është midis, a është i lekturuar, a s'është i lekturuar, a e kanë marrë me kohë, e tjera.

Substanca duhet të kalohet atje. Nuk mund të kalohet ligji në lexim duke imagjinuar që në lexim të dytë të ndreqet. Jo, nuk ndreqet në lexim të dytë.

Kështu që problemin, e theksova duke pasur parasysh këtë ligj, se e shoh jo substancial për trajtimin e fuqisë dhe të rregullimit, edhe një herë po them: identitar, politik, ekonomik, substancial. Sepse, unë diasporën nuk e shoh, edhe në herë - si ndihmë për mbijetesë, por e shoh si potencial të madh edhe të dijes edhe të kapitalit.

Nëse nuk krijojmë rrjet ligjesh që merren me diasporën, dhe jo vetëm një ligj, për të gjitha këto probleme atëherë ne formalisht do ta kalojmë një ligj por nuk do të zgjidhim asgjë.

Dhe fundi i fundit, ne kemi mbaruar edhe një Ministri të Diasporës, por vetë financat që i janë ndarë asaj ministrie dhe mënyra qysh funksionon, është pak a shumë simbolike.

Ne kemi nevojë për substancë, jo për simbolizëm. Duhet të krijohen kushtet që ajo dije, ai kapital vërtet të vijë me interes në Kosovë. Jo të na krijojë lidhje me shtetin vendas, se me shtetin vendas është rrjeti diplomatik që funksionon, dhe ato farë shoqëritë që mund të krijohen. Ju mund të keni atashe kulturor te ambasadat që i rregullojnë këto punë. Dhe diaspora, keni kujdes, mund të jetë diasporë e Kosovës që është shtetas dhe kërkon të hyjë në rrjetin e vlerave të vendit që është dhe mund të jetë mërgimtar. Edhe definicioni është dysor.

Prandaj po them edhe një herë, nuk jam për ta ndaluar, por unë atë variant nuk e shoh të plotë për problemin për të cilin shtrohet. Kaq zotni kryetar. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!
I nderuar zëvendëskryeministër,
Zonja dhe zotërinj deputetë,
Më lejoni që duke ju përshëndetur edhe unë t'i bashkëngjitëm atyre që mendojnë se një ligj i tillë na duhet dhe duhet ta mbështesim. Na duhet, se mërgata jonë vërtetë ka luajtur një rol të veçantë në këtë që kemi dhe meriton shumë më shumë, meriton trajtim tjetër, meriton përkujdesje tjetër institucionale për problemet e shumta të tyre dhe, nëse këto nuk po arrijmë t'i zgjidhin, atëherë së paku në ligj adekuat do të duhej ta bënim.

I duhet Kosovës një ligji ri, edhe për arsyen e thjeshtë se është ndryshuar struktura e përkujdesjes institucionale. Ishte një agjencion, tash kemi një Ministri dhe kjo impononte nevojën e ndryshimeve.

Por ç'është e vërteta, sado që do të dëshiroja të mos ishte kështu, Ligji vërtetë lë për të dëshiruar. Për më tepër, mendoj në ndonjë aspekt, është edhe më keq se sa ai i mëparshmi.

Më lejoni t'i theksoj vetëm disa prej vërejtjeve. Së pari me vetë titullin. E kemi pasur edhe në propozimin e parë këtë titull dhe e kemi kontestuar, e kemi ndryshuar, sepse është konstatuar në këtë Kuvend se shprehja "diasporë" nuk përfshinë kategoritë e mërgatës sonë. Ka vende që kanë më shumë diasporë se mërgatë, por mërgatë dhe diasporë nuk është një dhe e gjithë mërgata jonë nuk mund të futet në kallëpin e diasporës.

Është specifike gjendja e njerëzve tanë në botë, prandaj edhe do të duhej marrë përvoja të përafërta me këto tonat. Por tendenca e diasporizimit të mërgatës sonë është në kundërshtim me thelbin e këtij ligji.

Me ligj ne synojmë të ruajmë lidhjet me ta, të ruajmë, siç thuhet, identitetin e tyre. Kurse, nëse ne e diasporizojmë, do të thotë praktikisht, që ta bëjmë të kundërtën.

Për më tepër, edhe në qëllimin e Ligjit edhe ashtu siç është thënë, siç e tha parafolësi – reduktohet vërtet në mënyrë të palejueshme edhe përkujdesje institucionale për mërgatën tonë. Kthehet vetëm në një diçka kulturore që ka qenë një linjë e vazhdueshme e insistimit për ta ngushtuar, dhe nuk e kanë askush pothuaj se në këtë mënyrë.

Mërgata nuk është vetëm objekt kulturor, si të thuash. Është shumë më shumë se kaq. Prandaj edhe kujdesi i duhet të jetë i plotë.

Për mendimin tim ka qenë dashur të merret, dhe më e përshtatshme ka qenë përvoja e Kroacisë. Kroacia nuk ka ligj as për diasporën, as për mërgatën por ka ligj për bashkëpunimin e Republikës së Kroacisë me kroatët jashtë Kroacisë, me kroatët nëpër

botë. Dhe aty janë përfshirë pastaj linjat, dhe bashkëpunimi i përkujdesjes edhe politike, edhe ekonomike, edhe kulturore, edhe gjuhësore dhe gjithfare, sepse vetëm ashtu mund të jenë të plota. Angazhohem që kjo të korrigjohet edhe në rastin tonë.

Mospërputhje të tillë gjejmë madje edhe brenda tekstit edhe në përkufizimet, diku përfillet për mërgatën, diku për diasporën, diku madje edhe shkurtesat nuk sqarohen, në gjuhë të ndryshme, janë në forma të ndryshme, por unë nuk po marrë kohë me këtë lloj lajthitjesh, se besoj që edhe mund të rregullohen.

Ligji përsëri ka disa formula që i kanë edhe disa ligje tjera të natyrës – “Ministria e diasporës duhet t’i kushtojë kujdesë të veçantë kësaj, e kësaj çështjeje e tjera”, dhe kjo gjuhë nuk është juridike, nuk është gjuhë e ligjeve. Mendoj që duhet të fshihen gjithkund formula të tilla që merren prej programeve të ndryshme, prej strategjive të ndryshme e tjera, por kur bëhen ligj, duhet të marrin gjuhë ligjore.

Është dizajnuar këtu organizimi i mërgatës në formë të qendrave kulturore, si shprehje e asaj tendencës për ta ngushtuar kujdesin për mërgatën, kurse vendet tjera, ta zëmë, Kroacia ka strukturë krejt tjetër fare. Mendoj që është mirë të rishikohet. Por, pastaj edhe ato siç janë, është menduar të jetë një qendër këtu në Kosovë, si kryesorja, dhe pastaj qendra në vendet tjera dhe përveç anomalive tjera që u përmendën kam hasur atje edhe thuhet që financimi duhet bëhet edhe me anëtarësimin e mërgimtarëve, që nuk e gjej të vendet tjera, dhe nuk di si do të funksiononte kjo përzierja e përkujdesjes institucionale me vetë organizmin e mërgatës.

Mërgata jonë ka një formë të organizimit dhe mendoj që është dëshmuar si mënyra më e mirë organizimi i saj dhe funksionimi i saj në formë të bashkësive të komunitetit. Tani i kemi edhe përparësi diplomatike dhe një ndërlidhja adekuate, me një përkujdesje suplementare nga Ministria, mendoj që do të ishte zgjidhja më e mirë.

Ka edhe përsëritje ta zëmë, neni 5.2 me nenin 14 – e thonë pikë për pres të njëjtën gjë.

Në vende tjera ka edhe në ditë të mërgatës që mendoj se do të ishte mirë të mendohet që edhe Kosova ta kishte një ditë të mërgatës edhe ditë të trajtimit të problemeve të tyre, por edhe të lidhjes me vendin. Mendoj se më mirë se qendër kulturore për kujdesin e mërgatës do të ishte mirë që si në rastin e Kroacisë të ketë një këshill. Ne kemi këshilla për disa fusha dhe mendoj që do të ishte më mirë edhe kjo të jetë. Dhe në këtë këshill, nuk mjafton të jetë, siç është thënë, i përfaqësuar vetëm ministri i Mërgatës, por do të duhej të ishte edhe ai i Punëve të Jashtme. Në Kroaci Ministria e Punëve të Jashtme e sponsorizonte këtë ligj. Do të duhej të ishte edhe ai i Arsimit se është përkujdesja për arsimin një interes i veçantë, por edhe për zhvillimin ekonomik e investimet, sepse investimet nuk mund të përthekohen në kuadër të përkujdesjes kulturore.

Mërgata jonë ka edhe një specifikë të veçantë - është e bashkuar, është e integruar. Dhe mendoj që edhe përkujdesja duhet të jetë e tillë, ta ruajë dhe ta respektojë këtë specifikë të mërgatës tonë që nënkupton edhe për përkujdesjen për njerëzit tanë

jashtë Kosovës edhe në vendet fqinje, siç u tha me të drejtë, sepse të gjithë e kanë dhe nuk do të ishte normale që vetëm Kosova t'i injorojë, ta zëmë, banorët e Kosovës jashtë Kosovës në vendete fqinje ose t'i trajtojë ata si diçka tjetër në bazë të përkatësive etnike.

Besoj që gjatë amendamentimit këto do të korrigjohen, edhe pse edhe unë mendoj se do të jetë vështirë të gjitha këto të bëhen me përmirësime, por mendoj se prapë do të ishte rruga më e mirë për të mos e kthyer ligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputeti, Haki Demolli, e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit i nderuari kryetar,
I nderuari zëvendëskryeministër,
I nderuari ministër,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Fillimisht do të dëshiroja të theksoja se, ndonëse neve si deputetë ky Projektligj na është paraqitur si një projektligj krejtësisht i ri, në esencë ky më mirë do të ishte të ishte një projektligj mbi ndryshimin e Ligjit numër 03-L/171 për mërgatën e Kosovës.

Kur e them këtë, kam për bazë faktet që dalin nga krahasimi i këtij projektligji me Ligjin për mërgatën e Kosovës. Sepse nga 17 nene, sa i ka ky projektligj, 11 nene janë plotësisht identike me Ligjin për mërgatën, kurse 2-3 nene janë të modifikuara dhe vetëm 3 nene janë krejtësisht të reja.

Prandaj, si i tillë mendoj se nuk është Projektligj i mjaftueshëm për të rregulluar një çështje shumë të rëndësishme për Kosovën, siç është diaspora kosovare apo diaspora jonë.

Së dyti, do t'i theksoja disa sugjerime lidhur me dispozitat përkatëse të këtij projektligji. Në nenin 5 të këtij drafti, rregullohet çështja e themelimit të qendrave kulturore të Kosovës për diasporën. Mendoj se mënyra se si është rregulluar kjo çështje ka lënë mundësinë që të krijohet bindja se nuk është analizuar mirë gjendja e diasporës tonë, andaj edhe nuk janë përcaktuar kriteret të cilat duhet përmbushur për themelimin e qendrave të tilla.

Është interesante se kështu si është përcaktuar me këtë nen, nuk ekziston kurrfarë baze ligjore që e ndërlidhë themelimin e qendrave të tilla me institucionet kosovare, respektivisht për Ministrinë e Diasporës, Ministrinë e Punëve të Jashtme, ambasadat dhe konzulatat tona apo edhe me vetë Qeverinë.

Mirëpo, draftuesi lidhjen e këtyre qendrave e bënë më poshtë në nenin 7 të Projektligjit ku flitet për zgjedhjen e drejtorëve të qendrës, respektivisht pagën e tyre, e cila do të jetë e baraz-vlefshme me pagën e sekretarit të ambasadës ku vepron qendra.

Andaj, propozoj që në nenin 5, përveç qëllimeve të themelimit të qendrave kulturore të Kosovës për diasporën, vendit të themelimit dhe natyrës juridike të tyre, të përcaktohen edhe kritere të tjera, siç janë: numri i mërgimtarëve, largësia prej një qendre në qendre tjetër si dhe pëlqimi i autoriteteve kosovare për themelimin e qendrave të tilla, për shkak të obligimeve ligjore dhe materiale që i merr Qeveria e Kosovës ndaj këtyre qendrave.

Më tutje, në nenin 4, paragrafi 2 theksohet, citoj: “struktura dhe organizimi i Ministrisë...” po e potencoj “...Ministrisë, rregullohet me akt nënligjor të cilin e aprovon Qeveria.”. Mendoj se ky paragraf duhet të fshihet në tërësi, sepse çështja e strukturës dhe e organizimit të Ministrisë nuk duhet të jetë fare objekt i këtij ligji, por i Ligjit për Qeverinë e Kosovës. Por, si duket ky paragraf ka mbetur nga Ligji mbi mërgatën, i cili përcaktonte dhe rregullonte strukturën organizative të Agjencisë së Mërgatës, konkretisht në nenin 7, pika 4.

Sugjerimi tjetër ka të bëjë me nenin 7, paragrafi 1, në të cilin thuhet: “Drejtori i qendrës zgjidhet me konkurs nga komisioni i emëruar, në përbërje prej 5 anëtarëve”, por dispozitat nuk tregojnë se kush e emëron këtë komision. Dhe, vërejtja ime e fundit për këtë draft ka të bëjë me nenin 14, të cilin në njëfarë mënyre e përmendi edhe zoti Krasniqi nga “Vetëvendosja” ku haset shprehja: “varësisht nga mundësit buxhetore, Qeveria e Kosovës do të vendosë për themelimin e qendrave”. Sikurse të ishin planifikuar mirë mjetet financiare dhe nevojat e diasporës para përpilimit të këtij drafti, jam i sigurt se nuk do të kishim pasur një dispozitë të tillë kushtetuese.

Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Sala- Berisha Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet zëvendëskryeministër,

Ministër,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Shumë varet se përmes çfarë prizmi shihet nga të tjerët ky angazhim i Qeverisë shprehur përmes këtij ligji.

Mendoj se bashkatdhetarët tanë janë një vlerë, janë një potencial intelektual politik dhe ekonomik dhe, mendoj se në këtë pikë pajtohem të gjithë. Do të pajtohem gjithsesi me vërejtjen që e dha zoti Hydajet Hyseni sa i përket termit “diasporë”, sepse etimologjia e fjalës “diasporë” e ka një kuptim tjetër në kundërshtim ndoshta me atë me qëllimin e ligjit se çka mendojmë të rregullojmë ne me kapitalin tonë të quajtur “mërgatë”.

Në këtë Kuvend ka edhe deputetë që e kanë përjetuar direkt ndjenjën e mërgimtarit, ndjenjën e të jetuarit dhe vepruarit me peshën e mallit për vendlindjen. Mendoj që një pjesë e tyre direkt janë edhe zëri i mërgimtarëve. Bashkatdhetarët tanë kanë ditur t'i përgjigjen zërit të atdheut në çdo kohë edhe në kohërat më të vështira, qoftë përmes

angazhimit të tyre direkt në Kosovë, qoftë përmes angazhimit të tyre financiar dhe diplomatik në vendet ku kanë jetuar dhe vepruar.

Mendoj se për mërgimtarët tanë është një lajm i mirë miratimi i këtij projektligji, sigurisht që në fazën e amendamentimit do të plotësohet dhe të vijë të përafrohet me dëshirën në të cilën u shpreh edhe këtu përmes kolegëve tanë. Me këtë ligj bashkatdhetarët tanë që jetojnë jashtë atdheut do ta ndjejnë dorën e shtetit të Kosovës në lehtësimin e jetës së tyre. Kjo paraqitet edhe tek neni 1, paragrafi 1.2. Të gjithë pajtohemi se ka qenë çështje imediate të ketë një urë lidhëse dhe komunikuese në mes të mërgimtarëve dhe Qeverisë së Kosovës. Këtë mendoj se mirë e ka paraqitur dhe e ka dhënë obligim vetit Qeveria përmes këtij projektligji në nenin 4 me themelimin e Ministrisë së Diasporës.

Është me rëndësi të dihet sa njerëz tanë jetojnë jashtë atdheut, pra të ketë një regjistër të tyre dhe kjo është e paraparë në nenin 4, paragrafi 1.8. Është më se e nevojshme të përmirësohet pozita e diasporës në vendet ku ata jetojnë dhe veprojnë, a janë të organizuar përmes shoqatave apo formave tjera të organizimit? Kjo është e paraparë te neni 4, paragrafi 1.14. Kjo çështje tani është obligim ligjor që del nga ky projektligj po në paragrafin e përmendur. Është me rëndësi të ceket se me këtë ligj rregullohet edhe një çështje shumë e rëndësishme sa për Kosovën aq edhe për bashkatdhetarët tanë, siç është kyçja e kapitalit intelektual dhe ekonomik të mërgimtarëve tanë që kjo është e paraparë, në qoftë se nuk gaboj te neni 12, ku thuhet se, te nenin 12 ku është e rregulluar ekonomia dhe shkenca. Madje, te ky nen paragrafi 2 thuhet se Ministria përkrah bashkëpunimin e shkencëtarëve, pjesëtarë të diasporës së Kosovës, të cilët jetojnë jashtë atdheut dhe forcon bashkëpunimin me projektet kërkimore, institucionale të tyre.

Është shumë me rëndësi të ceket dhe të promovohet edhe një paragraf tjetër ku thuhet se Qeveria u ofron mërgimtarëve informata dhe udhëzime për investimet në Kosovë, lehtësimet fiskale po e përsëris lehtësimet fiskale, kështu që s'ka të bëjë vetëm me organizimin kulturor, po edhe me shtruarjen e njëfarë rruge që ata të investojnë në kapitalin e tyre ekonomik tani përmes rrugëve ligjore dhe përmes lehtësirave që ofron Qeveria e Kosovës me ligjet që janë në fuqi në Kosovë.

Mendoj se të gjitha këto diskutime pro e kontra që u paraqitën këtu nga kolegët tanë deputetë, qoftë nga prizmi me prirje që të shohin se s'është i rregulluar mirë, apo me prirje pozitive që është i rregulluar mirë e kanë një qëllim të njëjtë që të dalë një ligj sa më i mirë që të jenë më të kënaqur edhe mërgimtarët me ligjin edhe ne gjithashtu me bashkëpunimin mes tyre dhe krejt në fund, të nderuar deputetë, më lejoni të bëj një përsëritje të ngrohtë për bashkatdhetarët tanë nga ambientet e Parlamentit të Kosovës. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Deputetja Flora Brovina e ka fjalën, le të përgatitet i fundit, Lutfi Haziri.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Bashkëngjitëm në debat në lidhje me Ligjin për diasporën duke theksuar dhe duke u pajtuar me kolegun tim, Sabri Hamiti se diaspora nuk është pjesa folklorike e kombit tonë, gjithashtu mendoj për një qasje ndryshe. Kam pritur një ligj shumë më

përmbajtësore në lidhje me mërgatën duke marrë parasysh numrin e madh të mërgimtarëve dhe problemet dhe natyrën pse ata janë në mërgim, aq më tepër kontributin e tyre në gjitha kohërat e vështira të Kosovës.

Kujtoj se me këtë projektligj ka qenë dashur të shprehet në mënyrë ligjore interesimi i Qeverisë së Kosovës dhe interesimi i ndërsjellët i mërgatës për Kosovën. Do të përqendrohem konkretisht në disa dobësi të këtij projektligji që thashë që për mua nuk më kënaq, pikë së pari përkufizimet. Në përkufizime ngatërrohet shprehja “mërgimtar” ose “mërgatë” dhe “diasporë”. Kujtoj se te përkufizimet duhet të futet edhe shpjegimi “diasporë” ose të sqarohet mirë edhe “mërgata”, ndoshta pse jo ta pranojmë edhe vërejtjen që e dha kolegu Hydajet Hyseni. Sa i përket nenit tjetër është neni 4, titulli është “Ministria e Diasporës” në të vërtetë do të duhej të ishte “përgjegjësitë e Ministrisë së Diasporës”, sepse tërë neni bën fjalë për përgjegjësitë e Ministrisë së Diasporës.

Neni 6 flet për qendrat kulturore në diasporë dhe natyrisht i numëron vetëm aktivitetet kulturore dhe nuk përqendrohet në interesimet dhe në lëmit tjera që janë në interes të diasporës, e në rend të parë do të kisha thënë interesimi për problemet që i ka diaspora siç janë problemet me legjislacionin, me konventat e caktuara të një shteti, me të cilin duhet të njihet edhe Ministria e Diasporës. P.sh. sigurimet shoqërore, pensionale dhe shëndetësore me qytetarët që janë në mërgim e që nga kjo Ministri do të kërkohej që t’i sugjerojë Qeverisë dhe ministrive përkatëse lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në të mirë të qytetarëve tanë që janë në mërgim.

Konkretisht, ne kemi probleme me disa shtete në mungesë të këtyre konventave, pikërisht njëra nga to besoj pjesërisht të zgjidhet me shtetin e Zvicrës, por kemi problem me Austrinë, kemi problem me shtetet fqinje në region ku punojnë dhe janë mërgimtarë qytetarët tanë, me Gjermaninë, nesër, pasnesër me Francën, me të gjitha shtete dhe pse jo, domethënë, t’i dëgjojmë legjislacionin e tyre, ta bëjmë adaptues me legjislacionin tonë dhe të lidhim konventa. Kujtoj se këtu mungon sektori i informimit të saktë, të përhershëm të mërgimtarëve në lidhje me legjislacionin e Kosovës me mundësinë e investimit dhe mundësinë e kthimit, pse jo. Disa nga fëmijët tanë që rriten atje sigurisht e kanë vështirë të kthehen, sepse tanimë edhe gjuha është harruar për shkak të shkollimit në gjuhën tjetër.

Neni 13, flet për strategjinë përpilimin e strategjisë dhe Ministria e Diasporës i jep vetit komoditet në këto rrethana, jep komoditet që të përpilojë një strategji pas një viti. Kujtoj që kjo ministri e re, me njerëz të rinj, ka mundësi që këtë strategji ta ndërtojë shumë më shpejtë, mbas 3 ose 6 muaj, sepse edhe ashtu është mjaftë aktive dhe tanimë e ka njohur problematikën ose jo të mërgatës sonë. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe diskutuesi i fundit për këtë ligj, deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ligji ka probleme strukturore edhe si i tillë është më mirë të kthehet të ripunohet mbi bazë të rregullave dhe strukturave të brendshme, se sa ta shfuqizojë Ligjin për mërgatë, i cili edhe ashtu një bazë, i cili e trajton këtë problem. Nën 1, nuk kemi të bëjmë me diasporë klasike, por kryesisht në vendet më të mëdha të Evropës dhe në Amerikë, kem të bëjmë me qytetarët tonë që kanë migruar për motive ekonomike ose politike mbi bazë të marrëveshjeve të nënshkruara më herët nga ish-shteti apo mbi bazë të kërkesës së tregut dhe marrëdhënia e tyre ka qenë e rregulluar dhe po ashtu e përfaqësuar.

Kosova po dështon edhe sot t'i përfaqësojë interesat e tyre, sepse e kemi gjeneratën e tretë të njerëzve që jetojnë atje. Gjenerata e parë është gjeneratë që është kthyer e pensionuar apo e ka shtjerrë pjesën e nevojës për të jetuar atje dhe problemi kryesor është për mua mbetet problemi i përfaqësimit. Edhe në këtë rrafsh po ndodh problemi i njëjtë sikurse që po ndodh me shërbimin diplomatik edhe me shërbimin konsullor, të organizuara sipas ligjit atje, por që nuk trajtojnë apo nuk po merren drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit dhe realizimin e këtyre të drejtave, sepse fundja Qendra Kulturore nëse është e nevojshme për shqiptarët me origjinë në Turqi, nuk domethënë që është diçka që lidhet drejtpërdrejtë me kërkesat e shqiptarëve në Zvicër ose në Gjermani ose në Norvegji.

Dhe, si organizimi i takon Ministrisë së Kulturës e jo ministrive tjera që janë themeluar apo janë në veprim në kuadër të Kabinetit qeveritar. Trajtimi dhe përfaqësimi i këtyre të drejtave nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe shtetit tonë, do të duhej të marrë krejt një drejtim tjetër, sepse është , apo është një komunitet i madh, tashmë i pranuar atje me ndikim dhe kurrfarë garancioni tjetër ne nuk mund t'i ofrojmë pos t'i përfaqësojmë drejtë, t'i ndihmojmë në organizimin, sepse edhe ashtu ata kanë shoqata kulturore, ata kanë shoqata kulturore që 30 vjet që jetojnë atje. Kanë organizuar veten, kanë edhe organizim politik, kanë edhe organizim krejt tjetër, por ne nuk mund t'i atraktojmë ndryshe pos t'i trajtojmë barabartë sikurse çdo qytetarë të Kosovës.

Trajtimi i barabartë edhe i atyre ku jetojnë atje dhe kujdesi për ta bën me dije që ata janë të sigurt dhe ndiejnë siguri nga ana e shtetit të vet, sepse ata që kanë ditur të bëjnë kapital dhe ta ruajnë atë kapital në një vend evropian ose në Amerikë, nuk janë të padijshëm që të vijnë e të investojnë aty ku ka pasiguri çfarë është Kosova edhe nuk vijnë, askush nuk vjen me trajtua. Të mos harrojmë se remitencat po vazhdojnë të vijnë në masë të madhe dhe kanë ndikim në jetën sociale. Paqja sociale është falë këtyre njerëzve që po vazhdojnë të jenë solidar jo vetëm me familje, por me të afërmit dhe bashkëqytetarët e tyre në Kosovë.

I nderuari kryetar,

Mendoj që më së miri është me nxjerr këtë ligj me e kthyer mbrapa e me ripunuar edhe njëherë dhe me i trajtuar njerëzit e tonë njëjtë me ligj, mos me i dalluar, mos me i diferencuar, sepse ky nuk është diskriminim pozitiv. Kjo është një organizim sa për të thënë që Ministria e Diasporës ka filluar me funksionuar po bën diçka, a në fakt vetëm po qon konfuzion atje, po qon konfuzion të madh te ata njerëz, sepse fundja nuk janë ata njerëz që ne i kemi trajtuar shpeshherë prej këtuhi, ata janë njerëz që janë të organizuar me dekada në shtetet përkatëse, kanë aktivitet kulturor, kanë ditur ta organizojnë edhe

ta mbajnë aftësimin paralel edhe organizimin politik edhe krejt organizimet. Atëherë, Qeveria e ka obligim me i trajtuar çfarë janë edhe qysh janë dhe t' i përfaqësojë në Qeveri, sepse përfaqësimi i shqiptarëve në shtetet përkatëse është 0. Ata nuk janë të përfaqësuar as në Këshillin e Komiteteve, qofshin ata si të drejtë e punës apo drejtave tjera, as nivele komunale, shumicën e rasteve. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Nejse Lutë, a e kthejmë a se kthejmë ligjin varet prej votimit të deputetëve, por unë mendoj që ka mundësi të përmirësohet ligji sa i përket asaj trajtime të barabartë nuk di a pranojnë ata të mërgatës për t' u trajtuar barabartë me neve? Megjithatë, përkujdesjen institucionale të kemi sigurisht. Po unë pajtohem me ata që duhet ta kemi një ligj më të mirë dhe unë mendoj që komisionet duhet të punojnë në këtë drejtim.

Nuk e di sa janë ekonomike dhe e përballueshme për buxhetin e Kosovës ato qendra kulturore dhe unë mendoj që ambasadat që i kemi në ato vende edhe i kemi në shumicën e vendeve, mund ta kryejmë shumë mirë punën në bashkëpunim me komunitetin që e kemi atje. Ne duhet të kërkojmë që ai komuniteti ynë atje të jetë i organizuar si komunitet. Ne duhet të kërkojmë një integrim të gjithanshëm të atij komuniteti në vendet ku ata jetojnë dhe punojnë, natyrisht duke e ruajtur identitetin e tyre edhe kombëtar.

Çështje tjetër është mendoj se gjatë gjithë këtyre viteve, gjatë gjithë po e cek, gjatë gjithë këtyre viteve në mënyrë institucionale, ndoshta kemi pasur në fillim pengesa nga të tjerët, kemi pasur pengesa në krijimin e mundësive për të bashkuar bashkëkombësit tanë, kapitalin dhe për të investuar në Kosovë dhe nuk kanë pasur lehtësi dhe bile- bile janë detyruar të investojnë në vendet e ndryshme të botës më lehtë se sa në Kosovë. Dhe, në këtë rrafsh nuk ka pas nevojë të jetë Ministria e Diasporës, po Qeveria me segmentet që i ka të financave, të ekonomisë, të arsimit, të punëve të brendshme dhe punëve të jashtme ka mund ta ketë një përkujdesje shumë më të madhe se sa që e kemi.

Prandaj, unë megjithatë po mendoj që ne e kemi marrë një ligj dhe shumica juaj ishin dakord të miratohet në parim dhe unë mendoj që ky ligj mund të përmirësohet dhe mund të ndihmojmë jo aq shumë në vendet ku jetojnë dhe punojnë edhe për një fakt tjetër. Ju e dini se Kosova ka probleme me integrimin e saj në vendet e BE-së për shumë arsye edhe politike që s'varen shumë prej neve, prandaj një përkujdesje të veçantë duhet të kërkojmë nga ambasadat tona dhe njerëzit që i dërgojmë atje që vërtet, me vendet ku janë ambasadat të bëjnë diçka më shumë për liritë dhe të drejtat e komunitetit tonë në ato vende, sidomos në sferën e pensioneve dhe të drejtat që duhet t' i gëzojnë të drejtat sociale që duhet t' i gëzojnë në këto vendet që janë.

Realisht, ndoshta është ajo mungesa e traditës sonë politike e sidomos në mënyrë të veçantë diplomatike, por ne duhet të përpiqemi dalëngadalë të jemi, t' i ndihmojmë dhe sigurisht ne vlerësojmë kontributin e diasporës. Secili prej nesh në një formë ose në tjetër ka pasur një anëtar dhe ndoshta ka edhe sot anëtarë në mërgatë, sigurisht që këto lidhje nuk janë shkëputur dhe nuk duhet të shkëputen, por duhet të krijohen mundësi, ndoshta më të mëdha për t' u bashkuar mërgimtarët tanë, për të bashkuar kapitalin dhe atë kapital për ta investuar në Kosovë dhe në këtë rast me u krijuar lehtësi dhe unë mendoj edhe

njëherë po e cek gjatë këtyre viteve bashkëkombëseve tanë nuk u kemi krijuar lehtësi ekonomike. Ndoshta i kemi krijuar lehtësi ekonomike të tjerëve që se kemi ditur prejardhjen e mjeteve të tyre financiare, por bashkëkombësit tanë vërtetë nuk e kemi gjetur, nuk e kemi pasur gatishmërinë për t'i ndihmuar në këtë rrafsh.

Megjithatë, fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Regjistrimi i fundit i popullsisë, përkundër një numri të madh të defekteve dhe tendencave jo të mira, ka treguar që mërgata nga Kosova, është shumë më e madhe se sa që është menduar. Ka treguar që pothuajse çdo i treti qytetar i Kosovës e posaçërisht çdo i treti shqiptar, jeton jashtë Kosovës.

Mërgata e përbën një faktor të rëndësishëm jo vetëm kulturor, por edhe ekonomik për zhvillimin e vendit. Mërgata i sjell mbi 500 milionë euro në Kosovë për çdo vit dhe në vitet e '70 dhe '80 e dimë që mërgata i ka strehuar dhe i ka ndihmuar veprimtarë të ndryshëm politikë, ilegal dhe gjysmë ilegal që persekutoheshin nga Jugosllavia e Serbia. Kurse, në vitet e '90 mërgata e ka siguruar mbijetesën dhe rezistencën e shoqërisë së Kosovës përballë apartheidit që e pat instaluar Serbia prej arsimit të fëmijëve e deri te politika. Mandej në fund të '90-ve mërgata e pat mundësuar luftën çlirimtare përmes mjeteve të shumta të grumbulluara me ç' rast edhe shumë mërgimtarë shqiptarë u kthyen në atdhe për t'u inkuadruar në luftë për çlirim.

Pas luftës, mërgata jonë është shndërruar në kushtin e paqes sociale në Kosovën e varfër e të përfshirë nga papunësia masive. Pra, ajo që dikur ka qenë mundësia për luftë çlirimtare, sot është kushti për paqe sociale. Dhe, Qeveria aktuale po mundohet që të tregohet falënderuese dhe të sillet mirë së pari nëpërmjet formimit të kësaj Ministrie për Diasporë që jam dakord se e ka emrin e gabuar, duhet të jetë “për mërgatë”, sepse edhe në ligj thuhet “mërgimtarët” meqë i quajmë pjesëtarët e diasporës “mërgimtarë” pse të mos i themi tërësisë së tyre “mërgatë”.

Por, është e qartë që me këtë Ministri dhe më pastaj me këtë ligj, jemi tepër shumë larg dhe jo vetëm kaq, jemi edhe në kahe të gabuar. Fushëveprimi i projektligjit sipas memorandumit shpjegues thotë që ky projektligj ka për qëllim ruajtjen e identitetit dhe zhvillimin e kulturës së diasporës. Mendoj që neve nuk na intereson ruajtja e identitetit dhe zhvillimit të kulturës së diasporës si diasporë, por të kulturës së popullit tonë dhe bashkatdhetarëve tanë, sepse thua se duam ta betonojmë diasporën atje ku është, disi ndarash prej nesh. Dhe, ajo që është mendoj skandaloze, është arsyetimi për projektligjin, thuhet që “arsyeja për hartimin e këtij projektligji vjen si kërkesë e krijimit të rregullave bazë për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Diasporës”. Pra, kjo tregon që ky ligj s'është aty për diasporën, por për Ministrinë e Diasporës dhe vetë arsyetimi e thotë shumë qartë dhe hapur këtë gjë.

Pra, është vetë preferencial, i dedikohet vetvetes, Ministria, me këtë rast. Kur kemi parasysh që thuhet se më vonë do të bëhet strategjia për diasporën, kjo e konfirmon edhe njëherë këtë rendin e mbrapsht të gjërave. Kishim një zyrtar që duhej t'i gjendej një

ministri, u shpik ministria dhe u gjet resori, funksioni i asaj ministrie, më pastaj tash duhet edhe një ligj për atë ministrinë e në fund e bëjmë edhe eventualisht një strategji. Në vend se të jetë saktësisht e kundërta. Ne duam të bëjmë diçka dhe në bazë të atij vullneti të asaj se çfarë ne duam e përpilojmë një strategji dhe kjo strategji na imponon pastaj edhe ligjin edhe Ministrinë përkatëse dhe në fund e gjejmë edhe emrin e përveçëm i cili është më i përshtatshmi për resor.

Ndërkaq, këtu është saktësisht e kundërta sa i përket renditjes së hapave. Përgjithësisht ligji është shumë i thatë dhe i përgjithshëm dhe me përplot zotime të vagullta. Përpilon, propozon, ndihmon, promovon, ndihmon prapë, harton, domethënë, koordinon, përgatit, mbikëqyr, përplot këso shprehjesh të cilat duket që thonë gjithçka, por në fakt nuk thonë asgjë. Në nenin 4, pika 1.15. thotë që “kjo ministri raporton çdo vit Qeverisë për veprimtarinë e Ministrisë”. Kjo është tepër pak, tepër rrallë. Më tutje është interesante qysh në këtë ligj thuhet përkrahja e nenit 9: “përkrahja për mësimin dhe avancimin e gjuhëve zyrtare të Kosovës”, kjo do të shkaktojë përçarjen, ndarje të mëtutjeshme.

Prandaj, unë do të kisha kërkuar nga Qeveria e Kosovës që mos t’ia qojë mërgatës sonë planin e Ahtisarit. Pra, mos ia qoni Ahtisarin mërgatës tonë, lëni Ahtisarin nëpër zyrat e Qeverisë, mos e qoni te mërgata jonë, mbajeni aty ku e keni sajuar e pranuar. Mandej, është evidente qysh qasja e atyre që e kanë shkruar këtë projektligj, është super konservatore, është disi t’i mbrojmë mërgatën tonë të mos asimilohen. Pra, kjo qasje super konservatore është, do t’i kontribuoj ndrydhjes, ruajtjes, ngufatjes ku mbijetesa dhe shpëtimi është maksimumi i ambicies sonë.

Ata janë njerëz që tashmë janë integruar në ato shoqëri, kanë pozita të rëndësishme nëpër universitete, nëpër ndërmarrje e kështu me radhë dhe ata do të duhej të shihen si njerëz aktiv në ato shoqëri e pse jo të ndihmohet avancimi, organizimi dhe integrimi i mëtutjeshëm i tyre jo vetëm shoqëror, po edhe politik. Në këtë kuptim kemi nevojë për më shumë një Institut të Mërgatës sonë që do të bënte analiza le të themi socio-kulturore, qoftë për gjendjen aktuale të mërgatës, por edhe për trendët ekzistuese atje. Nuk mendoj që ne duhet të kemi Ligj për diasporën ndaras prej Shqipërisë. Gjithë shqiptarët jo vetëm të Kosovës dhe Shqipërisë, por edhe të Malit të Zi, të Luginës së Preshevës e të Maqedonisë kudo që janë: në Zvicër, në Gjermani, në Evropën Perëndimore, në përgjithësi, por deri në SHBA dhe në Australi, shihen prej vendeve mikpritëse si shqiptarë.

Pra, ata janë bashkë atje, le të mos i ndajmë prej këtu. Nëse këtu jemi të ndarë padrejtësisht në Ballkan, pse ne po e ndajmë mërgatën atje kur ata janë bashkë madje edhe prej vendeve, prej shteteve mikpritëse shihen bashkë, shihen të gjithë njësoj, pra si shqiptarë. Dhe sërish po përsëritët ajo si me thënë mënyra për mendimin tim shumë e gabuar e Qeverisë ku projektligjet që na i sjell Qeveria e Kosovës, këtu në Kuvendin e Kosovës, janë përplot me themelime të reja të këshillave, të komisioneve, të qendrave, të organizatave të ndryshme të cilat ndihmojnë, koordinojnë, shërbejnë etj, etj. - pra a thua se po presim që të krijojmë organe dhe entitete të reja në mënyrë që të na lind vullneti pastaj. Mirëpo, vullneti duhet të jetë pikënisja, pra, nëse s’ke vullnet për një çështje kot sajton komisione se Komisioni s’ta prodhon vullnetin.

Pra, vullneti ajo çfarë ti donë të realizosh duhet të jetë në fillim e më pastaj për të rritur efikasitetin, për ta mbajtur ligjshmërinë dhe për ta siguruar qëndrueshmërinë, krijon organe të ndryshme kompetente të cilat e shpijnë një çështje përpara, e cila siç thashë edhe niset edhe bartet prej vullnetit. Dhe, së fundi, pra duke pasur parasysh të gjitha këto që i thashë, besoj që ky ligj, ky projektligj duhet t'i kthehet prapa Qeverisë, për shkak se mërgata jonë meriton më shumë dhe më mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë diskutimet janë harxhuar. Rekomandimin e Komisionit e kemi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Në sallë prezentë janë 74 deputetë dhe votojmë tash.

Me 49 vota “për”, 17 vota “kundër”, 7 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Diasporën e Kosovës.

Kërkohej nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqet raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e 15 të rendi të ditës-

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bibliotekat në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zotin Memli Krasniqi që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MEMLI KRASNIQI: I nderuar, kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të rregullimit të veprimtarisë së bibliotekave në përputhje me nevojat nga evoluimi i fushës së bibliotekarisë të standardeve për veprimtari më funksionale të bibliotekave, para nesh kemi për shqyrtim Projektligjin për bibliotekat.

Ky projektligj i ri vjen si nevojë e kohës për avancimin e kornizës ligjore për rregullimin e fushës së bibliotekarisë dhe është në përputhje të plotë me përkushtimin institucional për standardizimin e bibliotekave në Republikën e Kosovës. Projektligji për bibliotekat rregullon: parimet dhe normat themelore të veprimtarisë bibliotekare dhe të organizimit dhe funksionimit të bibliotekave, llojet e bibliotekave, veprimtarinë e tyre, strukturën, organizimin dhe financimin e bibliotekave, ndarjen e Bibliotekës Kombëtare Universitare të Kosovës në Bibliotekën Kombëtare dhe në Bibliotekën Universitare, funksionet dhe

përgjegjësitë e bibliotekave, zhvillimin dhe përpunimin e koleksioneve, si dhe rrjetin bibliotekar të Kosovës.

Projektligji është në përputhje të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe në përputhje me rezolutat përkatëse për librin dhe bibliotekat.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe nevojën e avancimit të infrastrukturës ligjore të kësaj fushe në Kosovë, kërkojmë nga ju që ta miratoni këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të kryetarit të Komisionit për Arsim, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media , deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Prapë unë në emër të Komisionit do të paraqes raportin me rekomandime. Ne si Komision funksional e kemi shqyrtuar Projektligjin për bibliotekat në Republikën e Kosovës dhe me këtë rast kemi vlerësuar se ky projektligj është konform Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i rekomandojmë këtij Kuvendi për miratim në parim.

Dhe, prapë si komision jemi të hapur të pranojmë sugjerimet dhe rekomandimet e deputetëve dhe grupeve parlamentare edhe amendamente që ky projektligj të jetë i plotë dhe i zbatueshëm.

Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Radha e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Në emër të GP të Partisë Demokratike deputetja Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Edhe pse kemi humbur pak energjinë, unë shprehi keqardhjen që një projektligj i cili është dashur ndoshta të trajtohet në fillim të rendit të ditës, po trajtohet në fund, kudo në Evropë dhe në vende dhe në rajon, bibliotekat kombëtare janë institucionet më të larta kulturore, ndërsa ne sot po e trajtojmë në fund.

Sidoqoftë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar Projektligjin për bibliotekat në Republikën e Kosovës dhe po e mirëpret, pra aprovimin në parim dhe shqyrtimin e tij, duke iu gëzuar faktit që sot kemi mundësinë të bëjmë një ligj më funksional, i cili do të bëhet më në fund i implementueshëm në praktikë. Ligji është pajtueshmëri me legjislacionin evropian dhe ky është një obligim i yni, por unë kam vërejtjen që Ligji për bibliotekat, besoj që ka mundur të jetë më i mirë një model nëse do të merrej nga modeli i shtetit shqiptar. Pra, kemi mundësi së paku në sferën letrare dhe të

mediave, të artit dhe të kulturës që t'i ambientojmë shumë më lehtë ligjet kur vijnë edhe nga Shqipëria, pse jo.

Bibliotekat kombëtare, pra është dashur të trajtohen si në nivelin e agjencioneve shtetërore dhe si anëtare e Komisionit funksional, konsideroj që në disa përkufizime të tij ka pjesë të cilat nuk janë të zbatueshme, por kemi mundësi që t'i rregullojmë në mes të fushëveprimeve dhe përkufizimeve brenda ligjit, pra mund t'i harmonizojmë dhe nuk ka nevojë që t'i përsëritim gabimet nga ligji i më parë i vitit 2003. P.sh. vërejtja ime të neni 4, të kushtet dhe kriteret për themelimin e bibliotekave komunale, konsideroj që nuk ka nevojë që t'i jepet roli i asociacioneve pasi që janë asamblatë komunale ato të cilat duhet të marrin vendime për themelimin e bibliotekave, jo asociacioni i komunave, pra.

Në projektligjin që po shqyrtojmë parashihet edhe njëherë sikur në ligjin e kaluar, themelimi, ndarja e dy bibliotekave të veçanta, pra në këtë kuadër Biblioteka Kombëtare të ndahet nga Biblioteka Universitare dhe mos të jetë si tani e bashkuar, por nëse me të vërtetë nuk ndodh edhe njëherë në praktikë atëherë nuk e di pse çka ka pasur nevojë të përsëritet, por unë besoj dhe shpresoj që ministri aktual më në fund do ta realizojë këtë në praktikë e jo të mbetet vetëm në projektligj. Bibliotekat kombëtare kudo në botë e kryejnë funksionin e bibliotekave shtetërore dhe së bashku me Arkivin Kombëtar janë institucionet më të larta kulturore të një shteti. Këtu mendova që edhe Biblioteka jonë Kombëtare të trajtohet si bibliotekë shtetërore, pra siç janë edhe bibliotekat tjera në rajon.

Mendoj që këshillat drejtuese nëpër biblioteka në nivele komunale dhe regjionale nuk kanë nevojë të jenë në projektligj, pasi që ka stafe shumë të vogla dhe nuk mendoj që duhet të harxhohet buxheti në pagesat ndaj anëtarëve të këshillave, mirëpo të pasurohet fondi i librave nëpër biblioteka që realisht është shumë i vogël.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës, konsideroj që duhet të jetë një institucion i pavarur që do t'i udhëhiqte bibliotekat publike të Kosovës, pra: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Gjiilan, Ferizaj dhe këtu konsideroj që është mirë që ndoshta të përdoret edhe modeli siç është Arkiva Shtetërore e Republikës së Kosovës. Konsideroj që po ashtu Biblioteka Universitare duhet të jetë sesion i pavarur që do të udhëhiqte të gjitha bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës.

Bibliotekat publike me ligjin e vitit 2003 janë quajtur biblioteka ndër komunale dhe këtu besoj që kemi mundësi që edhe këto biblioteka t'i bëjmë që të jenë të pavarura dhe jo të jenë në kuadër të drejtorive për arsim dhe kulturë nëpër komuna. Po ashtu, si deputete kam një propozim, në Kosovë, pra në funksionim të bibliotekave në përgjithësi ka mbi 600 punonjës, të cilët nuk kanë shkollim adekuat në këtë drejtim. Pasi që ende nuk kemi një shkollim të mesëm ose të lartë në drejtimin e bibliotekarisë, konsideroj që mundet Universiteti i Prishtinës që të fillojë dhe të planifikojë studime në drejtimin e bibliotekarisë, por edhe të arkivave.

Konsideroj po ashtu që me angazhimet tona shtesë mund ta bëjmë një ligj më të implementueshëm se që ishte më parë. Grupi ynë parlamentar do të votojë "pro". Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka qëndrimet e saja në lidhje me këtë. Në këtë projektligj unë shoh 2 qasje: qasja e rregullimit të bibliotekave, pra në nivelin nacional që unë mendoj që projektligji ia ka dalë dhe mendoj se e ka avancuar punën, gjegjësisht mbështetjen bibliotekave qendrore si asaj kombëtare, por edhe atyre të niveleve arsimore dhe shkencore.

Dhe, pjesa tjetër qasja e dytë, bëhet fjalë për bibliotekat jo nacionale ose t'i quajmë komunale, afër 20 biblioteka dhe unë shoh këtu se është një problem. Nga dashja që të krijohet një model i funksionimit të një biblioteke, pra nacionale dhe ajo të shërbejë për këto komunale, është futur në një propozim jo racional, sepse 20 biblioteka komunale tash t'u shtohet një këshill atje dhe të paguhet aty 5 veta është jo nacionalitet dhe është e panevojshme, ndërsa e përshëndes modelin që bibliotekat të faktorizohen, të jenë drejtpërdrejtë të lidhura me institucionin e kryetarit, por mundësisht të kenë edhe nën kod është një avancim i organizimit të bibliotekave. Por, që domosdoshmërisht t'u parashikohet me ligj, këshilla bibliotekave që do të paguajnë 5 vetë ta formojnë një këshill rreth drejtorit, unë mendoj se për nivelin lokal është plotësisht e panevojshme dhe ndoshta më mirë aq mjete ish dashur t'i jepen bibliotekës për ta modernizuar, për t'i krijuar kushte se sa për të kaluar në paga të këtyre këshillave. Mendoj që është jo racionale.

Çështja tjetër neni 10, tek pjesa domethënë drejtori i bibliotekës duhet të jetë nga profili i bibliotekarisë ose fushat e përafërta, meqenëse nuk ka shumë, është mirë për t' i emëruar këto 3-4 fusha të përafërta, sepse duke marrë parasysh që nëpër biblioteka mirë të pajisura, literatura është e gjitha fushave, mund të jetë pastaj interpretim i vullnetshëm se secili kuadër mund të jetë i përafërt me literaturën që është në bibliotekë. Por, kryesisht deri tash ka qenë praktikë që përveç profesionit bibliotekar kanë qenë gjuhët, profesorë të gjuhës dhe të tjera, sociologjisë etj, prandaj jam i thartur që kjo të përshkruhet në mënyrë recidive, që të mos lihet vend që ai të interpretohet sipas vullnetit më tutje. Dhe çështja e dytë është tek mandati i drejtorit 4 vjeçar duke e ditur se ai do të jetë shërbyes civil dhe profesional, nuk shoh ndonjë arsye se edhe është rasti i parë nga të gjithë drejtoritë që i kemi do të thotë që ne e kufizojmë me mandatë 1 ose 2 vjeçar.

Nuk shoh arsye dhe s'di çka përfitohet këtu, meqenëse është shërbyes civil dhe profesionist, unë mendoj se është e padrejtë për t'u kufizuar ky mandat. Mirëpo, eventualisht, në mungesë të mjeteve nuk është paraparë, por do të kishim dëshiruar që Ministria e Kulturës, ta ketë një fond, pikërisht duke e parë rëndësinë dhe gjithë atë lidhje dhe obligimin që e kanë lidhja e bibliotekave komunale deri edhe në gjobë në rast se nuk bashkëpunon, por duhet të jetë edhe një përgjegjësi edhe mbështetje e Ministrisë që të mund ta rregullojë mirë këtë fushë, sidomos kur dihet që përveç leximeve të zakonshme tash nëpër biblioteka kemi rastin kur edhe studiojnë studentët, duhet të jetë

pra një qasje edhe digjitale ku ata do të mund të hynë nëpër biblioteka edhe arkiva të zhvilluara të vendeve tjera.

Pastaj, po aq sa është interes që të merret një libër në bibliotekë po aq të rëndësishme po janë sallat e leximit që nëpër disa biblioteka nuk po kanë vend as ku të ulën të interesuarit. Prandaj, gjithë kjo mbështetet në aspektin e digjitalizimit, ngritjes së kapaciteteve që është e paraparë që të jetë një departament, pra në kuadër të Bibliotekës Kombëtare apo Ministrisë që do të vazhdojë vazhdimisht në trajnime dhe aftësi, në ngritje të kapaciteteve dhe afrimin e qasjes moderne dhe fjalës së fundit të organizimeve, por njëkohësisht do të kishim dëshiruar që të jetë një mbikëqyrje në aspektin e vullnetit të mirë që duhet t’ju ofrohet bibliotekave komunale, në aspektin e modernizimeve dhe krijimit të kushteve në sallat e leximit, ta ushtrojë ndikimin e vetë edhe eventualisht të trokas nëpër donacione, por edhe pse jo ... fonde të Ministrisë.

Prandaj, unë mendoj se në tërësi nëse arrijmë që këto dy çështje t’i rregullojmë, pra që organizimi i Bibliotekës Kombëtare, të mos jetë kopje për bibliotekat komunale, sepse nuk e kanë atë rëndësi dhe është ngarkesë e madhe 20 biblioteka komunale ka 5 në borde, de fakto janë, ka kosto financiare, unë mendoj se pjesa tjetër e ligjit mund të pasurohet dhe të bëhet një ligj mirë i përdorshëm dhe t’i kontribuoj kësaj fushe.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes” e ka fjalën deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe lëvizja “Vetëvendosje” ka shqyrtuar Projektligjin për bibliotekat. Ne si lëvizje kemi disa vërejtje ndaj këtij projektligji, natyrisht këto vërejtje përfshinë disa gabime gjuhësore që po i përmban ky projektligj, por edhe të një pjesë të strukturës përmbajtësore të tij.

Shumë nga vërejtjet u thanë edhe nga parafolësit, për të kursyer kohën e deputetëve unë nuk do të fokusohem tash në të njëjtat vërejtje, por do të specifikohem në 2-3 që i konsideroj më brengosëse. P.sh. në këtë projektligj vërehet një tendencë e qartë për t’u shtuar njëfarë lloj kontrolli politik dhe institucional qeveritar ndaj këtyre institucioneve. Bie fjala sipas nenit 7 të këtij projektligji që rregullon Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, paragrafi 2 thuhet se në përbërje të këshillit hynë ministri i Kulturës si kryetar i Këshillit, kurse përfaqësues të institucioneve tjera që ndërlidhen me punën e bibliotekave janë vetëm anëtarë.

Dhe, po t’i referohemi ligjit aktual që është ende në fuqi, neni 14, i cili e rregullon këtë sferë edhe ai e specifikon nevojën që Ministria ta ketë përfaqësuesin e tij në këtë këshill. Por, aty thuhet se Ministria përkatëse për Kulturë e ka vetëm përfaqësuesin e tij dhe nuk e specifikon se në mënyrë të domosdoshme duhet që patjetër ministri të jetë kryetar i këtij këshilli. Tendencat e këtilla spikatin po ashtu edhe në pjesën që e kanë të bëjnë me Këshillin drejtues të Bibliotekës Kombëtare, ku ministri i ka kompetencat e plota në emërimin dhe shkarkimin e këtij këshilli.

Këshilli drejtues i bibliotekës thuhet sipas këtij neni, përbëhet nga 5 anëtarë me mandate 4 vjeçar, të cilët duhet të jenë nga fusha e bibliotekarisë, kulturës, arsimit dhe shkencës. Këshillin drejtues të Bibliotekës Kombëtare emëron dhe e shkarkon ministri përkatës për kulturë. Pajtohemi okej nëse i lejohen këto kompetenca ta emërojë, por duhet të specifikohet se mbi çfarë procedure dhe çfarë baze e bën një shkarkim të tillë? Nëse kjo bëhet për një periudhë 4 vjeçare aty këtu kemi të bëjmë me përfundim të mandatit dhe nëse nuk specifikohet kjo, atëherë ne shohim tendencat që të krijohet një hapësirë të lihet një hapësirë që sa herë që këta anëtarë të këtij këshilli drejtues të Bibliotekës, të jenë në mospërputhje po e zëmë me një ministër të caktuar, sot me këtë ministër, nesër me një ministër tjetër, t'i lejohet mundësia që ai ta bëjë shkarkimin kur e konsideron që duhet ta bëjë atë.

Po ashtu, sa i përket këtij projektligji thuhet se parashihet ndarje e Bibliotekës Kombëtare dhe asaj Universitare. Është e ditur se me ligjin aktual specifikohet themeluesi i këtij institucioni, ndërsa në këtë projektligj pas kësaj ndarje mungon themeluesi i këtij institucioni, pra siç dihet ka qenë Kuvendi i Kosovës. Konsideroj, se është e mirë, do të jetë më e shëndetshme dhe më e domosdoshme që të përkufizohet si kategori ligjore dhe themeluesi i këtij institucioni të rëndësishëm të Bibliotekës.

Për fund, ajo që do ta konsideroja si më shqetësuese që ndërlidhet me këtë projektligj, ka të bëjë me nenin 12, paragrafin 7, ku thotë se zbatimi i këtij ligji mund të bëhet varësisht nga situata fiskale dhe buxhetore. Do të isha i pajtimit sikur të thuhej që ndoshta një dispozitë e caktuar ligjore ose një nen të varet nga situata fiskale ose buxhetore, por që krejt ligji në tërësi do të thotë të varet nga këto rrethana objektive, fiskale dhe buxhetore, unë konsideroj se do jetë e dëmshme, sepse krijon një mundësi që të instalohet një logjikë antinomie ndërmjet miratimit formal të ligjeve dhe moszbatimit të tyre. Pra, nëse ministri i Financave thotë okej, ne nuk kemi financa në këtë drejtim, atëherë rrjedhimisht ne nuk do të kemi as ligj për bibliotekat dhe s'do të kemi mundësi që të zbatohet ky ligj i cili rregullon sferën e bibliotekarisë.

Prandaj, nëse korrigjohen këto aspekte ne kësaj here do ta miratojmë këtë projektligj në parim dhe nëse merren parasysh këto gjatë procedimit të mëtutjeshëm, do ta mbështesim këtë projektligj.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Aleancës deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe grupi parlamentar i yni do ta përkrahë në parim këtë projektligj, por kemi disa sugjerime si: e para, ligji si ligj është mirë që po bëhet, ka ndryshime me ligjin e vitit 2003, mirëpo këto ndryshime janë të pamjaftueshme.

Siç shihet krahasuar nga ligji i kaluar, pra janë hequr termet “biblioteka ndër komunale” që kishin kuptimin “biblioteka rajonale”. Pra, nga biblioteka që e përbëjnë 2-3 komuna në një pikë profesionale. Këto ishin 7 rajone ndër komunale, p.sh.: në Bibliotekën rajonale të Gjakovës ishin Deçani dhe Rahoveci, pra janë hequr nga ligji rajoni dhe ju kanë shkarkuar komunave.

Në ligjin e parë thuhej se Ministria e Kulturës është themeluese e bibliotekave ndër komunale, tani nuk përmenden. Tani quhen “komunale” çka donë të thotë minimizohet dhe lirohet Ministria nga obligimet, në këtë rast ngarkohet komuna, por dihet buxheti i komunave sa është. Pra, me një fjalë bie buxheti, bie investimi dhe bie profesionalizmi. Mendoj se ky është një nga dëmet që po i bëhet bibliotekarisë në përgjithësi, sepse puna në biblioteka është edhe edukative dhe vendet edukative duan më shumë buxhet, sepse ka edhe material harxhues siç janë librat për të vegjël dhe aktivitetet tjera. Nga praktikat e së kaluarës, përvojat dy vjeçare dhe teatrot dhe bibliotekat që ishin në kuadër të Ministrisë, tani kemi rënie drastike të profesionalizmit.

Unë nuk e di p.sh. se si është duke mbijetuar Biblioteka e Gjakovës, ngase siç jam në dijeni nuk është bërë asnjë investim gjatë vitit 2011, nuk është blerë asnjë libër në Gjakovë. Gjendja e tillë është edhe në bibliotekat tjera në rajon me sa kam dëgjuar siç janë: Peja, Mitrovica, Prishtina, Ferizaj, Gjiçani e Prizreni. Pastaj, e ngrit në lartësi Bibliotekën Kombëtare, kjo është e mirë, por ajo avancon lart në proporcion me komunat. Bile nga përvoja e deritanishme ata nuk marrin asgjë nga Biblioteka Kombëtare Universitare.

Pra, ligji mbron konjekturat e veprimtarisë, mirë, obligon institucionet, por nuk garanton efikasitet, fjala është për bibliotekat komunale, pra siç janë quajtur më herët “biblioteka rajonale”. Prandaj, konsideroj që ne me disa sugjerime tona do të mundohemi të japim maksimumin që të nxjerrim një ligj më të mirë për bibliotekarin
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përsëhendesim ardhjen e këtij projektligji për shqyrtim në Kuvend. Kësaj fushe i ka munguar legjislacioni gjithëpërfshirës, kështu që Koalicioni për Kosovë të Re, do ta votojë këtë projektligj.

Projektligji është i përgatitur mirë, por ka nevojë për disa përmirësime. Unë nuk dua të ndalem shumë në vërejtjet, sepse disa prej tyre i thanë kolegët këtu siç është vërejtja tek neni 4 për asociacionin e komunave, gjithashtu vërejtje tjetër për këshillin drejtues në nivel komunal që është propozimi të hiqet, si dhe për vërejtjet e tjera. Për këto dhe vërejtjet tjera, ne do të japim kontributin tonë, pra në Komisionin funksional, kështu që në këtë fazë Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah dhe do ta miratojë këtë projektligj.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS deputeti Milivoje Stojonović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala, predsedavajuće!

Poslanička grupa SLS je razmatrala ovaj Nacrt zakona o bibliotekama, kao što i time primetili da zakon određuje osnovna čela i norme delatnosti o Biblioteka, kao i organizovanje i funkcionisanje biblioteka.

Ono šta nam je zapalo za onako, što možemo da komentarišemo, jeste član 4, stav 2, o kome se govorio o uslovima i kriterijumima, kriterijumima za osnivanje i funkcionisanje biblioteka, mislim da bi ovaj član treba izbrisati i razraditi u samom zakonu.

Mnogo bi bilo transparentnije. Dalje, što se tiče člana 7 koji govori i definiše funkcionisanje i sastav nacionalnog saveta biblioteka i član 9 u kome se govori o upravnom savetu biblioteka, mišljenja smo da bi trebalo predvideti i zakonom regulisati učešće predstavnika manjinskih zajednica u ovim organima.

Dalje, što je veoma bitno za funkcionisanje biblioteka i korišćenje fondova biblioteka, vrlo je važno omogućiti digitalizaciju fonda biblioteka, a takođe i napraviti katalog u obliku u elektronskom obliku.

Poslanička Grupa SLS podržaće u Nacrt zakona o Bibliotekama a uočene nedostatke pokušati da otkloni kroz rad u funkcionalnoj i stalne Komisije. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! “6+” s’janë këtu... se di, ju e dini. Vazhdojmë me diskutimet. Fjalën e ka deputetja Lirije majtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër,

Ndoshta po e vëren pak që po ju bëhet me hile ligjeve që vijnë nga fusha juaj se përherë mbesin kështu në orët e vona kur lodhen të gjithë, ndoshta është mirë nganjëherë të kërkojmë një kohë tjetër.

Desha të jap pak kontribut te ky projektligj. Tek neni 16, ku flitet për funksionet dhe detyrat themelore të bibliotekave publike, paragrafi i parë te Biblioteka Kombëtare, përmendet selia në Prishtinë, por nuk përmendet edhe themeluesi, kështu që propozimi im është të jetë themeluesi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe se ajo duhet të mendojë, duhet ta ketë statusin e një institucioni qendror në nivelin e Agjencionit Kombëtar dhe duke u nisur nga opinioni i Departamentit të Buxhetit, te neni 12, paragrafi 7 thuhet: “zbatimi i këtij ligji mund të bëhet varësisht nga situata fiskale dhe buxhetore”, mendoj se këshillat në lidhje me këtë, këshillat drejtuese në nivelet komunale do ta ngarkonin buxhetin dhe nuk do t’i shihet si ndonjë zgjidhje apo ndihmesë në këtë drejtim.

Pata edhe disa çështje, të cilat mendoj se i përmendi me kujdes deputetja Xhevahire dhe do t'ju kisha bashkangjitur atyre, besoj të gjitha këto do ta pasuronin ligjin edhe më tutje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë u tha edhe nga parafolësit, unë kryesisht do të ndalem tek pavarësia e bibliotekave. Dihet mirëfilli që në vitin 2009, sidomos bibliotekat regjionale me kërkesën e komunave kanë qenë të interesuar që këto të barten në nivel komunal, mirëpo edhe pse nga Ministria e Pushteti Lokal në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës janë bartur këto kompetenca, mendoj që në aspektin buxhetor kuvendet komunale nuk e kanë treguar veten dhe njëkohësisht nuk kanë mbështetur aktivitetet të cilat i kanë paraparë bibliotekat regjionale që të zhvillojnë në komunitet e tyre.

Atë që e tha edhe parafolësja, zonja Lirie Kajtazi do të isha pajtuar që Biblioteka Kombëtare, meqë është institucion shumë i rëndësishëm edhe vetë fjala “kombëtare” tregon për një institucion të rëndësishëm, ky institucion kish qenë mirë që të jetë një agjenci e krijuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dihet mirëfilli që ne deri më tani në shumë ligje të cilat i kemi aprovuar kemi krijuar shumë agjencione dhe kjo do të thotë që është i papërbalueshëm për buxhetin e Republikës së Kosovës, por mendoj që ishin ngrit nivelet më të mira dhe njëkohësisht ishin zhvilluar aktivitetet më të mira se dihet mirëfilli në këtë 10 vjetshin e fundit Biblioteka Kombëtare nuk është mbështetur nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Por, njëkohësisht do të thotë krejt aktivitetet deri më tani të cilat i ka treguar edhe i ka dëshmuar Biblioteka Kombëtare i ka zhvilluar përmes donacioneve.

Prandaj, meqë është paraparë një ligj i tillë, meqë është paraparë që sponzorizues të jetë Ministria e Kulturës do të ishte mirë, sepse edhe në Deklaratën Financiare është paraqitur do të thotë nga Buxheti i Republikës së Kosovës nuk ka mundësi të ndahet buxhet shtesë për zbatimin e këtij ligji. Unë e kam thënë edhe për ligjet tjera po e them edhe për këtë ligj, nuk është mirë që të hartojmë ligje të tilla të cilat nuk kanë zbatueshmëri ose të cilat nuk kanë implementim të këtyre viteve, por duhet të harmonizohen me deklaratat financiare për tu implementuar.

Tek neni 7, është një çështje për të cilën është i krijuar bordi ku thuhet se në kuadër të këtij bordi kryetari i bordit do të jetë ministri. Besoj që do të ishte mirë që përfaqësuesi të jetë nga Ministria, ndërsa të mos përzihet me postet politike edhe njëkohësisht kërkoj një përfaqësim të Shoqatave të Botuesve të Kosovës të jenë anëtarë të këtij bordi. Besoj që dhe Komisioni në kuadër të

LDK-së do të jep kontributin e vet. mirëpo disa nene të cilat kanë mangësi edhe në kuptimin e fjalës dhe po ashtu edhe në aspektet e vendimmarrjes, do të ishte mirë që gjatë

leximit të dytë të harmonizohen dhe njëkohësisht të dalë një ligj më i mirë se sa që është deri më tani.

Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari kryetar i Kuvendit,

Edhe unë dëshiroj që të tërheq vëmendjen tuaj lidhur me nevojën, që në mënyrë më të qartë dhe në nivel më adekuat të përkufizohet Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Dihet se Biblioteka Kombëtare e Kosovës është e themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe mendoj se edhe më tutje duhet ta ruajë statusin e një institucioni nacional, i cili do të ketë një vend të spikatur në, pra një institucioni me rëndësi nacionale, që ka vend të spikatur në grupin e vendeve edhe institucioneve nacionale.

Më mirë është ta jepni m një pauzë, se sa mos të dëgjohemi!

Pra unë po pledoj, që Biblioteka Kombëtare...

KRYETARI: Pauzën e jap unë.

MUHAMET MUSTAFA: Po, veç po propozoj kryetar, të lutem të na krijoni kushte për punë.

KRYETARI: Të lutem!

MUHAMET MUSTAFA: Po edhe unë po të lutem ty të na krijosh kushte për punë, po.

KRYETARI: Kryetari i Komisioni debatin duhet ta zhvillojë gjatë dy javëve, kur vijnë ligjet në Kuvend dhe pastaj këtu grupet parlamentare deklarohen për miratim ose jo. Urdhëro e ke fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Mirë, mirë... deklarohemi, por... ta përfundojmë diskutimin edhe të kemi kushte për diskutim, se këtu po flasim për një institucion tejet serioz. Prandaj, të vazhdojmë.

Mendoj se kjo pozitë e Bibliotekës Kombëtare duhet të mbetet në tërësi e ruajtur në tekstin dhe në frymën e ligjit. Prandaj, Biblioteka Kombëtare duhet të jetë e veçuar si një institucion, të ketë lidhje me Kuvendin, me Qeverinë dhe me ministrinë përkatëse. Gjithashtu, duhet të shihet se a janë krijuar dhe sa janë krijuar kushtet që të kemi edhe Bibliotekën Kombëtare dhe Bibliotekën Universitare.

Ndoshta, unë sugjeroj, që deri në procedurën e mëtejme të shohim edhe pak a shumë modelin e Bibliotekës Kombëtare kroate.

Ju faleminderit, zoti kryetar!

Siç po e shihni, unë pata një diskutim të shkurtër, por pata vështirësi ta përfundoj dhe ta formuloj, sepse nuk e kam të shkruar.

KRYETARI: Faleminderit!

Prezent kemi 67 deputetë. Po, edhe një herë po kërkoj nga kryetarët e komisioneve. Asnjë ligj nuk vjen në lexim të parë në parim pa kaluar 10 ditë dhe unë mendoj që gjatë kësaj kohe, Komisioni duhet të organizojë debat të gjallë në mes anëtarëve të Komisionit dhe pastaj realisht, rekomandimet e Komisionit, kur të vijnë në seancë, grupet parlamentare, duhet të mbështesin punën e Komisionit. Kjo do të duhej të ishte ecuria e punës së komisioneve. Edhe neve do të na lehtësonit sot më shumë punën. Prandaj janë formuar komisionet, që në mënyrë profesionale të diskutojnë në komisione.

Lus deputetët dhe regjinë, që të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, një abstenim Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për bibliotekat në Republikën e Kosovës. Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Prezentë ishin 67 veta, edhe një herë po e cek.

Pika e fundit e rendit të ditës.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për teatrot

Në bazë të nenit 56 të rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, zotin Memli Krasniqi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër e ke fjalën!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Sot para nesh kemi në shqyrtim njërin nga projektligjet më të rëndësishme për komunitetin e artistëve në Kosovë, Projektligjin për teatrot. Ky ligj është një vazhdimësi e punës, që po bëhet për krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e veprimtarisë teatrore në Kosovë dhe paraqet një hap para për përmbushjen e kërkesave të artistëve të teatrit.

Duke pasur parasysh përmbajtjen dhe fushat, që rregullon ky projektligj, miratimi i tij është i një rëndësie të veçantë. Ky projektligj ka për qëllim avancimin e kornizës ligjore për rregullimin e fushës së teatrit dhe është në përputhje të plotë me përkushtimet e institucioneve të Republikës së Kosovës për avancimin e teatrit, për përkrahjen dhe

mbështetjen e vazhdueshme, në mënyrë që të kemi këtë fushë të rregulluar dhe të mbuluar me ligje dhe akte nënligjore të standardeve të kërkuara evropiane.

Projektligji rregullon dhe garanton të drejtën e lirisë krijuese për të gjitha format dhe shprehjet artistike skenike, rregullon: themelimin, organizimin, funksionimin, drejtimin, menaxhimin dhe financimin e teatrove, pozitën e artistëve teatrorë dhe çështje të tjera të rëndësishme për teatrot. Fushëveprimi i këtij ligji përfshinë veprimtarinë teatrore, përgatitjen dhe shfaqjen publike të veprave dramatike dhe të performancave të ndryshme skenike.

Projektligji për teatrot është në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-së dhe është bazuar edhe në praktikat më të mira evropiane, që rregullojnë këtë fushë.

Të nderuar deputetë, duke pasur parasysh rëndësinë dhe nevojën e avancimit të infrastrukturës ligjore për teatrin, ju ftoj që të votoni për miratimin e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Fjala tani është për kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, deputetin Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Edhe këtë projektligj e kemi shqyrtuar në Komisionin funksional dhe shumica e anëtarëve kemi qenë të pajtimit, që ky projektligj të lexohet në parim në seancë plenare dhe i kemi rekomanduar Kuvendit, që ta miratojë në parim.

Të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet edhe amendamentet, qoftë nga grupet parlamentare ose deputetët do t'i marrim parasysh gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit, në mënyrë që ky ligj për leximin e dytë të jetë i kompletuar dhe pastaj i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Xhevahire IzmaKU e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Ne si Grup parlamentar e kemi shqyrtuar edhe Projektligjin për teatrot dhe po ashtu është një projektligj, i cili ka pasur debate të shumta gjatë këtyre viteve dhe është kthyer edhe një herë. Unë konsideroj, që këtë herë projektligji ka shumë përmirësime.

Ne si Grup parlamentar do të votojmë për, ndërsa unë si deputete, personalisht, i kam dy vërejtje, të cilat po ashtu do t'i paraqes edhe në Komision, sigurisht, ndërsa këtu po i ndaj me kolegët e mi deputetë, artdashës.

Është fjala tek neni 7, ku konsideroj te organizimi dhe funksionimi i këshillit drejtues gjatë zgjedhjes dhe përzgjedhjes, ku thuhet që këshilli drejtues do të zgjedhë dy personat

udhëheqës të institucionit më të lartë, pra teatrit. Unë konsideroj, që duhet të jetë vetëm njëri i zgjedhur nga këshilli drejtues dhe ai për mua personalisht, do të ishte e rëndësishme që të jetë udhëheqësi artistik, pra, ai është personi, i cili realisht realizon politika kulturore edhe realizon programin dhe repertorin për gjithë vitin, për shfaqjet, të cilat do të realizohen dhe do të shfaqen para publikut. Ndërsa, drejtori i përgjithshëm mund të jetë një person, i cili ndoshta, nuk është ekskluziv një person, që i takon sferës së artit dhe kulturës, mirëpo ka një vullnet dhe një përgatitje tjetër profesionale.

Gjithashtu, kam edhe një vërejtje, nëse mund të them një rezervë më shumë. Tek çështja e përkufizimit të ansambli rezident, kam një shqetësim ku mendoj që nëse me të vërtetë ansambli rezident i përfshinë tek Teatri Kombëtar përmbi deri në 30 aktorë, kam frikën që dekurajon aktorët e rinj për ndoshta, për 20 vjetët e ardhshme, derisa ata të dalin në pension, kur dihet që repertori, që shfaqet gjatë tërë vitit, nuk është një repertor, i cili përfshinë aktorë, që janë brenda teatrit, por ata duhet të merren, ndoshta me një ... mund të them me shpallje publike, ku ofrohet një dramë apo një shfaqje dhe fiton ai i cili i ka ato vlera dhe merr ata aktorë të cilët mendon se i takojnë asaj shfaqjeje. Ndërsa, brenda teatrit, ne e dimë që kemi edhe aktor që asnjëherë nuk kanë luajtur në asnjë shfaqje, për vite me radhë.

Por, këtu sigurisht nuk kisha dashur me prekë, se është një çështje pak edhe sociale, mirëpo, nëse ka mundësi me u bë një kombinim, atëherë le të jetë një numër më i vogël dhe le t'i jepet përparësi atyre zgjedhjeve, të cilat do të bëhen gjatë vitit dhe atyre... thjesht le të vlerësohet konkurrenca. Pra, këtu është në pyetje që vlerat artistike të ngritën në këtë mënyrë.

Konsideroj po ashtu, që këshilli drejtues i teatrit duhet të jetë një këshill i kombinuar, siç qëndron edhe tek niveli i organizimit të sportet, pasi që këtu kemi mundësi që brenda këshillit të ketë edhe njerëz që i përfshihen sferës së biznesit, ku ka mundësi të ndihmojnë zhvillimin e teatrove.

Nuk do t'i mbetemi borxh edhe teatrove private. Konsideroj që duhet gjatë ligjit të futen disa dispozita, apo disa vërejtje, ku do të përkrahet pak më shumë, pasi që mendoj se i kemi mbet pak borxh teatrove private, t'i përkrahim pak më shumë me këtë ligj.

Ne do të votojmë për dhe do të japim kontributin në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Lirie Kajtazi, e ka fjalën!

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe një herë, i nderuar ministër i Kulturës,

Në projektligjin për teatër, të miratuar nga Qeveria, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i ka vërejtjet e veta serioze, që do t'i përmend në vijim.

Te neni 4, pika 2, ku flitet për themelimin e teatrove publike, domodoshmërisht duhet të shtohet edhe një paragraf, që përcakton saktë se teatrot publike themelohen, nëse paraprakisht janë plotësuar nga themeluesi kushtet: infrastrukture, hapësinore, materiale, teknike, mbi të gjitha kuadri artistik e administrativ dhe kushte të tjera, që duhet të përcaktohen me ligj. Arsyetim se vetëm në këtë mënyrë ligji do të sanksiononte saktë se mbi të cilat parakushte dhe kriteret do të mund të themeloheshin teatrot publike, duke shmangur degradimin e mëtejshëm administrativ dhe artistik të teatrove në Kosovë.

Te neni 5, ku flitet për teatrot publike, është propozuar që teatrot kombëtare të jenë në shumës, pra, disa syresh në gjykimin tonë, ky ligj në të gjitha kaptinat dhe nenet e veta duhet të njohë vetëm një teatër kombëtar, pra, Teatrin Kombëtar të Kosovës. Këtu, si arsyeshmëri, shumësia e teatrove kombëtare në Kosovë, vetëm se do të forconte kompleksin provincial, që promovon gabueshëm idenë se emërtimi si kombëtare e ngrit nivelin e funksionimit dhe cilësinë kreative të një teatri, që e kemi vërejtur edhe në praktikë.

Neni 6, që flet për Teatrin Kombëtar, bie ndesh me nenin 5, i cili teatrot kombëtare i njeh me shumicë dhe jo vetëm një, thashë me këtë ligj s’dihet sa teatro kombëtare ka Kosova, se thuhet aty teatrot, ndërkohë flitet për një teatër kombëtar.

Neni 7. në këtë ligj, është ajo që degradon emërtimin dhe pozicionin e drejtorit artistik, siç është në ligjin aktual në udhëheqës artistik. Ky është një degradim i pozicionit të drejtorit artistik, pa të cilin nuk mund të paramendohet ekzistenca dhe funksionimi i një teatri.

Prandaj, propozojmë që ky nen, në pikën 2.3 të përcaktojë qartë, se çdo teatër publik, ngjashëm me praktikën e teatrove, kudo në botë, duhet të ketë drejtorin artistik e jo udhëheqësin artistik, siç është këtu e shënuar.

Arsyetim- të gjithë teatrot publike në vendet e civilizuar në regjion, në Evropë dhe më gjerë dhe me traditë teatrore, kanë drejtorin artistik me përgjegjësi dhe kompetenca të plota në politikën artistike.

Neni 10, që flet për këshilla drejtuese të teatrove publike në pikën 1.10, thotë: Këshilli drejtues merr vendime me shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve. Shprehja “absolute” shihet krejtësisht e panevojshme dhe e paqëlluar, sepse për vendimmarrje mjafton vota e shumicës së të gjithë anëtarëve.

Te neni 11, pika ku flitet për përbërjen e këshillave drejtuese, kufizohet përbërja me njerëz ekskluzivisht të fushës teatrore. Mendoj, se më mirë do të ishte nëse lihet mundësia, që pjesa e këshillit, në pjesën e këshillit të jenë kritikë, publicistë apo shkrimtarë, të cilët kanë njohuri mbi fushën e teatrit dhe të kulturës në përgjithësi.

Neni 14, që flet për kompetencat e drejtorit të përgjithshëm, në pikën 2, thuhet: Drejtori i përgjithshëm merr pjesë në krijimin e konceptit artistik të teatrit, pa të drejtë i jep kompetencën atij që të përzihet në kompetencat, këtu si shkruan, të udhëheqësit artistik.

Neni 15, ku flitet për përgjegjësitë dhe kompetencat e udhëheqësit artistik, duhet të rishikohet plotësisht, sepse mendojmë se dëmton në themel përgjegjësinë dhe kompetencat e drejtorit artistik, në këtë version, siç thamë të udhëheqësit artistik dhe zhvesh ligjin nga çdo lloj mundësie të garantimit të pavarësisë krijuese artistike, në teatrot publike.

Po ky nen, pika 4, thotë se udhëheqësi artistik udhëheq punën kreative të ansamblit rezident.

Arsyetojmë, me punën kreative udhëheqin krijuesit e teatrit, ata që realizojnë shfaqjen: regjisor, aktorët, skenografi, kostumografi, kompozitori e tjerë, me një fjalë ekipi kreativ i shfaqjes. Udhëheqësi artistik për punën e tij i përgjigjet drejtorit të përgjithshëm dhe këshillit drejtues. Në ligjin ekzistues, që është në fuqi, drejtori artistik i përgjigjet vetëm këshillit drejtues, prandaj ky nen shënon regres dhe është cenim i drejtpërdrejtë i pavarësisë krijuese dhe artistike në teatrot publike, duke bërë përpjekje për të vënë nën kontroll edhe krijimtarinë artistike dhe rrjedhimisht ky nen në këtë formë që është edhe përfundimisht e varros shpresën për krijimtari të pavarur artistike në teatrot publike të Kosovës.

Neni 16, që është titulluar “Aktorët e teatrove publike” duhet të jetë “Ansamblit rezidente të teatrove publike”, sepse edhe vetë pika bie në kundërshtim me emërtimin e këtij neni.

Po ashtu pika 5 e këtij neni, në të cilin thuhet se komisionin e kryeson udhëheqësi artistik apo drejtori i përgjithshëm, aty ku nuk është funksional pozita e udhëheqësit artistik, bie në kundërshtim me nenet tjera, sepse udhëheqësi artistik nuk mund të zëvendësohet prej drejtorit të përgjithshëm, edhe pse ligji nuk njeh teatër publik, pa drejtorin artistik.

Te neni 19, teatrot e pavarura, pika 2, ku thuhet Ministria shpall konkurs publik për financimin e projekteve teatrore të organizmave të evidentuara në atë paragraf, duhet të precizohet qartë, që konkursi për mbështetjen e projekteve të teatrove të pavarura duhet të jetë vjetor dhe i obligueshëm, mendoj në këtë rast te pika 7, ku thuhet “zbatimi i ligjit mund të bëhet varësisht nga situata fiskale dhe buxhetore”, mendoj se ky ligj nuk e obligon ose nuk jep garancione, që Qeveria ose niveli lokal ta zbatojë këtë, prandaj do të ishte mirë që t’u lihet mundësia edhe teatrove publike të qyteteve të jenë ata dhe gëzojnë fondet nga konkursi publik, që shpall Ministria, një praktikë që ka qenë edhe më herët. Sipas kësaj do të ishte, po them, një mundësi më mirë që me i mbajt më mirë artistikisht, ato teatro.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do të japë edhe më tej kontributin e vet gjatë amandamentimit të tij, por mendojmë se një pasurim i veçantë i projektligjit mund të bëhet edhe nga dëgjimet publike, që përmendi edhe kryetari i Komisionit, se tha do të përpiqemi që edhe më tutje ta pasurojmë projektligjin.

LDK do ta votojë me kusht që këto të inkorporohen në ndryshim dhe do ta pasuronin edhe më tutje ligjin.

Faleminderës!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe lëvizja “Vetëvendosje”, e ka analizuar projektligjin për teatrot, që po diskutojmë sot dhe si e tillë ka disa vërejtje shumë serioze ndaj këtij ligji, i cili si po na servohet sot në këtë mënyrë.

Fillimisht, më duhet të them se fatkeqësisht, ky projektligj në shumë çështje substanciale, madje, është edhe më i dobët se ligji aktual që e normativizon jetën teatrore në vend. Pra, në vend se ta rregullojë dhe avancojë edhe më shumë këtë sferë të rëndësishme të sferës kulturore, për më keq ai do ta kaotizojë dhe anarkizojë edhe më shumë. Është më se e qartë se ky ligj është punuar, pra shihet qartë, se është punuar ndoshta nga një grup amatorësh dhe nuk është i artikuluar në mënyrë të duhur dhe si i tillë mund ta burokratizojë jetën teatrore dhe sjell një model të teatrit, i cili është i tejkaluar dhe i cili sot nuk është në përputhje me praktikën ekzistuese në teatrot evropiane.

Pra, unë ju them këtu, ky projektligj nuk është në përputhje me praktikën në teatrot evropiane, pavarësisht, që i referohet Komisioni për Ministrinë e Integritetit Evropian dhe i referohet një deklaratë të këshillit të ministrave, por askund nuk merr shembuj, për shembull, për mënyrën se si funksionojnë teatrot në vend të ndryshme të Bashkimit Evropian.

Fillimisht, më duhet të them se teatri është një institucion artistik. Ndërkaq, përmes këtij projektligji rrënohet koncepti i këtij institucioni dhe për të cilin ekziston si institucion artistik. Ky ligj e fuqizon shumë rolin e të ashtuquajturit drejtor gjeneral dhe e minimizon rolin e drejtorit apo si tani quhet udhëheqës artistik. Bie fjala, te kriteret që kërkohen për pozitën e drejtorit të përgjithshëm, neni 3, pika 4, thuhet se drejtori i përgjithshëm duhet të jetë nga fusha e teatrit ose nga lëmi e tjera të përafërta të kulturës.

Pra, ai mund të jetë edhe publicist, etnolog apo çkado tjetër, por paradoksi vazhdon, kur në nenin 14, pika 2, thotë se ai merr pjesë në krijimin e konceptit artistik të teatrit. E pra, kjo është një shkelje flagrante, sepse pjesë e krijimit të konceptit artistik të teatrit mund të bëhet edhe dikush, i cili nuk ka konsideratë profesionale në këtë punë. Madje, në shumicën e teatrove perëndimore, drejtori i përgjithshëm më shumë është një tip menaxheri apo administratori. Shikoni për këtë, vetëm mënyrën se si është i rregulluar, janë të rregulluara këto raporte në disa teatro, si në Austri, Gjermani dhe Francë.

Në këtë sens, drejtori artistik është vlerësuar nga të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë profesionale dhe këto kompetenca janë deleguar te drejtori i përgjithshëm, pa lejen e të cilit nuk mund të ideohet asnjë program artistik. Bie fjala, neni 15, ku merret me këtë sferë në paragraf pune këtij udhëheqësi i subordinohet atij të drejtorit të përgjithshëm. Për

shembull, skandali arrin kulmin, kur thotë se i propozon drejtorit të përgjithshëm për regjisor dhe ndihmon në përcaktimin e ekipit artistik të shfaqjeve. Po ashtu, i bën propozime drejtorit të përgjithshëm për bashkëpunim artistik me artistë dhe institucione teatrore vendore dhe ndërkombëtare. Pra, nëse udhëheqësi artistik ka mundësi të vendosë kësi bashkëpunime, atëherë pa lejen e drejtorit të përgjithshëm nuk mund të bëhet kjo. E nëse drejtori i përgjithshëm i thotë, jo, s'dua ta bëjë, pra, rrjedhimisht mund të rrënohen edhe këto interaksione artistike dhe estetike, që mund të krijojë udhëheqësi artistik. Thotë: “udhëheq punën kreative të ansamblit rezident. Udhëheqësi nuk e udhëheq punën kreative të ansamblit rezident, këtë e bënë regjisorin. “I propozon drejtorit të përgjithshëm për regjisor dhe ndihmon në përcaktimin e ekipit artistik të shfaqjeve.”. Pra, thotë vetëm bënë propozime. Kjo më duket nonsens logjik se për çka duhet të jetë atëherë, drejtori artistik. Rrjedhimisht, kjo logjikë e shkeljes së pavarësisë krijuese artistike dhe në kundërshtim me frymën krijuese evropiane. Për hartimin e këtij ligji madje, çka është edhe më katastrofale, ka të bëjë me faktin se ky projektligj ka ardhur në Kuvend për miratim, pa asnjë debat publik paraprak, pa asnjë konsultë me komunitetin e artistëve të teatrit dhe njohës të tjerë profesional të kësaj veprimtarie artistike.

Për më tepër një formë e këtillë, për më tepër një formë tjetër e këtij projektligji, që ka qarkulluar më herët, ka qenë shumë më e avancuar, se sa forma aktuale, që sot na servohet, por nuk dihet pse, ku ka shkuar dhe pse ajo nuk ka ardhur në procedim në Kuvend.

Paradokset dhe kontradiktat e këtij projektligji spikasin edhe në nenin 4, pika 4, ku thuhet se themelimi i çmimeve për teatër bëhet me një akt nënligjor, të cilin e nxjerrë ministri përkatës për kulturë. Pra, nuk thuhet Ministria, por thuhet ministri. Por, imagjeroni, me një dekret thuhet se qeveritar, ky ligj i sanksionon institucionet tjera dhe individët të themelojnë çmime për teatër. Pra, ky është kulmi i degradimit me këtë ligj. Një shtet t'ua ndalojë organizatave ose individëve ose lëvizjeve të ndryshme qytetare të themelojnë çmime për teatër. Rrjedhimisht, sipas kësaj logjike centraliste, që është konstruktuar ky projektligj, në vend se të synojë depolitizimin e kësaj sfere, do ta politizojë deri në banalitet jetën teatrore në Kosovë. Ka gjasa që tash e tutje vetëm ata që thurin lavde dhe glorifikojnë udhëheqësin e madh të kenë mundësi të përfitojnë mirënjohje artistike politike.

Përfundimisht edhe ky ligj është i infektuar po ashtu, nga ai virusi i ligjit të kaluar, në pikën sikur ligji për biblioteka, në fakt projektligji për bibliotekat, në nenin 20, pika 7, ku thuhet se edhe zbatimi i këtij ligji mund të bëhet varësisht nga situata fiskale dhe buxhetore. Është e papranueshme, që të vijnë në Kuvend projektligje dhe të varen nga rrethanat të jashtme objektive, fiskale dhe buxhetore dhe në esencë se ne po e miratojmë një ligj, po edhe nuk e dimë se a do të kemi mundësi ta zbatojmë për shkak të këtyre rrethanave të jashtme?

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh këto vërejtje, që i specifikova, lëvizja “Vetëvendosje” nuk e përkrah as në parim këtë projektligj.

KRYETARI: A e keni ndarë mendimin në Komision?

Mirë shumë! Vazhdojmë!

Në emër të Aleancës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Me të vërtetë, kryetar, ju si kryetar i Kuvendit, duhet të dini që disa prej deputetëve, një pjesë e madhe edhe udhëtojnë, unë e di që vëmendja ka rënë, sepse janë kushtet e vështira, por mbasi janë tri ligje, që vijnë nga Ministria e Kulturës dhe reflektojnë kulturën, unë shpresoj që vëmendja le të rritet deri në momentin e fundit. Prandaj, po shpresoj që edhe ju që po diskutoni atje në kryesi, po diskutoni në parime, jo për mos të thënë, ndoshta se ne po mundemi të bëjmë ndoshta edhe ndonjë gabim. Prandaj, që në fillim “Aleanca” e përkrah në parim, sidomos zoti Hamiti, me vëmendje po i përcjell diskutimet, sidomos diskutimet e gjinisë femërore, prandaj me vëmendje po i përcjell. Unë shpresoj që për të mirë, shpresoj për të mirë, prandaj, “Aleanca” e përkrah në parim dhe ka sugjerimet, vërejtjet e veta, të cilat, shpresojmë që do të merren parasysh, në të kundërtën do të votojmë “kundër” në leximin e dytë.

Prandaj, për shqyrtimin e këtij projektligji për teatrot, do të paraqesim disa informacione, me të cilat jam shërbyer me profesionistë të kësaj lëmie, e të cilët janë të ndërlidhura me statusin e teatrove profesionale të qyteteve, të cilat nuk janë të sqaruara në mënyrë të qartë në këtë projektligj. Prandaj, në nenin 5, të projektligjit përshkruhet statusi i teatrove publike,

- nën 1, teatrot kombëtare,
- nën 2, teatri i qytetit,
- nën 3, teatri i studentëve të fakulteteve universitare të Prishtinës.

Kështu që, tutje në nenin 6, pika 1, 2, 3, përshkruhet statusi i Teatrit Kombëtar të Kosovës, si institucion më i lartë teatror në Kosovë me seli në Prishtinë, si dhe elementet e tjera të funksionalitetit të këtij teatri. Konsideroj që pas nenit 6, mund të vazhdohet me tekstin e evidentimit të teatrove tjera kombëtare, të cilat janë të theksuara në pikën 1, të nenit 5, në numrin shumë, ku pezullohet njohja e statusit të më shumë se një teatri kombëtar. Në kontekst me statusin e teatrove kombëtare, mendoj se duhet të shtohet teksti i nenit 6, pika 1, me të cilin njihet statusi i Teatrit Kombëtar për Teatrin Kombëtar të Gjakovës, Teatrin Kombëtar të Gjilanit dhe ndonjë qyteti tjetër të Kosovës, i cili i plotëson kriteret për statusin e Teatrit Kombëtar.

Pastaj, në nenin pasues 6, pika 2, mund të theksohen kriteret e veçanta të njohjes së statusit të Teatrit Kombëtar, si për shembull,

- Nën 1, kriteri i historikut të institucionit të teatrit,
- Nën 2, kriteri i traditës dhe sukseseve në planin kombëtar dhe ndërkombëtar,
- Nën 3, kriteri i objektit të teatrit dhe infrastrukturës përcjellëse dhe
- Nën 4, kriteri i stafit profesional.

Sa për informacion, ju njoftoj se në shtetet e ndryshme të rajonit, ekzistojnë më shumë se një teatër kombëtar, për shembull, në Kroaci, Rumuni, Maqedoni, e tjerë, shtete në të

cilat funksionojnë edhe teatrot tjera kombëtare të qyteteve. Teatri Kombëtar i Gjakovës ka funksionuar me këtë status, për afër 35 vjet dhe nëse sot nuk i njihet statusi me këtë ligj, atëherë do të rezultojë me degradimin e vlerave të një institucioni me renome kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në stagnimin e kulturës dhe veprimtarisë teatrore në qytetin e Gjakovës, i cili para së gjithash njihet si qytet i traditës dhe i kulturës sonë në përgjithësi, vatër që në vazhdimësi i ka bërë nderë jo vetëm Kosovës, por gjithandej trojeve tona. Vetëm Teatri Kombëtar i Gjakovës, që nga themelimi i tij, pra, më 1977, ka realizuar më shumë se 97 projekte apo vepra artistike teatrale. Vepra, të cilat me ëndje i kanë shikuar rreth 1 milion artdashës. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Unë pa dëshirë do t'i them dy fjalë, po është hera e dytë që kjo zonjë ma përmend emrin, pa e ditur pse. Dhe unë e respektoj shumë këtë zonjë, si të gjitha zonjat deputete këtu dhe zotërinjtë deputetë. Po, kjo nuk do të thotë, që perceptimet abstrakte të bëhen publike duke afishuar emrat e dikujt. Duke ditur që jemi në pluralizëm e ushtroj durimin që të dëgjoj edhe mendimet, që s'i respektoj, në kuptimin e vlerës, po i dëgjoj. Ndonëse, në pluralizëm dhe në demokraci është gjest i kulturuar dhe njerëzor, bile që ato që s'do, s'i dëgjon edhe del jashtë. Po, unë po ndalem këtu.

Edhe një herë po them, e kam nivelin dhe kulturën, që s'dua të flas me gjuhë tjetër dhe nuk do të përdorë gjuhë tjetër. Ju atje, mund ta merrni fjalën dhe ju përgjigjem edhe ju, nëse duhet, po keni kujdes, sepse po bisedojmë për një materie, që nëse doni të bëhemi profesionist, mua më duhet t'ju mbaj ligjërata. Po, unë e di që jam në një Kuvend popullor dhe në Kuvend popullor, përfaqësues ka të gjitha shtresave të shoqërisë dhe nuk duhet të pritët, se ka të gjitha niveleve të dijeve dhe të përfaqësimeve dhe unë e di ku jam këtu. Në këtë rast, po bisedohet për një veprimtari që, le të më lejohet kjo ta them kësaj radhe, profesionalisht boll pak shoh këtu që dinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kundër replikë? Urdhëro Teutë!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Me gjithë respektin, që është bërë zakonisht kur diskutojnë, e them prapë me përgjegjësi të plotë, kur diskutojnë femrat, është e pamundshme që zoti nënkryetar të mos flet bile, bile me dorë te goja. Kjo më pengon, nëse flitet në një nivel shumë më të ulët e le më të një akademiku, këtë e them me përgjegjësi të plotë, prandaj nuk kemi nevojë për ligjërata, e them shumë sinqerisht, mund të jetë ekspert i një fushe, por secili jemi ekspert i një fushe, por bashkërisht bëhemi ekspertë të shumë fushave.

Prandaj, për ata po ju dalin edhe shumë afarizma në Fletore të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, mos i përzieri disa gjëra, afarizmat s'kanë lidhje me neve. Një minutë kundër-replikë, zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë.

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Duke dëgjuar edhe zërat e kolegëve deputetë, unë do të flas shumë shkurtër. Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar këtë ligj, të cilin do ta miratojë. Vërejtjet dhe sugjerimet tona në lidhje me këtë projektligj do t'i adresojmë te Komisioni funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit SLS, deputeti Milivoje Stojanović e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIQ: Hvala predsedavajući, zahvaljujem na reč!

Znači predstavnik Poslaničke Grupe SLS-a.

Poslanička Grupa SLS-a je razmatrala ovaj nacrt zakona o pozorištu. Ovim zakonom se garantuju prava slobodnog stvaralaštva za sve oblike umetničkog i scenskog delovanja. A istovremeno zakon reguliše osnivanje, organizaciju, funkcionisanje i finansiranje pozorišta s jedne strane, a sa druge strane reguliše i položaj pozorišnih umetnika i ostalih radnika u pozorištu.

U ovom nacrtu zakona i kod pretodnih govornika, pojavila se jedna nedoumica a to je član 5. u kome se govori o javnim pozorištima, gde se navodi o nacionalnim pozorištima, da li se govori u jednini ili množini, odnosno ovde je naglašeno da u množini sada kod svih nas izaziva nedoumicu, da li je to tehnička greška ili se radi o suštinskoj stvari.

Ukoliko je suštinska stvar, znači ovaj stav na neki način zadovoljio bi neke potrebe manjinskih zajednica. Ukoliko je tehnička greška, ja bi naglasio da i ostale zajednice, manjinske zajednice imaju potrebu da razvijaju i neguju svoju kulturu, da razvijaju, znači svoju pozorišnu scenu i samim tim imalo bi potrebe za formiranje jednog ansambla ili neke pozorišne trupe u okviru nacionalnog pozorišta. To je jedna stvar.

A sa druge strane upravni savet nacionalnog pozorišta, u upravnom savetu, također mišljenja sam da bi trebalo rezervisati mesto i za manjinske zajednice i to regulisati zakonom.

U svakom slučaju poslanička grupa SLS, će podržati nacrt zakona a svoje sugestije će prezentirati na funkcionalnim i stalnim komisijama. Zahvaljujem.

KRYETARI: Faleminderit!

Nga “6+”-i nuk ka të lajmëruar.

Radha e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Blertë Deliu Kodra.

BLERTA DELIU- KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të ndalem fillimisht tek projektligji, titulli i projektligjit, "Projektligji për teatrot". Mendoj se është i qëndrueshëm, për shkak se në këtë projektligj janë të përfshirë teatrot publike, në të cilat bëjnë pjesë Teatri Kombëtar dhe Teatri i qytetit, Teatri i studentëve të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës si dhe teatrot private, në të cilat bëjnë pjesë trupat teatrale, kompanitë teatrore, të cilat mund të themelohen nga personat juridik dhe fizik, vendor apo të huaj, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përmes projektligjit për teatro do të garantohen liritë dhe të drejtat krijuese për shprehjet artistike dhe skenike, duke rregulluar njëherit edhe: themelimin, organizimin, funksionimin, menaxhimin dhe financimin e teatrove, si dhe pozitën e artistëve të teatrit. Kur flas për pozitën e artistëve, e cila është e rregulluar me ligj, do të ndalem tek vendimi i Qeverisë për legalizim të vendit të punës të krijuesve dhe të përformuesve të kulturës si dhe të punonjësve të trashëgimisë kulturore, të cilët për 10 vjet me radhë kanë pasur status të pazgjidhur, duke punuar me kontratë mbi vepër.

Brengat e komunitetit artistik, jo gjithnjë janë trajtuar në mënyrë meritore, ngase mungesa e një statusi të rregullt legal ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në punën e tyre. Vendimi i ministrit Krasniqi, për t'iu dhënë fund telasheve të komunitetit të artistëve, erdhi pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të Teatrit, duke stimuluar kështu edhe artistët në aspektin material, por duke iu siguruar atyre edhe një mbrojtje ligjore.

Në fund shpresoj se Projektligji për teatrot, me 28 nene, sa i ka gjithsej, do të kontribuojë në krijimin e një ambienti të favorshëm për punë, duke ndikuar në avancimin e pozitës së krijuesve tanë.

Pasi që nga buxheti i shtetit nuk ka mundësi të ndahet buxhet shtesë për zbatim të këtij ligji, shpresoj se komunat sipas Projektbuxhetit për vitin 2012, kanë paraparë buxhet për financim të teatrove publike.

Faleminderit!

KRYETARI: Diskutuesi i fundit, deputeti Sadri Ferati, e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Unë isha edhe anëtar i Komisionit, që në parim e kemi përkrahur këtë projektligj dhe mendoj që kryesisht është mirë i hartuar, ia ka dalë. Por, ajo që do të kisha dëshiruar, që ky ligj të shkojë pak përtej.

Duke marrë parasysh rëndësinë e fushës që po flasim dhe po të bëjmë një analizë, cila është gjendja nëpër teatrot, sidomos këto regjionale apo profesionale, që janë themeluar nën premtimin e mbështetjes së ministrive, tash iu kanë lënë nën fat vetë komunave dhe kemi informacione se ato janë në gjendje të vështirë dhe shumë shpejtë do të mbyllen, në rast se nuk e kanë ndihmën e Ministrisë, së paku për një vit, dy-tri vjet, deri sa shoqëria jonë pak të forcohet.

Ne kemi rastin që prej Mitrovicës deri në Gjakovë, që edhe nga dy-tre muaj, pra një teatër i afirmuar, çfarë ishte ai i Gjakovës, tani ka problem edhe me pagat e artistëve. Prandaj

do të kisha dëshiruar të shihet cili është maksimumi, që do të kishte mundur të bëjë Ministria, që së paku, do të thotë, nga një shfaqje, nga një premierë ta financojë, po aq do të mund të bëjë komuna, kështu që, së paku këto 6 teatro profesionale, të mund të ruajnë kuadrin deri sa shoqëria jonë pak të forcohet dhe ato të munden pastaj, përmes biletave të mbahen. Tash për tash ato janë total jo profitabile dhe nëse nuk mbështeten nga Ministria, do të shuhen.

Gjithsesi, ne e dimë se, do të thotë, aktivitetet kulturore janë plotësisht kompetencë komunale dhe ajo mirë është e përshkruar me Ligjin për vetëqeverisje lokale, por meqë Ministria po dëshiron që të japë modelin se si po organizohet Teatri Kombëtar dhe atë ta përcjellë tek ato komunale, ishte dashur, megjithatë ta japë një minimum ndihme, që ato ta mbijetojnë për një fazë.

Një premierë, një premierë, një do ta sigurojë komuna dhe ato do të mund të ekzistojnë, prej atyre shkollore deri tek ato amatore dhe profesionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nejse, ndoshta ke ndonjë vërejtje edhe me arsye, por edhe unë dua t'i them dy-tri fjalë për këtë ligj, që e kemi, para se ta marrë fjalën ministri.

Realisht ne do ta ruajmë koncentrimin, se dy projektligjet e fundit, është e vërtetë, që kanë një rëndësi të veçantë për kulturën dhe traditën kombëtare, në rend të parë. Dhe, sigurisht që gjatë këtyre viteve, duhet ta pranojmë edhe si komb, kemi pasur probleme edhe të edukimit edhe të kulturës edhe të traditës kombëtare.

Unë dua t'i them vetëm dy-tri fjalë. Jam ithtar shumë i kulturës edhe asaj të bibliotekave, që ishte më herët edhe i kësaj, i teatrit.

Ne duhet ta shikojmë si komb, sa teatro kombëtare mund t'i mbajmë dhe nëse një teatri i themi teatër kombëtar, duhet ta dimë se edhe materia që zhvillohet atje duhet të jetë, sa për qind kombëtare. Se në fakt ne po i themi kombëtare, por gati gjitha shfaqjet që jepen janë nuk janë kombëtare dhe në këtë rrafsh, kur nuk jepen shfaqje kombëtare, por jepen shfaqje të huaja, do të thotë, me gjithë respektin që kam për kulturën e huaj, por unë më me ëndje e shikoj, nëse një temë është e artistëve të Holivudit, në origjinal ta shikoj se sa në gjuhën shqipe. Unë konsideroj që të gjithë ata që e marrin përsipër formimin dhe avancimin e një teatri apo shumë teatrove kombëtare, duhet të shikojnë që edhe problemet ose temat, që i marrin për t'i prezantuar para opinionit, duhet të jenë tema të interesit kombëtar dhe që edukojnë në edukimin e gjeneratave të reja, që shpeshherë këtë nuk e shohim.

Prandaj, gjithnjë kur ju themi diçkaje kombëtare, duhet të jetë shumica e saj kombëtare ose përndryshe veç i themi teatër shtetëror ose teatër i kryeqytetit. Megjithatë, kjo ishte tema e diskutimit, ndoshta edhe individual, siç diskutoni ju individualisht, që si ta avancojmë kulturën tonë dhe kemi nevojë të investojmë shumë, edhe pse mundësitë ndoshta, janë të kufizuara. Por, si komb, sigurisht që kemi nevojë ta trajtojmë edhe më shumë kulturën kombëtare, edukatën tradicionale kombëtare dhe natyrisht, çështjet që

kontribuojnë në edukimin kombëtar të brezave tonë. Se, teknologjia ka shkuar aq shumë, sa ne nëse duam që të shohim shfaqje të huaja, shkojmë në kinema, shikojmë televizionet, do të thotë i kemi shumë mundësi.

Po na mungon jeta kulturore kombëtare në Kosovë, që sa vite dhe ndoshta edhe Ministria, por e gjithë shoqëria kosovare duhet të investojë në këto fusha, në fushën e edukimit tradicional të gjeneratave të reja. Ministër, e ke fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Më lejoni fillimisht t'i falënderoj të gjithë deputetët, ata që diskutuan dhe veçanërisht anëtarët e Komisionit funksional. Më lejoni që në mënyrë telegrafike t'i them disa gjëra për çështjet që u ngritën, duke konfirmuar vullnetin që të diskutojmë në detaje në Komisionin funksional, kurdo që ata të na thërrasin.

E para, më lejoni ta sqaroj, nëse ka pasur debat publik për ndonjë ligj, ka pasur për këtë ligj. Janë më shumë se 200 aktorë, regjisorë, dramaturgë, kritikë, të cilët e kanë marrë këtë projektligj dhe kanë pasur një muaj kohë për të na i dorëzuar komentet e tyre. Pasi që i kemi marrë komentet e tyre dhe i kemi inkuadruar një pjesë të tyre, realisht ne atëherë e kemi dorëzuar projektligjin në Qeveri dhe pastaj ka ardhur në Kuvend. Këto mund t'ua dëshmojmë dhe do t'ua sjell dokumentacionin, nëse doni, t'i shihni edhe emrat, nëse duhet, të gjithë këtyre njerëzve, ju e dini që s'janë me mijëra, po janë me qindra dhe janë mbi 200, që ne i kemi konsultuar, pas përfundimit të punës nga grupi punues qeveritar, siç ka qenë e paraparë me Rregullore.

Çështja e teatrove kombëtare në shumës, realisht, Teatri Kombëtar i Kosovës definohet edhe në këtë projektligj si institucioni superior, primar i veprimtarisë teatrore në Kosovë. Ajo pse është në shumës, teatrot kombëtare, është për të krijuar një bazë ligjore, që në të ardhmen, nëse shtrohet nevoja për ta themeluar një teatër, ta zëmë Teatri Kombëtar i Komedisë ose Teatri Kombëtar i Kukullave, kjo nuk është diçka e re, që po zbulojmë. S'po shkojmë më larg se Shqipëria dhe po e marrim modelin atje, që u përmend këtu, që të merret modeli i Shqipërisë dhe shohim se atje teatri në nivelin kombëtar nuk është vetëm Teatri Kombëtar, por është edhe Teatri i Operës dhe i Baletit, Teatri i Kukullave, Teatri i Komedisë, që do të thotë kjo e krijon bazën ligjore, ndoshta kurrë s'ka për t' u bërë, ndoshta behët mbas 5 vjetësh. Ndoshta, Teatri Dodona, nesër bëhet Teatër i Kukullave në nivel kombëtar, por e krijon bazën ligjore, që nëse neve na vjen njëherë një rast mbas 5 vjetësh me u ba mos me ardh me ndryshu ligjin ose me marrë veprim, që s'ka bazë ligjore.

Kjo është ideja, s'do të thotë që duhet të mbetet, mund të ndryshohet, është në vullnetin tuaj dhe në gjykimin tuaj. Ose Teatri i studentëve të fakultetit, që nuk ekziston, është në bazë ligjore dhe është në vullnetin e Universitetit të Prishtinës, që të krijojë hapësirën, kushtet dhe mundësitë për funksionimin e tij. Çështja tjetër, që u përmend, e udhëheqësit artistik apo drejtorit artistik. Mendoj se më e rëndësishme se sa të merremi me titullin, është të merremi me kompetencën ose me fizionominë, që do t'ia krijojmë kësaj, këtij pozicioni. Për dallim prej ligjit të kaluar, tash ndarja është shumë më e saktë, ndërmjet

kompetencave të drejtorit, ose në këtë rast udhëheqësit artistik dhe drejtorit të përgjithshëm ose menaxhues. Dikotomia që ka qenë për vite me radhë e ka paralizuar bile në raste të caktuara funksionimin e Teatrit Kombëtar, për shkak të mosmarrëveshjeve deri në sharje publike ndërmjet këtyre dy pozicioneve, se kush ka çfarë kompetence. Dhe, udhëheqës artistik ka ardhur si rrjedhojë e vullnetit tim ose të stafit politik të Ministrisë, po e grupit punues, që përbëhet prej shërbyesve civilë kryesisht dhe duke u bazuar në legjislacionin aktual, që në institucionet tjera publike, qoftë në Ansamblin Kombëtar të Valleve “Shota”, qoftë në Baletin e Kosovës, qoftë në Filarmoninë e Kosovës, nuk parashihet pozicioni i drejtorit artistik, por quhet udhëheqësi artistik. Kompetencat realisht, janë të njëjta, bile, unë mendoj se në këtë projektligj janë specifikuar shumë më qartë dhe pjesa e pavarësimit të punës në pjesën artistike, është evidente. Fakti pse ka ndodhur në fund të projektligjit final, që thuhet që, eprori i parë i udhëheqësit artistik është drejtori, është sepse kjo është një praktikë edhe tek ligjet tjera. Atëherë, mendimi ynë është që ne duhet ta bëjmë një lloj apo një frymë të këto ligje të institucioneve të kulturës, të njëjtë dhe jo të kemi një përzierje, një ligj ndryshe një tjetër.

Fakti që ai drejtor, udhëheqës artistik i jep llogari thjesht, e krijon një lloj hierarkie në kuptimin menaxherial, që të mos jenë dy zot shtëpie, qysh ka ndodhur, kur janë dy zot shtëpie, s’dihet cili është realisht, përgjegjësi. Dhe gjithmonë, edhe kur ka probleme, përgjegjësia po shpërndahet ose po gjuhet faji prej një vendi në vendin tjetër. Kjo është thjesht në funksion të thirrjes në përgjegjësi dhe marrjes në përgjegjësi konform ligjit dhe konform akteve të tjera nënligjore.

Ajo që u përmend, që është u tha më duket, se është në kundërshtim, nuk është, sepse mungesa e udhëheqësit artistik, në teatrot private mund të jetë. Ne s’mund t’i detyrojmë, s’është drejtë t’i detyrojmë teatrot private ose kompanitë, trupat teatrore, t’iu themi- ju duheni gjithqysh, sipas ligjit të keni udhëheqës artistik, sepse ndoshta do ta kenë vetëm drejtorin, i cili është i kësaj fushe dhe udhëheq. Dhe, ideja, që e zëvendëson udhëheqësin artistik, drejtori është në këto raste, jo tek rastet publike.

Ansamblin rezident, ishte vërejtje me të drejtë për mendimin tim. Çka nëse në ansamblin rezident ka aktorë realisht, që dhjetë vjet paguhen dhe nuk luajnë. Është sipas praktikave, që diskutohen me akte nënligjore, do të rregullohet çështja në ansamblin rezident dhe do të jetë një pjesë e limituar e kohës ku anëtarët e ansamblit rezident, nëse për një periudhë të caktuar nuk angazhohen nga asnjë prej regjisorëve që mund të bëjnë shfaqje në teatër, pastaj mund të mos jenë më pjesë e ansamblit rezidentë dhe të konkurrojnë prapë me të tjerët ose të lëshojnë vendin për të tjerët. Sepse, realisht është shqetësim edhe i udhëheqësish aktuale të teatrit, fakti që janë mbi 20 momentalisht dhe pjesa dërmuese e tyre nuk angazhohen dhe kur bëhen shfaqjet, angazhimi bëhet me aktorët, që janë jashtë dhe kjo e rrit edhe koston e projekteve dhe për shkak të buxhetit të limituar e pamundëson ndoshta edhe një numër më të madh të shfaqjeve.

Realisht, është e mundshme që mos të ketë fare ansambël rezident, sepse praktikën, ta zëmë në Angli, nuk kanë, shumica e teatrove në Angli, nuk kanë ansambël rezident, kanë pjesën teknike që i realizon shfaqjet, pjesën e stafit eminent që duhet të ekzistojë, ndërsa

teatrot e caktuara i angazhojnë, varësisht prej nevojave dhe kërkesave artistike të regjisorëve të caktuar për shfaqje të caktuara, ata aktorë që ata duan.

Çështja tjetër, ndarja e çmimeve, shikoni, çmime në teatër, janë ndarë edhe tash. Ne kemi konkursin për dramë “Katarina Josipi”, kemi çmimin vjetor për teatër. Dhe ato çmime, realisht janë ekzistuese, sipas vendimeve të ministrit. Ajo që është munduar të bëhet me këtë ligj, është të krijohet baza ligjore për ato vendime, sepse edhe ato vendime që ekzistojnë janë thirrur në kompetencën, që ministri e ka të marrë vendime, dhe është shumë e gjerë ajo fushë. Nëse ke të drejtë të marrësh vendime, sipas asaj rregullores, që ka qenë në kohën e UNMIK-ut, mund të marrë vendim për çkado, edhe për ligj edhe për çmim edhe për këto. Ajo që është këtu, është thjesht për ta përligjur mundësinë, që për fushën e teatrit për të marrë vendim. Ajo që duhet ministri ose Ministria është çështje irelevante, fakti është që aktin nënligjor në fund duhet ta nënshkruajë dikush dhe përgjegjësinë e ka ministri. Kjo është, nuk është diçka politike, është thjeshtë teknike dhe tek e fundit e ka këtë ide.

Në fund fare, për teatrot e qyteteve, pajtohem plotësisht me Ligjin për vetëqeverisje lokale edhe tek bibliotekat edhe tek teatrot dhe tek rastet tjera, ka ndodhur devoluimi i përgjegjësi dhe në nivelin komunal kanë shkuar këto përgjegjësi edhe në kuptimin financiar. Ne në Ministri jemi munduar edhe vitin e kaluar dhe në këtë vit, që të ndajmë një fond, edhe pse fond nuk ka realisht, por nga fondi ekzistues i subvencioneve, për teatrot e qyteteve. Realisht, e mira është që kanë filluar të shtohen. Vjet edhe në Mitrovicë është themeluar Teatri profesionist i qytetit. Më vjen mirë, që nuk është në revers, domethënë, shuarja e tyre, por këtë vit do të mundohemi, që së paku nëse jo plotësisht, afërsisht t’ua mbulojmë nga një premierë. Dhe e fundit për politizimin ose depolitizimin, mendoj se vlerësimi është pak paushall, nëse lexohet drejt ky ligj dhe krahasohet me ligjin ekzistues, që ka qenë për teatrin, është një dëshmi e qartë e tendencës për depolitizim, bile edhe heqje të kompetencave konkrete të ministrit, kujtdo qoftë ai në të ardhmen, për sa i përket emërimeve të njerëzve të caktuar. Nëse në ligjin e tashëm ministri e vendos kush është drejtor, me ligjin që ne e kemi propozuar, ministri s’ka asnjë kompetencë në atë drejtim. Dhe, qëllimi është plotësisht, që ministri si pozicion politik të mos ketë mundësinë e ndërhyrjes së vullnetit të tij në përzgjedhjen e drejtorëve menaxhues e aq më pak të atyre udhëheqësve artistik ose drejtorëve artistikë, sido që të jetë, vendimi juaj final, që të quhet në fund.

Ju faleminderit shumë, për vëmendjen dhe po ashtu për bashkëpunimin e deritashëm të Komisionit funksional.

KRYETARI: Faleminderit!

A vazhdojmë edhe pak?

Prezentë janë 65 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Konstatohet se me 52 vota “për”, 10 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim, Projektligjin për teatrot.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Pasi shumica udhëtojnë, ju falënderoj që kishit durim të rrini deri në këtë kohë.
Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë